

Spitali ushtarak, mjekët:
Po e lëvizin për privatizim

"Të dhënat personale,
të dënohen gazetarët"

Albpetrol në protestë,
1200 vetë ikin nga puna

Financat, shqetësohet FMN,
Bode: Ekonomia në ulje

[SHQIPTARJA.com]

Na ndiqni
edhe
online

www.shqiptarja.com

LEKË 30

VITI II - NR. 95 E martë, 24-04-2012

Premiera e dokumentarit "Diktatori" të Fevziut, marrin pjesë aktorët kryesorë politikë, mungon Rama

BERISHA-NANO TAKOHEN TE ENVERI

Asnjë fjalë për presidentin, vetëm për diktatorin

Liri Belishova: Tani që u bë ky film, ndjehem e lehtësuar nga dhimbjet. Berisha: I dija të gjitha anët e errta të Hoxhës Nano: S'prita dokumentarin, të njoh Hoxhën. Fatos Lubonja në një ekspozitë sot: Shkoj në Spaç për të kuruar traumën

DEBATI I PLOTE ► Faqe 2-3



**Reforma,
Edi Rama
debat me
Ballin:
Ju hani pula**

Lajmi

Përpara nisjes së kryeministrit Berisha në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ai dhe Fatos Nano, i cili ka shpallur ambicien për të qenë në krye të shtetit, janë takuar në bar Milenium, pasi kanë parë së bashku për 88 minuta dokumentarin "Diktatori" të Blendi Fevziut.

■ ■ ■ TIRANE
DHURATA HAMZAI

Dokumentari i Blendi Fevziut mbi historinë e diktatorit Enver Hoxha, që u shfaq mbremë në Kinema Milenium, përveç të panjohurave për veprimtarinë sekrete të Enver Hoxhës, ka bashkuar dhe shumë personalitete në një tryezë... ► vijon në faqe 20-21



Në foto:
Berisha dhe
Nano dhe pas
përfundimit të
dokumentarit
"Diktatori"
të gazetarit
Blendi Fevziut

Koment



NGA PREÇ ZOGAJ

Për 21 janarin s'ka qëndrim të ballancuar

Hetimi gjithëpërfshirës i 21 janarit dhe qëndrimi i ballancuar për 21 janarin, si ai që shprehu ish-kryeministri Fatos Nano në hapje të fushatës së tij presidenciale, janë dy gjëra të ndryshme, krejt të ndryshme. Hetimi gjithëpërfshirës ka qenë dhe mbetet i domosdoshëm, madje duhet të kishte filluar menjëherë, qysh në mbremjen tragjike të 21 janarit, pa ato pengesat dhe alibitë që nxorri kryeministri Berisha, pa u dhënë kohë të pandehurve të prishnin prova, të rregullonin muhabetet, të manipulonin armët vrastare, të shkatërronin filmimet e bëra nga kamerat e brendshme e të jashtme të kryeministrit, pra pa ndodhur krimi i fshehtës së krimit, për të cilën autorët kanë hyrë dyfish në borbë para ligjit, para opinionit publik e familjeve të të vrarëve padyshim, pasi nëse vrasjet të kryer gjoja për llogari të qeverisë dhe shtetit, fshehjen janë përpjekur ta realizojnë si burracakë për prapancën e tyre.

Hetimi gjithëpërfshirës ka funksionuar dhe po funksionon plotësisht në krahun e opozitës dhe pjesërisht në krahun e qeverisë dhe institucioneve shtetërore. Dhjetra pjesëmarrës në demonstratën opozitare të 21 janarit janë hetuar e dënuar me gjoja apo me ditë burgu për kundravajtje. Tre deputetëve opozitarë u është hequr imuniteti dhe po hetohen. Me shumë vështirësi është vënë në rrugën e zbardhjes hetimi i vrasjeve. Opozita e ka mbështetur hetimin gjithëpërfshirës, ajo i është ofruar nga i pari tek i fundit me bindjen se nuk ka gjë për të fshehur. Qeveria nuk është simetrike me opozitën në këtë qëndrim. As Prokuroria nuk është ende simetrike ndaj palëve në hetimin e deritanishëm. Kryeministri Berisha dhe disa nga ministrat e tij kanë bërë veprime dhe deklarata të bujshme, që duhet të hetohen patjetër... ► vijon në faqe 9

EFT PUBLIKON DOKUMENTIN

Serbët marrin linjën me Malin e Zi

Grupi i përfolur për linjën me Kosovën, hyjnë fuqishëm te energjika

■ ■ ■ TIRANE

ARBEN RROZHANI

Grupi energjitiko-financiar serb EFT, i përfolur javët e fundit për linjën e energjisë me Kosovën, më pak se një vit më parë ndërtoi linjën e interkonjeksionit mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, me vlerë prej 43 milionë eurosh, po financim i bankës gjermane KfW, sipas vetë dokumenteve... ► Faqe 8

REPLIKA

► Faqe 17

**2 prilli, ku
gabon gjyqtari
Artan Broci**



Faksimile e shpalljes së rezultatit fitues që vetë kompania serbe EFT ka bërë në sitin e vet zyrtar për linjë e interkonjeksionit me Malin e Zi dhe Vuk Hamović, drejtues i EFT

DENONCIMI DHE PROVA

Kultura, faqja në anglisht, një "paçavure"

Prezantimi kulturor për të huajt
lë shumë për të dëshiruar

► Faqe 4



... gjithmonë një hap përpara...

Erëza dhe fruta të thata

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 7, Yrshëk Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com



Partia e re e Topit deklarohet brenda javës, gati strukturat

Partia e re e së djathtës shqiptare e inicuar nga Presidenti Topi pritet të deklarohet zyrtarisht këtë javë. Në fillim ajo do të drejtohet nga deputeti aktual Gazmend Oketa dhe më pas Topi do të marrë drejtimin e partisë menjëherë pas përfundimit të mandatit të tij presidencial. Partia mësohet se do të quhet "Fryma e Re Demokratike". Bëhet e ditur se kanë përfunduar të gjitha

përgatitjet, këto ditë pritet shpallja e programit dhe strategjia që do ndjekë për të thithur sa më shumë elektorat në vend. Tashmë kanë përfunduar përgatitjet për ceremoninë e prezantimit të partisë. Bëhet e ditur se Oketa do marrë fjalën i pari ku do prezantojë sfidat e organizimit të partisë dhe më pas do flasin edhe protagonistë të tjerë që i janë rreshtuar kësaj force. Ceremonia do organizohet në

zyrat e reja të kësaj partie përballë godinës së Kuvendit. "Fryma e Re Demokratike", partia më e re e së djathtës shqiptare në statusin e saj parashikon që kreu i partisë të zgjidhet sipas parimit një anëtar, një votë. Kreu i partisë, por dhe krerët në rrethë të zgjidhen jo më shumë se dy mandate, një formë kjo që siguron rotacionin e elitave dhe eliminimin e krerëve të përjetshëm.

Tryeza e partive të vogla për reformën zgjedhore s'arrin marrëveshje

Tryeza: Diskriminohemi nga PS-PD, korrektim sistemit

Rama: Mbështesim korrektimin kombëtar. Rusmali: E diskutojmë

Lajmi

Tryeza e partive politike ku kanë marrë pjesë dhe lideri i PS Edi Rama dhe përfaqësuesi i PD, Rusmali është mbyllur pa një marrëveshje të nënshkruar, por duke marrë zbatim mbështetjen e kreut të PS për korrektimin kombëtar, por dhe lëkundjen e PD, e cila u shpreh se do ta diskutojë. Ka pasur debate të forta në takim.



IMPENJIMET

Berisha dhe Meta munguan në tryezë



Unë s'kam ardhur për të lypur. Këtu voton populli, deri tani janë manipuluar zgjedhjet. Keni gjë për manipulimin dhe vjedhjen. Nëse s'keni gjë ai që ka vjedhur do vjedhë prap", tha Ngjela. PS përmes Ramës garantoj se është dakort për të përmirësuar sistemin. "Nëse ka vend për të përmirësuar sistemin ne jemi dakord që të japim gjithë mbështetjen dhe kontributin tonë, për një sistem të përmirësuar përmes një korrektimi kombëtar që mundëson më shumë hapësirë dhe barazi në garë dhe në votën e partive parlamentare, partive jo parlamentare dhe partive të reja që hyjnë në garë. Në parim e kemi thënë dhe sot e konsiderojmë këtë, se jemi të gatshëm të eksplorojmë bashkë me gjithë të tjerët mundësitë e përmirësimit të sistemit", deklaroi Rama. Ndërsa përfaqësuesi demokrat në këtë tryezë Rusmajli tha se "është një pemë që nuk e ka gjetur qetësinë e vet që në kohën kur lindi demokracia në të gjithë botën e zhvilluar. Nuk ka gjetur qetësinë e vet sepse s'ka arritur të realizojë dot prefekcionin dhe s'ka për ta arritur ta realizojë kurrë. Ne jemi të hapur ta diskutojmë dhe ta vendosim këtë gjë". Por tryeza është shoqëruar vazhdimisht me debate të tensionuara, në qendër të të cilave ka qenë kryetari i socialistëve Rama, i cili u kërkoi të djathtëve, që, ndryshimin e sistemit si kërkesë t'ia adresojnë aleatit të tyre PD dhe jo forcës më të madhe opozitare. Tryeza e të vegjëlve përpos debatit me dy partitë e mëdha, u pa se edhe mes tyre kanë divergjenca në qendrimet. Iniciatorët thanë se do përpilojnë një dokument me disa konkluzione, të cilat do t'ju dërgohen për firmë partive të tjera e më pas do ti paraqitjet komisionit të Reformës Zgjedhore.

TIRANE

JAKIN MARENA

Ndryshimet në kodin zgjedhor duhet të nisin me korrektimin kombëtar të këtij sistemi, pasi ai aktual spanjoll është adaptuar me deformime. Kjo ka qënë kërkesa e 23 partive të vogla të mbledhura dhe në tryezën që u zhvillua për reformën në sistemin zgjedhor. Duke bërë propozimet e tyre përkatëse përfaqësues të këtyre partive bënë thirrje për një proces gjithëpërfshirës ku të garantohet parimi themelor, ai i barazisë së votës. Kreu i PDS, Paskal Milo dhe bashkëmonitoruesi i kësaj tryeze Arian Madhi i PR në hapje të tryezës deklaruan se gara e ardhshme elektorale duhet të jetë e barabartë e të plotësojë standardet. Të vegjlit me radhë, të majtë e të djathtë kanë akuzuar dy partitë e mëdha për deformime të sistemit në kurriz të të vegjëlve, duke vënë në krye të kërkesave të tyre, korrektimin kombëtar. "Vota të mos shkojë nga një parti tek tjetra në mënyrë të padrejtë, por të shkojë haka tek i zoti", u shpreh kreu i PSD, Gjinushi. I cili është shprehur se sistemi zgjedhor sipas variantit spanjoll dhe i deformuar në Shqipëri ka sjellë luanatje të votës. Ndërkohë që s'ka kaluar pa u shprehur dhe për aleancat, duke deklaruar se problemi i listave të përbashkëta është i tillë që ato s'mund të ndalohen apo të futen

PROPOZIMET E PARTIVE TË VOGLA PËR REFORMËN

I- Mbi llogaritjen dhe shpërndarjen e mandateve me qëllim korrektim proporcionalisht të votave për çdo subjekt zgjedhor.

Formula e më parshme deformon votën duke:

Favorizuar padrejtësisht partitë më të mëdha politike brenda koalicionëve.

Sjell uljen e pamerituar të numrit të mandateve që u ndahen partive të treta

Ndryshimi parashikon: (Varianti 1)

Aplikim të një formule që realizon një ndarje të plotë proporcionale brenda koalicionit në nivel rajonal. Ky variant merr parasysh përllogaritjen e shpërndarjes së mandateve për çdo Zonë Zgjedhore, duke ruajtur formulën e parashikuar në nenin 162 të Kodit Zgjedhor.

Neni 163 për ndarjen e mandateve brenda koalicionit. Këto ndryshime parashikojnë:

1. Partia politike pjesëtare e një koalicioni depoziton në KQZ listën shumëemërore të kandidatëve të saj për çdo Zonë Zgjedhore si dhe një listë të posaçme shumëemërore të kandidatëve të saj në rang vendi.

2. Llogaritja e mandateve që u shpërndahen partive politike brenda një koalicioni në nivel rajonal bëhet mbi bazën e metodës matematikore me kuotë

II- Mbi uljen e pragut elektorale në 2% të partive që konkurojnë më vete dhe 4% për koalicionet.

III- Mbi aksesin e plotë për vëzhgimin e procesit zgjedhor nga të gjitha subjektet konkurrese.

V-Mbi regjistrimin e listave shumë emërore të kandidatëve të koalicionëve. Neni 67/2 i Kodit Zgjedhor detyron për depozitim në KQZ vetëm listën shumëemërore të partive të koalicionit. Është i pajustifikuar fakti që një koalicion zgjedhor përfshihet në garën konkurrese si subjekt zgjedhor dhe nuk i lejohej të sillte si i tillë për Shpërndarjen e përfundimtare të mandateve zgjedhore ndërmjet partive përbërëse të këtij koalicioni. Ndryshimi i propozuar parashikon: "Çdo koalicion apo grupim politik brenda një koalicioni ka të drejtë të depozitojë në KQZ listën shumëemërore të përbërë për çdo zonë zgjedhore apo në nivel kombëtar".

në Kod, pasi është problem i koalicionit. Ndërsa kreu i PDK Ndoka tha se "janë votat tona, të cilat me ligj i keni deformuar duke i tjetërsuar në mandate për dy partitë, duke e bërë veten

ligjërisht me zor të mëdha". Ndërsa kreu i PS Rama iu përgjigj se "është rasti unikal në botë që kërkohet mbështetja e partive të mëdha me të shara". Nga ana e tij, numri dy i LSI,

njëherësh dhe i qeverisë, Haxhinasto është shprehur që i qëndron idesë së një proporcionali të pastër, ndërkohë që tha se "LSI mbështet korrektimin kombëtar ose variantin e ndarjes

në 6 zona elektorale". Kreu i PLD Ngjela vuri në dukje mungesën e një formule e për për mospërsëritjen e precedentit të vjedhjes dhe manipulimit të votave. "Këtu s'ohet një formulë.



POLITIKE

PS me sindikalistët për programin, Beqaj: Luftë ndaj varfërisë

Grupi i punës së Programit të PS për Çështjet Sociale, organizoi një takim konsultativ me drejtues dhe përfaqësues të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë nga të gjitha qarqet e vendit. Në këtë takim, i cili u organizua në selinë e Konfederatës në Kombinat, morrte pjesë dhe Sekretari për Programin Ilir Beqaj. Ai prezantoi idetë kryesore të Programit të PS dhe disa nga rezultatet e rekomandimit kryesor të

tryezave të organizuara për aspekte të ndryshme të Programit. Kryetari i Grupit të punës së Programit për Çështjet Sociale, Barjaba, parashtrroi disa nga idetë kryesore në fushën e zhvillimit social, duke u fokusuar në luftën kundër varfërisë e përjashtimit social, politikat e pensioneve, shërbimet sociale riintegruese, llogaritjen, shpalljen e garantimit të minimumit jetik, politikat për fëmijët, politikat e shërbimit

për grupet nevojtarë të shoqërisë etj. Ata vlerësuan Programin e PS për idetë dhe mbështetjen e gjerë që u jep sindikalistëve, njerëzve të punës dhe grupeve nevojtarë të shoqërisë, si edhe praktikën e re të konsultimit të Programit me grupet e interesit. "Procesi i diskutimeve me grupet e interesit, është një garanci për zbatimin në praktikë të Programit socialist gjatë qeverisjes", thanë ata.



Milo i flet Ramës për Ngjelën: Çfarë është ai budalla, pse m'a sillni këtu

Rama, debat me ballistët dhe Milon: Ju hani pula

Ballistët, Alimadhi: Ju keni ngrënë koka njerëzish

TIRANE

JAKIN MARENA

Tryeza e politike për re formën zgjedhore ka de gjenur në akuzë dhe batuta mes kryesocialistit Edi Rama me përfaqësuesit e Ballit Kombëtar, Partisë Republikane, Partisë Lëvizja e Legalitetit dhe përfaqësuesin e PDS Milo, por dhe mes Ngjelës dhe drejtuesve të tjerë partiakë të mbledhur dhe në tryezën politike për diskutimin e ndryshimeve në sistemin zgjedhor. Kreu socialist Rama nuk ka munguar të kujtojë dhe njëherë për ballistët "epopenë" e Shefqet Muasarajt për marrëdhëniet e mira të "ballistëve me pulat", ndërkohë që ka marrë përgjigjen se ka vrarë njerëz. Nga ana tjetër debate ka pasur dhe mes Ramës e Milos, ku më së njëherë kreu socialisti i ka kërkuar kreut të PDS që të flasë seriozisht, debate që kanë vijuar dhe pas përfundimit të tryezës së partive. Nga ana tjetër nuk kanë munguar as debatet mes pjetarëve të tjerë të tryezës, ku Milo ka shprehur qartë faktin se nuk e duron Ngjelën, teksa i është drejtuar kreut të PS se pse e merr me vete atë budalla. Ndërkohë që Ngjela ka bërë thirrje që partitë aleate të Berishës të braktisin koalicionin të rrëzojnë qeverinë që të bëhen ndryshimet në sistemin zgjedhor dhe të mos viden me vota e qytetarëve shqiptar. Po japim të plotë të gjitha replikat dhe batuta.



Paskal Milo dhe Edi Rama

uta nuk funksionon.

Alimadhi: Ju z.Rama keni nxjerrë njerëzit zvarrë në burgje. Ty nuk të shkon të shprehesh kështu, lëri pulat. Se ju keni ngrënë koka njerëzish. Këtu e gjete ti të flasësh për ballistët.

Rama: E kam pikë të dobët këtë Ballin Kombëtar.

Alimadhi-Ramës: Pse zgërdhihesh.

Rama-Milos: A mund t'i mbash në rresht ti këta? Se asaj pune s'keni çfarë t'i bëni. Mua nuk ma censuron njeri fjalën.

Alimadhi: Mos u shpreh më kështu se është hera e dytë që merreni me pulat dhe ballistët.

Rama: I paske shënuar?

Ngjela: Mos vendosni kush-

kryeministrin që vjedh votat.

Madhi: Po nuk vete kështu të bëhen vetëm deklarata...

Ngjela: Jam për mazhoritar të pastër, jo për këtë lojë. Manipuluesin e votave e kemi, por s'do e lëmë këtë radhë. Ju nuk ju ka ardhur kryesori. Juja jap unë zgjidhjen, republikanët, LSI dhe tre katër parti rrëzoni kryeministrin dhe shpëtoni gjendjen. Nëse na keni thirrur për t'u tallur, s'na keni kështu.

Milo: Tryeza është mbledhur për të diskutuar për parimet dhe kushdo ka të drejtë të flasë.

Milo-Rusmalit: Do të dëshironim të ishit më të qartë. Nuk na dhatë përgjigje për të gjitha pyetjet që shtruan ne.

Rusmalit: Ju dhashë mbësht-

tesin, e dha mbështetjen e plotë për përmirësimin e sistemit. PD nuk e ka dhënë kërkojeni nga PD.

Milo: I bëj thirrje PS dhe PD që nëse kanë vullnet për të përmirësuar sistemin zgjedhor, të firmosin deklaratën e përbashkët. Nëse jo të na e thonë.

Rama: Ore Paskal, seriozisht e keni këtë që po thoni apo po bëni shaka. Ne e kemi thënë, e thamë dhe do ta themi se mbështesim përmirësimin dhe ndryshimin e ligjit zgjedhor, pa e kushtëzuar me reformën zgjedhore. Mirë parti të aleate opozitare, por tani kanë nisur ta kërkojnë te PS dhe të unë dhe partitë e mazhorancës.

Milo-Ramës për Ngjelën: Çfarë është ai budalla, pse ma sillni këtu. Mos e dëgjoni atë budalla...

Starova: Rama i tha 'po' mbështetjes për përmirësimin e sistemit zgjedhor, PD tha se është 90 për qind dakort për ta diskutuar propozimin tonë. Të reflektohen në deklaratë dhe t'u dërgohet partive për ta firmosur.

Kurt Kola: Këtu duket qartë se kush nuk ka vullnet për të bashkëpunuar, pasi mungon kryetari i mazhorancës. Kryetari i opozitës është këtu në tryezë, e dha mbështetjen e tij për ne.

DEBATET PAS

TRYEZËS

Rama: Ore Paskal, pse fole ashtu në tryezë, ne kemi biseduar dhe kam deklaruar gjithnjë se PS mbështet dhe është dakort me iniciativën e përmirësimit të sistemit siç e kërkonte ju.

Milo: E kemi diskutuar dhe më parë dhe ishte e nevojshme ta thojë këtë.

Rama: Paskal je në rregull apo si. Unë e them publikisht se jam dakord me propozimin tuaj për përmirësimin e sistemit, pra për korrektimin, ti më thua në tryezë se PD e PS duhet të deklarojnë për sistemin. Prandaj po të pyes: Seriozisht e ke ti Paskal?

Milo: Unë kërkoi mbështetje reale në Komisionin e Reformës Zgjedhore që të mos ketë deformim të votës, pra të ketë korrektim të sistemit zgjedhor.

Skema e Tryezës

Rusmali hyn në sallë bashkë me ODIHR Rama me Gjinknurin

TIRANE

Tryeza e djeshme e partive politike për përmirësimin e sistemit zgjedhor të organizuar nga partitë e vogla parlamentare dhe ku ishin ftuar dhe dy partitë e mëdha politike, ka qënë me të vërtetë unike për nga mënyra e skemës si u prezantua që në hyrje të saj. Kështu që në fillim kishin ardhur organizatorët e kësaj tryeze, përkatësisht sekretari i përgjithshëm i PR, Arjan Madhi dhe kreu i PDS Paskal Milo që prisnin në hyrje të sallës së "Sheraton" të gjithë të ftuarit. Të parët kanë ardhur krerët e Ballit Kombëtar dhe përfaqësuesi i PAD. Më pas kanë ardhur Gjinknuri, Koçi dhe njëri pas tjetrit krerët e partive aleate të PS dhe PD. Kreu socialist Rama ka hyrë në ambientet e Sheraton i shoqëruar nga Legjisti dhe Gjinknuri dhe pak para tij ka qënë kreu i PDK Nard Ndoka. Ndërkohë që përfaqësuesi i PD, Ilir Rusmali bashkë me drejtorin e kabinetit të kryeministrin Oerd Bylykbashi. Të cilët kanë qënë bashkë me përfaqësuesin e ODIHR, Dan Radhwford. Ndërkohë që kanë marrë pjesë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, si ish-krerët e KQZ Celibashi



Skënder Gjinushi

dhe Kume, por dhe bashkëshortja e kreut të FRPD, deputetit të PD Gerti Bogdani, që është përsëherë në kreun socialist Rama në sallën ku mbahej tryeza e partive politike. Mënyra e vendosjes së krerëve të partive politike ka qënë e përllogaritur mirë, ku në anën e djathtë të sallës janë vendosur Rama dhe të krerët e koalicionit opozitar, ndërsa në anën e majtë janë vendosur Rusmali dhe liderët e koalicionit të mazhorancës. Ndërkohë që në krye të tryezës kanë qënë Milo dhe Madhi, të dy të vendosur dhe ata sipas krahëve politikë, Milo në anën e opozitës dhe Madhi në anën e mazhorancës. Drejtimi i tryezës është bërë me rotacion mes Madhit dhe Milos, ku vihej re koordinimi dhe rakordimi i saktë mes tyre.

Rama-Spahiut: Ekrem, ti e the dhe vetë se dhe në burg të ka funksionuar partia. Ti mos u qaj dhe mos më ndërprit. Po të ishte kaq i fortë ndërprisje Enver Hoxhën jo mua. Kështu erdhi puna se edhe Balli Kombëtar kërkoi ndihmë nga partitë të majta.

Roshi: Mos trego përralla, keni marrë vota me Kush-tutë apo jo?

Milo: Ju lutem mos replikoni **Rama:** Unë nuk ndërpreva njeri. Zakonisht ju hanit pula, lepuju ju ka mbetur në bark. **Roshi:** Me këto pseudo bat-

te në tryezë.

Madhi: Po u duhet lënë hapësirë të gjithëve të flasin, janë përfaqësues të 23 partive këtu dhe jemi të kufizuar në kohë.

Ngjela: Kemi ardhur për debat nuk mund të më vendosësh kushte. Kemi bërë gabim që kemi ardhur nuk ishte gjë kaq e rëndësishme. Jeni në vetë apo jo, këtu flet njeriu si të dojë. Hajde të bisedojmë na jepni projekte. E vetmja gjë është se na janë vjedhur votat. Këtu kam ardhur të rregulloj

tetjet të pakufishme.

Milo: Mendoj që dy partitë e mëdha të reflektojnë mbi atë çfarë propozojmë ne si tryezë e partive politike, për t'i reflektuar.

Rama: Ore Paskal, çfarë të reflektoj, çfarë të reflektoj PS.

Milo: Ne nuk kërkojmë ndryshime në sistemin zgjedhor me ndërhyrje në Kushtetutë, ne kërkojmë përmirësim brenda këtij sistemi, pasi Rama tha për mosndryshimin e sistemit.

Gjinknuri: Rama e dha konen-



Bashkëpunimi për gjyqësorin shqiptar, Belgjika asistencë

Shqipëria dhe Belgjika do të koordinojnë bashkëpunimin ndërgjyqësor. Alain Bourrier, kryetar i Komitetit të Drejtimit të Shërbimit Publik Federal të Drejtësisë në Belgjikë u takua me ministrin e Drejtësisë, Eduard Halimi, ndërsa nënshkroi protokollim me zv.ministren Brikena Kasmi. Plani i veprimtimit për 3 vitet e ardhshme

mbështetet dhe në angazhimin e qeverisë shqiptare për integrimin në BE si dhe objektivat e ministrisë së Drejtësisë për reformimin e sistemit të drejtësisë dhe luftën pa kompromis kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikëve të paligjshme të çdo lloji. Asistenca belge do të ofrohet gjithashtu në administrimin e të dhënave të dosjeve të bashkëpunimit

gjyqësor ndërkombëtar duke përfshirë edhe aspektin informatik dhe sitemin e mbajtjes së të dhënave. Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë qënë të shqetësuar gjithnjë për reformën në gjyqësor, duke kërkuar përafrimin e legjislacionit me këto vende, por dhe duke hedhur para për financimin e kësaj reforme të rëndësishme për demokracinë e një vendi.

Kryeministri ka garantuar deputetët në grup: Vendimi im, i palëkundur

PANDELI MAJKO:

"Tek busti i Enver Hoxhës mbillet dardhë"



Në Serbi, vakum politik. Në Kosovë, vriten shqiptarë. Në Maqedoni, vriten pesë maqedonas. Në Tiranë, në qendër të saj, janë mbjellë dardha. Të mendosh se tek vendi i bustit të Hoxhës është mbjellë një dardhë... Shprehja popullore "Dardha e ka bishtin prapa" ka shumë kuptime në Ballkan-pazarin politik ku jetojmë". Kjo ka qënë deklarata e ish-kryeministrit shqiptar Pandeli Majko, me të cilën në adresën e tij në rrjetin social facebook ka përmblledhur tërë situatën politike në Shqipëri dhe rajon. Duke e përcjellë me dhimbje dhe ironi tërë atë që po bëhet në këto vende, ku pazari politik është më i vlefshëm se sa marrëveshjes mes politikës në një vend dhe marrëveshjeve mes fqinjëve për ecurinë e popujve që jetojnë bashkë.

Lajmi

Kryeministri Berisha jashtë syrit të kamerave dhe pas daljes jashtë të mediave ka garantuar deputetët e tij se nuk ka lëvizur nga qëndrimi për të patur një president një nga figurat kryesore të PD. Ai nuk ka përfshirë takimin me Nanon por dhe konsultimet me liderët politikë, por vetëm të një kandidatit të PD.

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Kryeministri i vendit Berisha nuk ka mundur të ripërsërisë dhe njëherë se kandidati për President i Republikës do të jetë një nga figurat më të rëndësishme të Partisë Demokratike. Garancinë e radhës kreu i qeverisë dhe i mazhorancës e ka dhënë në mbledhjen e grupit parlamentar të PD, teksa ka shuar të gjitha hamendjet për një tërheqje të mundshme të tij nga qëndrimi i mëparshëm, duket pas zërave që kanë qarkulluar në ambientet e ngushta të demokratëve këto ditë e fundit dhe sidomos pas hyrjes së fortë në lojë të ish-kryeministrit socialist Fatos Nano, në atë tur takimesh me liderët e partive politike. Mes të cilave paralajmëron dhe një takim me liderin e mazhorancës Sali Berisha. "Ju garantoj se kandidati për president i Republikës do të jetë një nga figurat kryesore dhe potenciale të Partisë Demokratike. Nuk ka asnjë tërheqje dhe ndryshim qëndrimi në lidhje me këtë fakt të rëndësishëm që përkon dhe me zbatimin e Kushtetutës së vendit që e ka të përcaktuar qartë si zgjidhet kreu i shtetit. Unë e kam tërhequr se jam i hapur për takime me këdo për të diskutuar në lidhje me këtë proces të rëndësishëm, përfshirë dhe takimin me ish-kryetarin e PS Fatos Nano, i cili e ritheksoj e ka derën të hapur për takim me kryeministrin e vendit. Por nuk përjashtoj as takimin me liderët e tjerë politikë, përfshirë kryetarin e PS, Edi Rama. Ajo që mbetet është konsultimi vetëm për një figurë të PD për president, dhe këtij qëndrimi nuk i lëviz, ju garantoj me siguri", ka qënë deklarata e kryeministrit Berisha në mbledhjen e djeshme

Berisha: Presidenti i PD, s'ndryshoj qëndrim

Kreu i qeverisë: Do të takoj Nanon dhe Ramën



Sali Berisha dhe Astrit Patozi

të grupit parlamentar, menjëherë sapo është mbullur dera dhe mediat janë nxjerrë jashtë. Me sa duket kreu i qeverisë dhe i PD ka dhënë garanci shtesë për deputetët e tij në lidhje me mosndryshimin e qëndrimit për një kandidat të PD për postin e Presidentit, pas dhe kërkësve të ndërkombëtarëve dhe presionit të fortë që po bën Fatos Nano në lidhje me këtë post. Mësohet se në mbledhjen e grupit të PD, përpos kësaj deklarate të Berishës në lidhje me kreun e ri të shtetit, nuk ka pasur diskutime të tjera nga ana e deputetëve në lidhje me këtë

temë, por as për probleme të tjera, për shkak të impenjimeve të kryeministrit. Shqetësimi i deputetëve demokratë me sa duket ka ardhur për shkak të presioneve të forta për një president konsensual nga ana ndërkombëtarëve por dhe për arsye të faktit, se para pesë vitesh, teksa diskutohet kandidatura e Presidentit aktual Topi, ai është tërhequr dhe futur disa herë në garë, për shkak të pavendosmërisë së Berishës për të paraqitur një kandidat të PD për postin e kryetarit të shtetit. Berisha ngurroi para pesë vitesh për shkak të presionit të fortë të

ndërkombëtarëve që kërkonin me insistim një president konsensual, madje u lakuan dhe emra të tillë si ai i gjeneral Arian Zaimi, asokohe atashë ushtarak i Shqipërisë në Bruksel. Por më pas, në garë hynë Topi, Nano por dhe kreu i PAD Ceka, ku me një votim karambolesk Nano u nxor jashtë loje që në rundin e parë, ndërkohë që më pas dhe me votat e gjashtë deputetëve socialistë presidenti aktual Bamir Topi u zgjodh në këtë post. Zgjedhje që u kontestua fort asokohe nga ana e socialistëve duke sjellë dhe dorëheqjen e kreut të grupit Ben Blushi për

shkak të rrjedhjeve të votave, por dhe akuza ndaj Topit për blerje të mandatit presidencial. Ndërkohë që tashmë situata është pëthuhur e njëjtë, ku sërish Fatos Nano po punon fort për t'u zgjedhur President duke kërkuar votat jo vetëm të PS por dhe të partive të tjera parlamentare, ndërkohë që nga mazhoranca janë hedhur në tregun politik kandidatura të tilla të kalibrit të lartë, siç është kryetaria e Kuvendit, njëherësh nënkryetare e PD, Jozefina Topalli, ministri i Financave Ritvan Bode dhe kreu i Komisionit të Jashtëm parlamentar, Fatos Beja. I vetmi ndryshim tashmë është se kryeministri Berisha deklarohet i palëkundur në qëndrimin e tij për një President të PD.

Denoncimi dhe prova

Te Kultura, faqja anglisht "një paçavure"

Ministria e Kulturës ka një paraqitje "skandaloze" në gjuhën angleze të faqes së saj. Këtë e ka evidentuar Edi Rama me batutën për ministrin Bumçi "Baba Nuts Myslymit", por në fakt, më pas e ka hedhur online në rrjet edhe Auron Tare. "Kur dëgjova batutën e fundit të Ramës "Baba Nuts Myslymit" për faqen online të MKRS mendova se po tallej. Për kureshtje e hapa faqen zyrtare të ministrisë. Nuk ishte për të qeshur por për të qarë sesi një ministri kulture e vitit 2012, mund të vendosë



Faksimile e faqes në anglisht të Ministrisë së Kulturës

idiotësira të tilla në anglisht për vizitorët e huaj. Është e turpshme që një djalë i ri nga Tirana, me kollare dhe parfum, mund t'i lejojë një Institucioni që drejton një prezantim aq të turpshëm në një anglishtë të përcjellur. Gjykoni vetë se çfarë karagjozliqesh shkruhen: Faqja e pare: Minister expects Bumci Weightlifting Team. Faqja e dyte: Presented in GKA 5 bocet for 100 Monument of Independence Anniversary shkruan Tare. Por ka edhe gafa të tjera si kjo: "Material cultural heritage is the wealth

of generations, their major obligation towards the past and the future of every nation sequence material. As such, cultural heritage materials is a challenge in front of the intense national and international care, to reach the trail of genius krijues mbarëshkullorë and forward it to the future, to new generations", ku anglishtja dhe shqipja, janë përzierë në mënyrën më të pabesueshme. Pas publikimit të skandalit në rrjetet sociale, si në Facebook, në 23.23, Ministria e hoqi faqen anglisht.



Shtyhet Komisioni i Sigurisë, Lutaj në Fier për Këshillin e Qarkut

Komisioni i Sigurisë ku pritej të shqyrtoheshin relacionet për nxjerrjen në rezervë të tre ushtarakëve është anuluar, për tu zhvilluar në një ditë tjetër. Deputeti i Partisë Socialiste, Piro Lutaj, i cili është edhe autori i relacionit, ku radhiten shkëljet e Ministrisë së Mbrojtjes, është zhvendosur në qytetin e Fierit për të ndjekur punimet në Këshillin e Qarkut,

Fier. Në këtë komision do të përplasen dy relacionet për nxjerrjen në rezervë të tre gjeneralëve, mendimet pro dhe kundër zbatimit të ligjit nga ministria e Mbrojtjes. Gazeta SHQIPTARJA.com ka siguruar ditë më parë të dyja relacionet e përgatitura nga deputeti socialist Piro Lutaj dhe nga deputeti demokrat Luan Skuqi. Gjatë interpretimit të nenit 10, të ligjit për

Gradat, Lutaj i kërkoi ministrisë që të nxjerrë në rezervë edhe tre gjeneralë, disa kolonel dhe nënkolonel, pasi sipas tij është shkelur ligji i Gradave. Deputeti Skuqi, i vendosur në krah të ministrit ka përcaktuar si ligjore nxjerrjen në rezervë të tre gjeneralëve. Pritet që diskutimet të jenë më të ashpra, pasi do të jenë edhe deputetët e tjerë që do të ndërhyjnë me mendimet e tyre.

Projektligji për mbrojtjen e të dhënave, kërkohen sanksione

“Të dhënat personale të dënohen gazetarët”

Komisioni i Ligjeve, debati Rusmajli-Çabej

Lajmi

Komisioni i Ligjeve ka kërkuar që të sanksionohen përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale nga gazetarët në media. Kryetari Ilir Rusmajli, kërkoj ndryshime në nenin 9, pasi me atë nen të projektligjit autorizohen gazetarët të përdorin të dhënat personale si të duan.



Komisioni Parlamentar i Ligjeve

■ ■ ■ TIRANE

FERNADA GENKO

Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale ka ngjallur debate në Komisionin e Ligjeve, për sa i përket përdorimit të këtyre të dhënave nga gazetarët. Kryetari i këtij komisioni, Ilir Rusmajli ka kërkuar ndryshime në këtë projektligj, sipas tij, nëpërmjet disa neneve i jepet autorizim gazetarëve për të përdorur të dhënat personale të personave, pa marrë pëlqimin nga ata. Në këtë aspekt, ai ka kërkuar që të sanksionojë kontrolluesit që përdorin të dhënat personale. Sipas Rusmajlit, etika e gazetarit respektohet nga vetë ata, por nuk ka asnjë detyrim ligjor për të mos e përdorur në rastet kur do. Në këtë kuadër, ai ka kërkuar ndryshime, pasi me miratimin e këtij ligji çdo gazetar mund t'i përdorte të dhënat, pa u sanksionuar.

DEBATET NË KOMISIONIN E LIGJEVE

Rusmajli: Marrim një kauzë. Një fëmijë 6 vjeç përdhuhet në një zonë x, është lajm. Gazetari është i lirë të jap lajmin. Gazetari ka të drejtë që të japë në liri të plotë dhe gjithë detajet e fëmijës së përdhunuar, emër, mbiemër, adresë. Pra nuk mbrohen nga ky ligj, sepse neni 11, që keni vendosur ju, i jepni liri të plotë gazetarit për të shkruar. Ky është kuptimi i nenit?

Çabej: Vetëm një gjë të vogël, në lidhje me paragrafin

e parë është standarti që po flasim. Për këtë e ke fjalën? Nuk kemi prekur asnjë gjë. Se në lidhje me paragrafin 9, është standarti i vendosur fjalë për fjalë ligji. Ne kemi sjellë vetëm paragrafin e dytë.

Rusmajli: Unë e kam me paragrafin e parë, po të doni lidhni edhe me të dytin. Kautiza është e plotë; Liria dhe e drejta e tyre absolute për të mos respektuar të dhënat e tyre personale, thotë paragrafi i parë, edhe kur ato janë sensitive. Bie poshtë ky ligj për hir të lirisë së shtypit, thotë paragrafi i parë. E kam kuptuar drejtë, në rastin e atij fëmijës që përdhuhet në vendin x? Kjo është? Që gazetarët kanë të drejtë të japin gjithçka pa u kujdesur për të dhënat personale?

Çabej: Keni shumë të drejtë, në këto dy vjet kemi dhënë rekomandime të panumërta për

mediat tona, pikërisht me abuzimet seksuale për një minor, për personat në nevojë dhe kemi gjetur mirëkuptimin e medias për këtë, janë shprehur vetëm me iniciale. Dhe ju kemi kërkuar që të jepen të dhëna vetëm për qëllimin e kronikës, dhe jo me detaje. Për të gjitha këto kemi gjetur mirëkuptimin e gazetarëve, dhe është pika dy që e fut në kontroll dhe median, por duhet të ngulur këmbë që media të ketë ligjin e vetë, të ketë kapitullin e saj të privatësisë brenda, të ketë urdhërin e gazetarit, kodin etik. Në një fjalë kontrolluesi media të ketë vetëkontrollimin. Megjithatë kjo është futur në pikën dy. E thotë edhe ju, që mediat do të kenë sanksione. Që ky ligj sanksionon kontrolluesin, jo personin e të dhënave personuale, as përpunuesin jo.

Çdo gazetar që nuk njeht etikën profesionale, dhe etika profesionale është një gjë që i përket sferës së vetërregullimit dhe nuk është detyrim ligjor, mund të bëjë pazarlliqe me këtë autorizim që i jepni ju.

Nysi: Zoti kryetar, ky është një nen shumë i rëndësishëm raporti i shprehjes dhe përpunimi i të dhënave personale. Kam një sygjërim: Paragrafin e parë e ndajmë në dy pjesë. Pra të qëndrojmë pjesa e parë, siç ka qenë në ligjin ekzistues dhe pas fjalës së të drejtës së shprehjes

të vëmë pikë dhe të fillojmë: Kontrolluesi i garanton subjektit të të dhënave në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe ruajtjen e jetës private dhe personale, dhe për të tretën hajde ta diskutojmë do e lëmë këtu, apo do e çojmë në fund. Pra paragrafi i parë siç është formuluar ka një paqartësi, sepse është fjalia shumë e gjatë. Dhe e dyta kam një pyetje, çdo të thotë ruajtje të mjaftueshme të të dhënave personale? Se ne e diskutuam edhe më parë. Këtu ju jepni edhe shembuj.

Çabej: Duhet bërë një balancim i mirë mes lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së jetës private. Të dyja do të jenë në një balancim ekzakt. Ndaj jam dakord me ju ta ndajmë këtë në dy pjesë, që të jetë më qartë dhe ta formulojmë më mirë.

Rusmajli: Unë kam përshlytjen se neni 9 ka nevojë të shihet. Për mua nuk ka pikë diskutimi, nëse është në ligjin aktual, apo jo. Ju thoni për qëllime të gazetarisë... Nuk ka më mbrojtje më të të dhënave personale, neni 5. Dhe ju thoni përjashtohet nga neni 5, nëse jeni tek gazetaria. Pra nuk ka më detyrim gazetari që të marrë pëlqimin e subjektit për përpunimin e të dhënave të veta personale. Nuk ka më kriter ligjor për përpunimin e të dhënave në gazetari, mund të bësh çfarë të duash me to, dhe nuk ke detyrim ligjor lidhur me përpunimin. Nuk ka më transferim në kombëtar. Nuk ka më detyrim për informim të subjektit që i përpunohen të dhënat, nuk ka më përgjegjësi për të njoftuar subjektin dhe nuk ka më konfidencialitet të të dhënave. Fjalia e parë e këtij neni thotë: Ligji bie.

Nuk ka më ligj, dhe pastaj thuhet, vetëm mbrojtja e këtyre të dhënave, sipas këtyre diskutimeve, vetëm nëse kontrolluesi garanton të drejtat subjektit të të dhënave në lidhje me mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe ruajtjen e mjaftueshme të jetës personale.



Ilir Rusmajli

Nuk mund të thuhet njëkohsisht që ligji bie dhe qëllimi i ligjit rri. Se në qoftë se ti e ke përjashtuar veprimin e ligjit kur bëhet fjalë për gazetarinë, ti nuk mund të thuash qëllimi rri. Këto nene janë për këtë qëllim, këto nene i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit njerëzor dhe ruajtjes së mjaftueshme të jetës personale. Vetëm këtë qëllim kanë këto nene. Nëse ti i shfuqizon tek gazetaria, nuk e ruan dot qëllimin e tyre. Jo çdo subjekt duhet të mbrohet. Unë nuk po kërkoj që ju të mbronin njerëzit publik, se njerëzit publik imazhin e tyre e kanë publik. Një imazh publik, nuk është më personal. Ose në rrethanat të caktuara nuk është privat. Kur thuhet e drejta për informim prevalon në raport me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale për personat publikë, kur këta persona ushtrijn funksione publike. Po të thuhet për shkak të informimit, apo të gazetarisë bie ky ligj, i bie të thotë më shumë se çka thotë sot praktika e vendeve europiane. Dhe kauza që unë solla nuk mbrohet më. Çdo gazetar që nuk njeht etikën profesionale, dhe etika profesionale është një gjë që i përket sferës që i përket vetërregullimit dhe nuk është detyrim ligjor, mund të bëjë pazarlliqe me këtë autorizim që i jepni ju. Çdo gazetar që njeht etikën profesionale mbrohet individ, por i mbrohet për shkak të etikës profesionale, jo për shkak të autorizimit që i jepni ju. Çdo gazetar që njeht etikën profesionale ka rënë në momentin që ne e miratojmë. Unë them ta mbylлим, edhe me miratimin e deputetëve. Faleminderit!

LAJME SHKURT

Meta në Pulia, kërkon mbështetje për gazësjellësin e TAP

Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integritim, Ilir Meta ka futurur drejt Italisë për të zhvilluar një vizitë në rajonin e Pulias ku u takua me presidentin e këtij rajoni, Niki Vendola. Kreu i LSI falenderoi Vendola-n për kontributin në Shqipëri ndërsa cilësoi se rajoni i Pulias është i rëndësishëm për Shqipërinë. Meta theksoi në këtë takim dhe mbështetjen që duhet për gazësjellësin e TAP. Nga ana e tij presidenti i Rajonit të Pulias, Vendola vlerësoi rolin e Metës në forcimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Pulias. Me tej Vendola i shprehu Metës se 'jemi krenarë për komunitetin shqiptar në Itali'.

Topi nderon kampionin Qerimaj

Presidenti i Republikës, Bamir Topi nderoi kampionin e Evropës në peshëngritje, Erkan Qerimaj, me Urdhrin "Mjeshtër i Madh". Në këtë ceremoni dekorimi merrnin pjesë personalitetet të shquara të fushës së sportit, artit e shkencës, trajnerë, peshëngritës, miq e familjarë. Në ceremoninë zyrtare të zhvilluar në mjediset e Institucionit të Presidentit, Qerimaj iu dorëzua urdhrin "Mjeshtër i Madh", me motivacionin: "Për kontribut të shquar në sportin e peshëngritjes, si fitues i dhjetëra medaljeve ndërkombëtare e spalljes kampion i Evropës për vitin 2012".



Flora Çabej



Braçe: Berisha gënjen, Tiranë-Elbasan po bëhet me kredi

Deputeti i Partisë Socialiste, Erjon Braçe ka replikuar në distancë me kryeministrin Berisha. Në rrjetin e tij social "Facebook", Braçe duke u nisur nga deklarata e Berishës "se opozita nuk votoi rrugën Tiranë-Elbasan" e ka kundërshtuar duke shkruar se "Kjo rrugë nuk po bëhet me paratë e buxhetit të shtetit". Ai pohon se kjo rrugë bëhet jo me lekë të taksapaguesve

shqiptarë, por me kredi. Braçe u shpreh se shuma prej 280 milionë lekë është marrë borxh nga Banka Islamike. "Jo! Për rrugën është marrë një borxh nga Bankat Islamike që arrin në mbi 280 milion dollarë! Borxhi është ndarë në disa marrëveshje, të gjitha të votuara nga socialistët në Kuvend! Pra Berisha, burri më i poshtër që ka patur mbi krye çdo shqiptar ndonjëherë, gënjeu!",

është shprehur ai. Duke e konsideruar Berishën si burrë pushteti, Braçe tha se "Sot inaguroi nisjen e trasesë së rrugës Tiranë-Elbasan! Më herët kishte inaguruar vrimën e parë; pas disa javësh shkoi dhe inaguroi vrimën e dytë! Pas disa javësh do shkojë të inagurojë nisjen e trasesë së rrugës Elbasan-Tiranë!", shprehet Braçe në rrjetin social "Facebook".

Pronat, shtyhet afati i kthimit dhe kompensimit deri në 2014

Braçe: Pronat, po anashkalohet Kuvendi

Ish-pronarët edhe 2 vjet shpresë për të marrë tokat

Lajmi

Partia Socialiste ka kundërshtuar projektligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave. Maxhoranca miratoi një ndryshim të ri në Ligjin për Pronat, i cili e anashkalon Kuvendin nga vlerësimi i vlerës së pronave, për efekt të kthimit dhe kompensimit. PS apsteno në votim.

■ ■ ■ TIRANË

FERNADA CENKO

Shtyrja në afat e kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe anashkalimi i Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e pasurisë, kanë qenë debatet ku është fokusuar shqyrtimi i projektligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës. Pas një prezantimi të ligjit nga përfaqësuesja e ministrit të Drejtësisë, Elona Syla, deputeti i Partisë Socialiste Erjon Braçe i ka kërkuar shpjegime pse është anashkaluar Kuvendi i Shqipërisë. "Cila është arsyeja që i hiqet kompetenca Kuvendit për vlerësimin e pasurisë dhe i kalon qeverisë? Sipas ligjit ekzistues, ishte Komiteti i AKKP-së që merrej me ndarjen e tokës dhe miratohet nga Kuvendi", është shprehur Braçe. Ndërsa për deputetin Mimi Kodheli shtyrja e afatit ishte e detyrueshme, pasi ka lidhje me fushatën elektorale për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Por sipas ministrit, këto dy ndryshime vijnë në favor të pronarëve, pasi do të jepet një vlerë reale për pronën e tyre. Ligji i ri shtyn afatin për kthimin dhe kompensimin e pronave, deri në prill të vitit 2014, pasi qeveria nuk ka arritur të përgatisë fondin fizik për kompensimin, edhe pse afati ishte fundi i vitit të kaluar.

DEBATET NË KOMISIONIN E EKONOMISË

Elona Syla (Përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë): Kjo iniciativë ligjore ka si qëllim krijimin e një harte unike të vlerës, e cila duhet të reflektojë në mënyrë reale vlerën e tregut duke garantuar të njëjtën sa me efektive të drejtat e pronësive bazuar në standarde ndërkombëtare të përdorura në vlerësimin e pasurive të paluajtshme. Së dyti



Komisioni i Ekonomisë

me anë të këtij projektligji synohet që të shtyhet afati i procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës nga data 30.11.2011 në 30.4.2013, duke mundësuar trajtimin nga AKKP të gjithë kërkesave të paraqitura pranë saj si dhe atyre që vijnë për shkak të vendosjes në afat të atyre që vijnë nga gjykata. Gjithashtu parashikohet edhe shtyrja e afatit të miratimit të fondit të pronave dhe pasurive të paluajtshme shtetërore që vihet në dispozicion të AKKP për kompensim fizik duke e lidhur ngushtësisht

këtë ndryshim me përfundimin e regjistrimit fillestar, i cili parashikohet të përfundojë brenda vitit 2013. Një tjetër ndryshim lidhet me krijimin e një strukture të posaçme, e cila do koordinojë punën e gjithë institucioneve shtetërore të përfshira në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave. Ngrija e kësaj strukture është parashikuar të bëhet pranë MD-së, duke lehtësuar procesin e vendimmarrjes në fushën e pronësive ku përfshihen shumë aktorë shtetërorë.

Erjon Braçe: Në nenin 1/3.

Cila është arsyeja që i hiqet kompetenca Kuvendit për vlerësimin e pasurisë dhe i kalon qeverisë? Sipas ligjit ekzistues, ishte Komiteti i AKKP që merrej me ndarjen e tokës dhe miratohet nga Kuvendi. Pse u shty afati? Fondi është krijuar për të gjitha llojet e pasurisë dhe çfarë e pengon në bazë ligjore dhe vetekzistencës së pronësive?

Mimi Kodheli: Afati pse është kaluar. Kjo na lë në dyshim, sepse jemi afër fushatës elektorale.

Elona Zylaj: Ligji i vitit 2004 ka patur Komitetin e Kompensimit të Pronave, tashmë është Agjencia e Kompensimit të Pronave, e cila është në varësi të ministrit të Drejtësisë dhe vendimet miratohen nga KML-ja. Të gjithë pronat janë duke u verifikuar dhe për këtë është shtyrë afati. Nga viti 2011-2012, ministria e Drejtësisë ka zhvilluar strategjinë e trajtimit dhe të kompensimit të pronave, dhe kjo të kryhet brenda vitit 2014.

Juris Avonitis (Këshilltari në Ministrinë e Drejtësisë): Ekziston mënyra për të vendosur metodologjinë në ligj. Metodologjia e vendosjes së çmimit të tregut është thelbësisht e çështjes.

Mimi Kodheli: Vlera do afektojë edhe faturat e individëve?

Erjon Braçe: Minimumi që duhet bërë është që të paktën të stopohen këto aksionet e tjera, që këtë lloj pasurie e transferojnë diku tjetër, qoftë edhe në vartësi të organeve të pushtetit vendor, apo e ndalojnë organet e pushtetit vendor që këtë lloj pasurie të vënë në dispozicion, pikërisht për këtë gjë ta marrë edhe ta transferojë qoftë edhe në formën e dhënies në përdorim, mbi të cilën pastaj kryhen investime të tjera, që do të jetë e vështirë, t'u marrësh atyre njerëzve që investojnë mbi të.

Elona Zylaj: Në AKKP po trajtohen 6000 kërkesa fillestare. Shtyhet afati i shqyrtimit, dhe jo i kërkesave.

Erjon Braçe: Diskutimi është parimor. Nuk mundet të përcaktojë vlerën e pronës sime, një institucion, i cili ka marrë përsipër detyrimin që të më kompensojë pronën që kam patur. Nëqoftëse me ligj detyrimin për të kompenzuar në vlerë në natyrë, e ka marrë qeveria, natyrisht që nuk mundet që qeveria të bëjë vetëvlerësimin e pronës sime, pavarësisht standardeve që do të aplikojë, prandaj është vendosur Parlamenti më herët, prandaj duhet të jetë përsëri Parlamenti, për ta miratuar si një institucion.

Diskutimi, në gjithë vendin

PS, Qato: Skema jonë për pronat e legalizimet

■ ■ ■ TIRANË

Partia Socialiste në rrugën e Proqramit "Për një Rilindje Shqiptare" ka zhvilluar deri tani 18 tryeza, ku një prej tyre ka qenë dhe tryeza për pronat. "Zgjidhja e problemit të titujve të pronësive dhe sigurisë së këtyre titujve është një nga çështjet më të rëndësishme që qëndrojnë në themel të të katër shtyllave të "Rilindjes Shqiptare". Nuk ka zhvillim ekonomik pa u zgjidhur çështja e pronës, dhe PS ka marrë përsipër ta zgjidhë atë. Nuk ka qetësi sociale, pa u zgjidhur çështja e pronës e PS me Programin e saj ka marrë përsipër për ta zgjidhur atë", është shprehur kryetarja e Grupit të punës në PS të Programit për



Merita Qato

Pronat, Merita Qato. Sipas saj, s'ka një shoqëri demokratike dhe shtet ligjor nëse nuk luftohet korrupsioni dhe nuk shkon prona te i zoti dhe po ashtu një nga 12 rekomandimet e Bashkimit Europian për vendin është zgjidhja e problemit të pronës. "Çështja e pronësive e cila prek të katër shtyllat e programit të PS, do të vijojë të diskutohet në të gjithë Shqipërinë. Duke i zhvendosur këto tryeza në rrethet e ndryshme të vendit ku problemet e pronësive janë shumë të mprehta, konkrete dhe jo rrallë kanë shkakuar konflikte sociale", tha ajo. Sipas Qatos, grupi i punës për çështjet e pronës do të paraqesë një draft të Programit duke dashur të tërheqë mendimin e grupeve të interesit, por edhe të individëve të cilët kanë

interesa direkte për problemet e pronësive. Drafti i Programit propozon zgjidhje për çështjet më të prekushe, siç janë kthimi i pronës, legalizimet, regjistrimi i pasurive të paluajtshme, komisionet e titujve të pronësive, pasuritë e paluajtshme, si dhe gjithë problematikën në lidhje me këtë çështje. "PS në çdo hap të rrugës së Programit për pronësinë do ta bëjë në transparencë të plotë e në bashkëpunim të ngushtë me grupet e interesit ndaj i fton ata të jenë kontributorë dhe faktorë të rëndësishëm në këtë proces për t'i dhënë zgjidhje kësaj problematike sa shqetësues aq edhe madhore për integritimin e vendit", tha Qato.

j.a.n.a

KLSH dhe gjashtë OJF, marrëveshje antikorrupsion

Dje u nënshkruan gjashtë marrëveshje bashkëpunimi mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe disa prej organizatave joqytetërore më të spikatura të vendit në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës. Këto janë lëvizja "Alternativa Civile", e drejtuar nga Mentor Kikia, "Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë", e drejtuar nga Sami

Neza, "Instituti i Studimeve Bashkëkohore", i drejtuar nga Artan Hoxha, "Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim", i drejtuar nga Sotirag Hroni, "Transparency Internacional në Shqipëri", drejtuar nga Lutfi Dervishi dhe "Lëvizja Evropiane Shqipëri", drejtuar nga Gledis Gjipali. Marrëveshjet lidhen nën moton e Organizatës Ndërkombëtare të

Institucioneve të Larta të Auditimit, INTOSAI, "Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve" dhe synojnë kontribute dhe aktivitete të përbashkëta të KLSH-së dhe shoqatave, si vrojtime, prognoza dhe studime, pjesëmarrje reciproke në seminare, simpoziume, konferenca, në luftën kundër korrupsionit, si dhe rritjen e transparencës së institucioneve.

Fondi, raport i ministrit italian për Shqipërinë

FMN: Shqetësues deficiti korrent

Bode: Ritmet e rritjes janë në ulje

Lajmi

Raporti vjetor i FMN-së për Shqipërinë, hartuar nga ministria italiane e Financave, shpreh shqetësimin e këtij institucioni lidhur me ngërçin në ndërtim, deficitin e madh të llogarisë korrente, si dhe uljen në nivele rekord të inflacionit, si shenjë e rënies së konsumit në vend

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Konsumi vendas dhe investimet në Shqipëri janë të dobëta, kryesisht si pasojë e një ndryshimi të qendrimit të konsumatorëve dhe investitorëve në drejtim të një maturie më të madhe dhe pjesërisht si pasojë e paqartësisë në tregjet financiare ndërkombëtare. Ekonomia shqiptare është mbajtur kryesisht me rritje e industrive që lidhen me eksportin dhe shërbimeve që lidhen me turizmin, ndërkohë që sektori i ndërtimit vazhdon të jetë në një situatë të vështirë si pasojë e moskryerjes së pagesave për punën e mbaruar dhe rënies së kërkesës për banesa.

Këto konsiderata përfshihen në raportin mbi Sh-

qipërinë, që i është paraqitur Fondit Monetar Ndërkombëtar këto ditë në Uashington dhe përgatitur nga ministria e Financave e Italisë, që mbulon edhe vende të tjera, si Greqinë, Portugalinë, Maltën, etj.

Sipas raportit, shqetësim të konsiderueshëm përbën niveli i lartë i deficitit të llogarisë korrente, ndërkohë që janë ngushtuar mundësitë e

të ardhurave buxhetore, kështu që qeveria, për të rregulluar situatën e saj me borxhin publik, është e detyruar të bëjë shumë shkurtime të shpenzimeve.

BODE

Nga ana e tij, në një intervistë në "Zërin e Amerikës", ministri shqiptar i Financave Ridvan Bode u shpreh se "qështja e borxheve meri- ton të jetë në qendër të vë-

mendjes nga ana e qeverisë, për ta zvogëluar atë. Për ekonominë shqiptare sfida është se janë zvogëluar ritmet e rritjes ekonomike", tha ai. Sipas Bodes, "raporti i borxhit publik me PBB-në është 58.7 për qind, e kemi relativisht të lartë krahasuar me rajonin. Por, nga ana tjetër, nuk kemi rritje të kostonë së borxhit, ajo është më e ulët se në vitet 2005-2006. Janë

marrë kryesisht borxhe të jashtme nga banka të zhvillimit, me interesa të ulta dhe afate të gjata shlyerjeje".

KOSOVA

"Zëri i Amerikës" e ka pyetur ministrin për problemet me tenderimin e linjës së interkonieksionit me Kosovën. Ai tha se janë marrë tashmë 110-120 milionë euro kredi nga KfW, për zhvillimin e energjetikës në vend. Ka patur takime të drejtorit të OST-së me gjermanët, ndërkohë që është bërë presion nga qarqe të interesuara që të fitonte një subjekt i caktuar, pavarësisht nga çmimi i lartë, rreth 33% më shumë se subjekti i dytë, tha ministri.

Interkonieksioni

Ministri Bode ka theksuar se është bërë presion nga qarqe të interesuara që të fitonte një subjekt i caktuar në linjën me Kosovën, pavarësisht nga çmimi i lartë, 33% më shumë se subjekti pasues



Investimi

Banorët e Bërzhitës, protestë për çmimin e shpronësimeve

■ ■ ■ TIRANE

Banorët e komunës Bërzhitë janë shprehur dje kundër çmimit që qeveria u ka dhënë për kompensimin e pronave të tyre, që do të prishen për shkak të ndërtimit të rrugës së re nacionale Tiranë-Elbasan. Në një protestë, të organizuar prej tyre në rrugën aktuale, ata theksuan se çmimi prej 300 lekësh për metër katror është tejet qesharak, ndërkohë që shumë nga ata pranonë tokash që preken nga ky ndërtim nuk figurojnë në listën e të dëmshpërblyerëve. "300 lekë janë poshtërsi, është marrje nëpër këmbë e dinjitetit. Çmimi i tregut është e pakta 800 lekë, të na jepet minimumi 500 lekë për një metër katror tokë", tha një banor, pjesëtar i kësaj proteste. Disa të tjerë theksuan,



nga ana tjetër, se këtë kompensim ata duhej ta merrnin që pa filluar ende punimet, por këto kanë filluar dhe ata s'kanë marrë ende asnjë lek nga institucionet përkatëse, çka përbën një sh-

kelje të të drejtave të tyre kushtetuese.

"Këtu, në këtë tokë, do të vdesim të gjithë. Mua më ikën dy dynym tokë. Këtu do të vdes, në tokën time", theksoi dje një nga banorët protestues.

Kjo protestë shpreh një tjetër realitet, krahas bujës spektakolare të përrimeve nga ana e kryeministrit dhe anëtarëve të tjerë të qeverisë së tij. Ende në rrugën që lidh Shkodrën me Hanin e Hotit vijojnë pa ndërprerje protesta të banorëve, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin dhe nuk kanë me se të jetojnë. Kjo situatë po ndodh edhe me HEC-et vendore, ku konsencionarët po përballen me pronarët e tokës, pasi qeveria nuk ka kryer dëmshpërblimin e tyre. Kursimi i shpenzimeve buxhetore nuk mund të prekte kurrësi investimet, si në këtë rast.

Njoftim punësimi

Grupi Mediatik "Free and Fair Media Group"

kërkon:

Menaxher shitjes në fushën e reklamave

Kërkesa të nevojshme për aplikuesin:

- ✓ Të jetë i pajisur me Diplomë Universitare. Përparsi do të kenë kandidatët të cilët janë të lidhur me fushën e marketingut.
- ✓ Të ketë eksperiencë pune në pozicione të ngjashme në fushën e medias.
- ✓ Të ketë aftësi shpirtërore dhe menaxheriale të larta
- ✓ Të jetë i komunikueshëm, të dijë të punojë në grup dhe të menaxhojë me efikasitet rrethin e klientëve të kompanisë.
- ✓ Preferohet të ketë njohuri në gjuhën angleze dhe italiane.
- ✓ Të njohë programet bazë office dhe njohuri mbi internetin.

Të interesuarit janë të lutur të dërgojnë kërkesën dhe C.V në adresën e e-mailit: marketing@shqiptarja.com

Shkrimi për energjinë vazhdon bllokimi i "Zërit" në Shqipëri

Për më shumë se një javë, faqja online e të përditshmes kosovare "Zëri" (<http://www.zeri.info/>) nuk mund të vizitohet nga qytetarë të territorit të Shqipërisë e më gjerë. Kurse në Kosovë, faqja funksionon normalisht. Një "problem" i tillë erdhi një ditë pas botimit të artikullit me titull "Sali Berisha, me mafian serbe kundër Kosovës". "Faqja për momentin nuk hapet në vendet jashtë Kosovës, si pasojë e sulmeve nga

persona ende të panjohur në drejtim të faqes sonë. Sulmet ndaj nesh kanë nisur pas publikimit të shkrimit me titull "Sali Berisha, me mafian serbe, kundër Kosovës" në gazetën "Zëri", dhe që nga ajo kohë, faqja ka funksionuar me probleme të vazhdueshme" thuhet në një reagim të "Zëri-t". "Informata të sakta se nga kush vijnë sulmet, ende nuk kemi, mirëpo jemi duke u marrë me këtë çështje shumë

seriozisht". Në artikullin e shkruar nga Enis Veliu, kryeministri i Shqipërisë akuzohet se "ka më shumë se një vit që ka bllokuar projektin për ndërtimin e linjës 400 kilovoltëshe të interkonjeksionit, e cila lidh Kosovën me Shqipërinë". Bllokimi që "i ka siguruar shtetit të Serbisë monopol në importin e energjisë në Kosovë, pasi për momentin Kosova të vetmen rrugë për import të energjisë ka fqinjin verior".

Grupi EFT krenohet në Beograd me linjën e trasmetimit

Energjia, serbët fituan linjën me Malin e Zi

Financimi gjerman u inaugurua në gusht 2011

Lajmi

Grupi energjitiko-financiar serb EFT, i përfolur javët e fundit për linjën e energjisë me Kosovën, më pak se një vit më parë ndërtoi linjën e interkonjeksionit mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, me vlerë prej 43 milionë eurosh, po financim i bankës gjermane KfW, sipas vetë dokumenteve të grupit të prezantuar në Beograd.

■ ■ ■ TIRANE

ARBEN RROZHANI

Capital investments in infrastructure projects

Transmission

Recently built interconnection overhead lines:

- Hungary-Romania, 400 kV Bekescsaba-Nadab-Arad, December 2008
- Bulgaria-FYROM 400 kV Chervena Mogila-Stip, year 2009
- Hungary-Croatia, 400 kV Pecs-Ernestinovo, November 2010

- **Montenegro-Albania, 400 kV Podgorica-Tirana/Elbasan, May 2011**

Generation Capacities

In last 3 years only couple of mid-size hydro power plants was commissioned (~100 MW), a number of wind farms (~1000 MW), but main investments was in gas-fired power plants (some of them are CHP). Installed capacity of CCGT plants built since 2009 is:

- 1700 MW in Greece,
- 100 MW in Croatia,
- 220 MW in FYROM,
- 860 MW in Romania,

but gas supply (redundancy of supply route) and (long-term) price issues remains open...

❖ Excess of Generation Capacity is absolute prerequisite for the competition and functional (regional) market(s)!



Vuk Hamović, drejtues i EFT

Në foto: Në faksimile: Shpallja e rezultati fitues që vetë kompania serbe EFT ka bërë në sitin e vet zyrtar për linjën e interkonjeksionit me Malin e Zi

HETIME NË OST

Linja me Kosovën, KLSH nis kontrollin


Kontrolli i Lartë i Shtetit po heton çështjen e ndërtimit të linjës së interkonjeksionit Shqipëri-Kosovë. Kjo u bë e ditur gjatë një marrëveshje që KLSH nënshkroi me shoqërinë civile për bashkëpunim në shkëmbimin e informacioneve dhe ekspertëve për të luftuar korrupsionin. Kryetari i këtij institucioni, Bujar Leskaj, u shpreh se një ekip ndodhet aktualisht në OST, ku po hetohen procedurat e ndjekura.

Linjat Lindje-Perëndim

Interkonjeksioni, energji të lirë nga Italia

Debati për linjën e interkonjeksionit Shqipëri-Kosovë, është real dhe nëse ai do të mbyllet sipas parashikimeve, Kosova do të ishte e pavarur nga energjia që merr nga Serbia. Sepse krahas linjës mes dy vendeve shqiptarë, do të ndërtohet edhe linja e nënujore e energjisë mes Italisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë, duke e hapur tregun energjetik Italian për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe duke e hequr nga varësia e importeve energjetike të kompanive serbe, siç është EFT. Sipas dokumentit të shtatorit 2007 për linjën e interkonjeksionit mes Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe linjës Maqedoni, Shqipëri-

Itali, aty parashihet kompletimi i lidhjes energjetike mes vendeve plotësisht, deri në 2020. Linja e interkon-



Faqja e parë e projektit për linjën me Kosovën dhe Italinë

jeksionit mes Shqipërisë dhe Kosovës, e vlerësuar në 39 milionë euro, është e gjatë 239 kilometra, nga të cilat 85,5 km janë nga Kosova B deri në kufirin shqiptar dhe pjesa tjetër në Shqipëri. Sipas dokumentit, të mirat e linjës së interkonjeksionit do të ishin të shumta, siç është ulja e ndjeshme e kostove dhe shkëmbimi i ndërsjellë.

Më pas do të vinte projekti i kablrit nënujor mes Maqedonisë-Shqipërisë dhe Italisë, me një vlerë prej 450 milionë eurosh. Për këtë do të lidhet linja nga manastiri i Maqedonisë në Elbasan, rreth 128 km, Elbasan-Durrës rreth 70 km dhe më pas kablri nënujor për në Foxhia (Itali) rreth 330 km.

Malit të Zi Vuica Llazović ishte edhe Ministri për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim i Republikës Federale të Gjermanisë, Dirk Niebel. "Ky interkonjeksion mbyll rrjetin unazor 400 kv në territorin tonë për rajonin e Ballkanit. Ne kemi resurse të mëdha hidroenergjetike dhe jemi një Norvegji e dytë në Europë", ishte shprehur Berisha. Projekti i interkonjeksionit konsistonte në

ndërtimin e linjës 400 kv mes nënstacioneve Tirana 2 dhe Podgoricës. Linja ka një gjatësi prej 155 km nga të cilat 125,5 km në territorin të Shqipërisë. Pjesa e linjës nga Tirana deri në Vaun e Dejës (rreth 80,5 km) është ndërtnuar me shtylla për dy qarqe, për të qenë e gatshme për linjën 400 kv Tirana-Kosova B. Kjo linjë është pjesë e interkonjeksionit 400 kv Elbasan-Tiranë-Podgoricë dhe

ka një impakt të madh në rrjetin e mundësisë teknike të shkëmbimit të energjisë elektrike mes sistemit tonë dhe vendeve fqinje por dhe një impakt rajonal. Kjo do krijojë mundësinë e importit të energjisë së kërkuar në kohën e duhur dhe mbulimin e kërkesave për energji elektrike në çdo kohë. Ndërtimi i kësaj linje është një nga kushtet që OST të bëhet anëtarë me të drejta të plota

të rrjetit europian të operatorëve të sistemit të transmetimit për energjinë elektrike (ENTSO-E). Përveç këtij projekti qeveria gjermane nëpërmjet bankës gjermane KfW po financon dhe projekte të tjera të rëndësishme për zhvillimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të Shqipërisë siç janë projekti i ndërtimit të linjës së interkonjeksionit 400 kv Tirana 2-Kosova B

me një vlerë 42 milionë euro për pjesën shqiptare, projekti i fuqizimit të Nënstacionit 400/110 kv Zemblak dhe zhvillimin e rrjetit 110 kv të zonës jugore të vendit me një vlerë 49 milionë euro. Në krye të EFT-së, është Vuk Hamović, ish-bashkëpunëtor i diktatorit serb, Millosevic dhe sot kompania e drejtuar prej tij ka monopolin në tregun energjetik në Ballkan, përfshirë edhe Shqipërinë.

Ndërsa prej dy javësh në Shqipëri vijon je hona e skandalit të bllokimit të projektit për ndërtimin e linjës 400 kilovoltëshe të interkonjeksionit mes Shqipërisë dhe Kosovës, financim i bankës gjermane KfW, një linjë tjetër e rëndësishme është fituar prej serbëve, pa zhurmë dhe bujë. Sipas dokumentit të prezantuar nga vetë grupi EFT, konkretisht nga kreu i saj i shitjeve, Mladen Apostolović, në 7 mars 2012, në Beograd, një ndër sukseset e EFT është ndërtimi i linjës së interkonjeksionit të Shqipërisë me Malin e Zi në 2011. Sipas dokumentit të grupit EFT, linja e transmetimit të energjisë Mali i Zi-Shqipëri, 400 KV, Podgoricë-Tiranë/Elbasan, është mbyllur në maj 2011. Inaugurimin e kësaj linje interkonjeksioni e bëri vetë kryeministri Berisha në 5 August 2011, në Shkodër. Projekti me vlerë 43 milionë eurosh u financua nga qeveria gjermane nëpërmjet bankës KfW, dhe kishte të bënte me ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kv midis nënstacioneve Tirana 2 (Shqipëri) dhe Podgoricë (Mali i Zi). Në inaugurim përveç kryeministrit Sali Berisha, zv.kryeministrit të



Reportazhi

RICCARDO STAGLIANO

Tiranë. Maria de Filippi tash më e ka harruar karburanin. Të paktën përpara në përket shqiptarëve. Nuk habiten më nga sirenat televizive të përtej Adriatikut. Ëndrrat televizive i realizojnë në Atdhe. Me programe të klonuara nga tonat. Si Fiks Fare, që do të thotë "pikërisht kështu" dhe duket përgjigja e singertë e pyetjes "mos është fajti i Striscia la Notizia?". E njëjta skenografi, të njëjtat velina trikollogjistik bipartizan, bionde dhe brune. Kështu, për këtë dhe për motive të tjera më thelbësore, dy dekada pas eksodit drejt brigjeve puljeze duket se ka më shumë shpresë në rrugën drejt kthimit sesa në atë të largimit. Sic transit gloria mundi. (Latinit: Kështu ndryshon lavdia në këtë botë, shën red).

Më shumë se sa prova për këtë ndryshim të tendencës, ka të dhëna. Këtë vit, për shembull, në Tiranë janë regjistruar 600 fëmijë më shumë në klasat e fillores. "40% të këtyre nga Italia, të tjerët nga Greqia", shpjegon Ismail Ademi, konsulent ndërkulturore si dhe ideator i takimit "30 vjet emigrim shqiptar në Itali" që është zhvilluar në Tiranë. Një nga sponsorat është INAS CISL, që ndihmon mes të tjerash kë dëshiron të bashkojë kontributet shoqërore të mbledhura në vende të ndryshme. Ka ardhur për të njoftuar hapjen e një selie në qytet. Sepse kush kthehet, pa ndihmë, rrezikon të humbasë atë që ka vënë mënjëgjatë viteve të punës në Itali.

"Presim që të kthehen gjithnjë e më shumë", tregon presidenti Antonio Sorgi. Zv/ambasadori Giuseppe Berletti shton: "Njerëzit emigrojnë duke ndjekur "rregullin e 5-ës", thënë ndryshe kur fitojnë 5 herë më shumë se në Atdhe. Përndryshe kthehet". Një konstatim, më shumë se sa një profeci. Në sinkronë me krizën ekonomike që këtu të në fillimist u thith falë parakolp human të emigrantëve, të parët që u pushuan nga puna.

Spas numrave të Teuta Grazhdani të Organizatës Ndërkombëtare të Migrantëve, në vitin 2011 janë kthyer nga Italia 1053 shqiptarë. Por nuk ka numra për kthimin vullnetar. Kjo organizatë "po përpiqet t'i mbledhë përmes Ministrisë së Arsimit", shpjegon sociologu Rando Devole, "meqenëse shumë familje emigrantësh kanë kërkuar ndihmën e shkollave përpara u përket fëmijëve". As Caritas Migrants nuk ka të dhëna të sakta. Por ajo që është tepër specifike janë historitë që kjo tendencë mishëron.

Altin Prenga është rikthyer në 2009. Njëmbëdhjetë vjet më parë, kur ishte 15 vjeç, ishte nisur vetëm. Në Trentino punonte në përpunimin e sallamit në një gastronomi. "Të lash pjatat në një restorant me vjet Michelin ishte shumë formuese", thotë me një italishtje që nga pastërtia duhet të bëjë me turp shumë italianë, "më pas hapa një agriturizëm në liqenin e Garda-s". Gjërë e cënin jo keq, por jo keq nuk ishte aq sa duhet: "Nuk ndjehesha i vlerësuar. Isha larguar sepse këtu nuk mund të jetoja më. Kur jo u bëri përsëri e mundur u riktheva". Duket vendosur në valixhe një nga idetë italiane për eksportim: filozofinë Slow Food. "Shqipëria është

Ndonjëherë rikthehen. Në Shqipëri



një vend që, pas 50 vitesh dietë komuniste, ka harruar traditën gastronomike. Na vjen turp të bëjmë barinjët, të ndotim duart me tokën". Ndërsa ai do ta kthejë në modë. Një orë e gjysmë larg kryeqytetit ka hapur Mrizin e Zanave, i pari vend në Shqipëri që mban vulën Carlo Petrini. "Lënda e parë vendase, kuzhinë e singertë, si ajo e gjysmës. 10-12 euro për person. Im atë më talle: shqiptarëve nuk u pëlqen t'u kujtohet të kaluarën, preferojnë ta harrojnë. Por në fund fitova unë". Dhe takimi

ynë shtyhet për dy orë sepse për drekë, papritur, vjen Kryeministri Sali Berisha dhe zv/kryeministri i Kosovës.

E ngjashme edhe historia e Blerim Kokomanit. Në 1991, vetëm 14 vjeç, ishte ndër të parët që besuan se te ne ishte Amerika. Mori një varkë, shkoi në Brindisi dhe pas një kalimi përmes një instituti minorenesësh mbërriti në Reggio Emilia ku ka bërë kurse për kasap dhe marangoz. Nga një i afërm të tjetri, ka bërë xhiron e Italis derisa gjeti vokacionin në një kantinë umbre. Në fillim merrej me votat e verës, por ishte kaq i shkathtë sa që një enolog i rëndësishëm e mori si krah të djathtë. Më pas ai tërhoqi edhe të vëllanë: fitonim mirë, harxhonim pak ("70% e të ardhurave shqiptare vjen nga emigrantët") dhe çdo vit blinin një hektar tokë në Shqipëri. Exit strategy graduale e zyrtarizuar vete më parë me lindjen e Kokomani Vineyard. "Vitin e kaluar bëmë 56 mijë litra. Hapëm një pikë shitjeje në Tiranë. Dhe bëjmë

tregti me Shtetet e Bashkuara". Për italianët thotë se jemi "kreativë, nuk rrinë kurrë në një vend. Dhe në këtë sektor mund t'i jepni mënd të gjithë botës!". Duket se më shumë e beson ai sesa ne. Ish-kryebashkiaku i Tiranës, Edi Rama, përveçse ngjyrosi me alegri pallatet gri të sovjetikëve, është i famshëm për një batutë: "Italianët janë shqiptarë të veshur me Versace". Blerimi është shumë elegant, por i një lloji shumë më të thjeshtë.

Ajo që ka të përbashkët me bashkatdhetarët e tij të kundërkësht është një maturi e parakohshme. I sheh, u flet dhe tregojnë të gjithë dhjetë vite më shumë në krahasim me një bashkëmoshatar europian. Ajo në kanalën e Otrantos, mes skafistëve dhe financierëve, ishte një lojë shumë më impetuose sesa ajo mes rojeve dhe hajdutëve që adoleshentët italianë kishin lënë pas prej pak kohësh. Të gjithë të martuar, me dy-tre fëmijë: ky nuk është një vend për përtaqë. Armand Voksi nuk përbën përjashtim. Në 1991 kalon një seri kufijsh për të mbërritur në Gjermani. Bën kamerierin dhe dërgon lekët në shtëpi. Më pas, me kursimet e shtatë viteve, regjistrohet në fakultetin e arkitekturës në Firence. Me një performancë unike, më shumë se sa të rrallë: diplomohet në kohë, në një gjyhe që e mësoi gjatë vitit të parë të universitetit. Profesori i tij i urbanistikës e merr si ndihmës, fiton një doktoraturë kërkimi: shkëlqyeshëm dhe bollshëm për çfarëdo standardi italian, por jo për një njeri që kurrë ishte vogël mbante me bukë familjen e tij. "Nuk shikoja, në një periudhë kohore mesatare, mundësinë që të hapja një studio dhe të kisha një kurs timin dhe u ktheva". Sigurisht tani është kërkues në universitetin e Tiranës,

por me një rrogë trefish në krahasim me atë të doktoraturës italiane. Nga Firence i mungojnë miqtë dhe "oferta kulturore. Por tashmë, me fluturime prej 100 euro, mund të shkoj edhe dy herë në muaj". Ndërsa këtu puna e tij kryesore është plani rregullator i një qyteti anarkist, i menduar për 300 mijë banorë të trefshuar nxitimthi gjatë viteve 90 ndërsa infrastruktura nuk rritet me të njëjtin ritëm. "Nuk ka një parking të vetëm. Barket që janë kthyer në shtëpi janë gjysma abuzive. Pranë disa lokaleve të qendrës ka ende rrugë të pashtruara. Është një sfidë e madhe".

Kush e di nëse do arrijë t'u shpëtojë hoteleve të reja moderne që nuk është rasti të imitojnë diskotekat dhe se niveli i cilësisë nuk matet me decibelët që lëshojnë. Pak si plazhet në Salento, të bukura pa fund po të mos ishte për dj-të që në mes të pasditës i kthejnë në ferr nën

EDITORIAL

NGA PREÇ ZOGAJ

Për 21 janarin s'ka qëndrim të ballancuar

vijon nga faqja 1

...Prandaj hetimi gjithëpërfshirës mbetet një sfidë e hapur. Po qëndrimi i ballancuar çfarë është? Çfarë kuptimi ka? Ata që e artikulojnë këtë qëndrim mund të shpjegojnë para publikut se çfarë kanë në mendje. Unë po them një mendim timin. Qëndrimi i balancuar do të thotë vënie në një plan e gurëve që hodhën në drejtim të policisë dhe kryeministrit një pakicë e vogël demonstruesish të irrituar me plumbat luftarakë që shtu Garda e Republikës mbi vetë demonstratën. Do të thotë vënie në një plan e dhunës me mjete rrethanore, pa dëmtë njerëzore dhe materiale të pariparushme, me vrasjen gjaktohtë të të paktësishme të katër demostuesve- Hekuran Dedës, Aleks Nikës, Faik Myrtajt dhe Ziver Veizit- dhe plagosjen e mbi dhjetë të tjerëve, që të gjithë demostues paqësorë. Do të thotë gjithashtu vënie në një plan e retorikës së konfrontimit të ndonjë aktori të veçantë opozitar, që nuk ishte retorikë e shefit të opozitës dhe shtabit të demonstratës, me gjuhën e plumbave në krahuin tëjetër.

Me fjalë të tjera do të thotë poshtërsi, çarje e logjikës dhe e qënies, siç do të thoshte De Mestre, s'ka rëndësi nga budallallëku apo ligësia. Sidomos tani, kur mbarë bota demokratike ka konstatuar dhe dënuar përdorimin shproporcional të dhunës nga ana e qeverisë shqiptare më 21 janar dhe kur hetimi gjithëpërfshirës e drejtësia kanë mbaruar punë me mbi njëqind pjesëmarrës në demonstratë dhe kur asnjëri prej tyre nuk i është gjetur asnjë lloj arme dhe nuk i është marrë asnjë pohim se ishte thirrur për të ushtruar dhunë dhe kur ekspertiza e FBI-së ka ndriçuar në mënyrë të paktësishme krimin e vrasjes, duke shokuar të madh e të vogël me lehtësinë me të cilën është hapur zjarr në mish të gjallë njeriu dhe me guximin me të cilin është punuar për manipulimin e provave, pra, sidomos tani nuk mund të ketë një qëndrim të ballancuar për 21 janarin.

Vrasjet e 21 janarit janë realistisht handikapi i paqes politike dhe shoqërore në këtë vend. E di shefi i partisë më të madhe të opozitës që mundohet të lëvizë në kafazin e marrëveshjeve dhe kompromisave të domosdoshme për çwshtë të tjera, i vërditshëm se plagët e 21 janarit janë kufiri i pakulshëm dhe argumenti i panegotitshëm, që nuk mund të shërohen veçse më një verdikt sovran, të plotë e përfundimtar të drejtësisë. E di edhe kryeministri, Sali Berisha, i cili, duke u kthjelluar me kalimin e kohës për jetët që humbun panoveshëm para dritares së zyrës së tij kur demonstrata po shpërndahej dhe për muret që ngritën ato vrasje mes tij dhe popullit të lirë të Shqipërisë, që është me shumë se partië opozitare dhe partië qeveritare të Shqipërisë, me siguri ëndërron ditën kur një degë ulliri të ngrihet mbi ato mure. Por ajo degë ulliri nuk mund të ngrihet nga harrimi i tragjedisë dhe nuk ka asnjë vlerë në një dorë që zgjatet për t'i bërë fresk zotit Berisha. 21 janari nuk mund të jetë monedhë shkëmbimi në asnjë lloj skenari politik.

Amasadori i SHBA-së, zoti Arvizu, ka folur sërish këto ditë për nevojën e një shërimi në lidhje me 21 janarin. Është një qasje dhe dëshirë fashike padyshim, që jehon pozitivisht në traditën tonë shekullore, do thosha mjaft të përpunuar në këtë fushë. Unë do të doja ta lidhja dëshirën e tij me letrën që i ka shkruar familjes Nikë në Lezhë me datën 9 shkurt të këtij viti, në të cilën ai shpreh mbështetjen e tij dhe të SHBA-së për zbardhjen e së vërtetës së 21 janarit. Kjo do të ishte. Kjo do të ishte. Një shërim i mbështetur mbi të vërtetën, një paqe e mbështetur mbi drejtësinë. Verditë politike për përgjigjësi të ballancuar të palëve nuk kanë asnjë mbështetje në realitetin e faktëve që janë parë, janë hetuar e po hetohen. Aq mu shumë jashtë realitetit janë ato, kur mendon se drejtësia nuk e ka thënë ende fjalën e vet për vrasjet.

www.shqiptarja.com

RIGHT TO A VILLAGE

Aleanca për zhvillimin rural dhe kulturor të komuniteteve të vogla

FTESË PËR ANËTARSIM

RTV është një rrjet zhvillimi kulturor, organizatash lokale të orientuara drejt komuniteteve nga Ballkani Perëndimor, të bashkuara për arrijnjen e çështjeve dhe principeve të përbashkëta: liri shprehjeje, respect, reciproc, përfshirje dhe vullnetarizim.

RTV është një aleancë rajonale dhe një rrjet që po ndërtohet drejt një lëvizjeje rajonale për bashkëpunim, zhvillimin kulturor rural, planifikim i hapësirave rurale, të drejtat njerëzore dhe demokraci. RTV kërkon të krijojë impakte lokale dhe rajonale dhe ndryshime positive në fushën e kultures dhe zhvillimin e komuniteteve rurale.

Në kuadër të krijimit të këtij rrjeti RTV pret aplikime për anëtarësim të organizatave kulturore që operojnë në zonat kulturore. Afati maksimal për përfundimin e aplikimit, është data 30 Prill.

Kriteret për anëtarësim të organizatave kulturore

- Të jenë organizata që ekzistojnë në paktën prej një viti.
- Të kenë realizuar të paktën tre projekte në 18 muajt e fundit direkt në fshatra ose komunitete me më pak se 10.000 mijë banorë.
- Të fokusojë aktivitetet e veta në zhvillimin rural dhe zhvillimin e brendshëm të komuniteteve me më pak se 10.000 banorë.
- Të kenë dëshirë për bashkëpunim rajonal dhe të krijojnë partneritete me organizata nga vende dhe rajonet e tjera.

Për të parqitur kërkesën ju lutem dërgoni një kërkesë me email ne adresën info@artkontakt.al me subjektin, "Kërkesë për anëtarësim në RTV"

diell. Ka tragete që tashmë të dërgojnë për 40 euro. Dhe prej dhjetorit 2010 nuk ka më nevojë për viza. Ka nga ata që marrin me vete në shtëpi Slow Food, dikush tjetër të tmerrshmen disco on the beach. Takoj të tjerë të kthyer. Altin Shuaipi që në Firence ka studiuar artë të bukura, por që i duhet të kënaqej me punën si kamerier ndërsa këtu bën fotografim. Shumë i sjellsimi Edvin Kukunja nga Torino, ish-menaxher impiantesh sportive por që dëshiron të shfrytëzojë diplomën në juridik dhe tani, ndërsa bën praktikën ligjore, punon edhe si spin doctor për disa politikanë premtes vendas.

Rroga mesatare mbetet e ulët, rreth 250 euro, por është edhe e vërtetë se me 25 mijë euro blihet një apartament në periferinë e parë të kryeqytetit. Më mirë një shtëpi në Tiranë apo një garazh në Romë? Fusha tërheqëse italiane reziston.

Përtej programeve televizive, emrave të lokaleve, ekziston edhe Shqip, një e përditshme që është fotokopja mahnitëse e Repubblica. I njëjti format, faqesje, font. Nëse kishte të drejtë Armani kur thoshte se "imitimi është forma më e lartë e adhurimit", atëherë na duan ende shumë. Dhe në përmjetim më pak. Në klasifikimin e frikësues tanë të preferuar janë zëvendësuar nga rumunët dhe ndoshta edhe nga kinezët. Ky të paktën është përfundimi i takimit. Verifikojnë fund në Internet me "Albanes" dhe "kriminalitet" si fjalë kyçe. Del një histori e tmerrshme e një tipi që ka vranë të shogën dhe të dashurin e saj, të bijën dhe të fejuar. Nuk duhet kuj, pikërisht tani që po rikrijonin një reputacion. Pormë pas shikoj mirë dhe Albanese ishte mbiemri i një tipi në Manduria. Përsa i përket dhunës në familje, mos t'u vijë keq legjivete, nuk marrim leksione nga askush.

Pasuritë e zyrtarëve

Hetime pasurisë së Mediut dhe Imamit Shorti, kontroll pasurisë edhe të deputetëve

Qytetarë, përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile përgjodhën dhe me short 192 zyrtarë që do t'i nënshtrohen investigimit të hollësishtëm të pasurisë së tyre nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Procedura e shortit

ishte pjesë e aktivitetit "ILD-KP me dyer të hapura", e cila shënon transparencën më maksimale të aktivitetit të institucioneve kontrolluese në Shqipëri. Në përfundim të shortit, nga e cila sipas ligjit përzgjidhen 4% e totalit të rreth 4360 subjekteve

deklarues, u përzgjedhën për kontroll 2 ministra, një zv.ministër, 29 gjyqtarë dhe prokurorë, 9 nëpunës të nivelit të lartë, 6 deputetë, 55 nëpunës të nivelit të mesëm, 17 drejtues të pushtetit lokal dhe 73 punonjës të administratës tatimore dhe doganore.

Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP, z. Adriatik Llalla, në fjalën hyrëse të aktivitetit, falenderoi qytetarët dhe aktorët e shoqërisë civile për bashkëpunimin e ngushtë me Inspektoratin e Lartë lidhur me denoncimet e rasteve korruptive në administratën

publike. Duke vënë theksin në amendimet e fundit të Kodit Penal, në bazë të të cilave ILDKP-së i krijohen mundësi më të mëdha investigimi për pasuritë e paligjshme, z. Llalla inkurajoi të gjithë ata që synojnë forcimin e shtetit ligjor në Shqipëri "të jenë sa

më aktivë në bashkëpunimin me Inspektoratin e Lartë". Në këmbim të këtij bashkëpunimi - theksoi kreu i Inspektoratit të Lartë, "sigurojmë opinionin publik se do të vijojmë me vendosmëri luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave".



SUBJEKTET E PERZGJEDHUR NGA SHORTI 2012

Ren.	Namri	Subjekti	Institucioni	Funksioni	Vendi
1	7675	Maksim Sokrat Sota	Prokuroria e Rrethit	Zv/Prokuror Rrethi	Vlore
2	9118	Zeta Rakip Terpollari	Gjykata Rrethit	Gjyqtar	Lushnje
3	1467	Albana Burhan Boksi	Gjykata Apelit Krimeve te Renda	Gjyqtar	Tirane
4	1687	Saida Lumner Dollani	Gjykata Apelit Krimeve te Renda	Gjyqtar	Tirane
5	8851	Mariola Josif Mertini (Llaci)	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Gjrokkaster
6	1359	Melush Sinan Saraci	Gjykata Apelit	Kryetar/Gjyqtar	Tirane
7	1412	Enkela Ferik Bajot (Vlora)	Gjykata Rrethit	Gjyqtar	Tirane
8	1751	Naim Baftjar Tota	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Mat
9	1514	Kostika Miti cobanaqi	Gjykata Rrethit	Gjyqtar	Berat
10	8596	Artan Nuh Zeneli	Gjykata Rrethit	Kryetar	Tirane
11	2001	Dritan Adem Cina	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Durres
12	1772	Skender Veledin Dautaj	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Vlore
13	2020	Artan Sabri Bajrami	Prokuroria e Apelit Krimeve te Renda	Prokuror/Drejtues i Prokurorisë	Tirane
14	1621	Eda Muhamer Kaja	Gjykata Rrethit	Gjyqtar	Durres
15	1371	Idriz Shaban Mulkuiri	Gjykata Krimeve te Renda Shkalla e Pare	Gjyqtar	Tirane
16	1589	Anesti Pandi Kasuli	Gjykata Apelit	Gjyqtar	Korce
17	1370	Gurati Mitat Brahimllari	Gjykata Krimeve te Renda Shkalla e Pare	Gjyqtar	Tirane
18	1782	Julian Sotir Kristo	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Korce
19	1877	Elirim Kujtim Sino	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Fier
20	1409	Bujar Rexhep Krasniqi	Gjykata Rrethit	Gjyqtar	Tirane
21	1843	Lindita Dashmir Zguri (Male)	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Tirane
22	1895	Elidiana Qamili Morina (Kasa)	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Puke
23	1997	Adriatik Ismail Cama	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Tirane
24	1364	Tom Pjeter Ndreca	Gjykata Apelit	Gjyqtar	Tirane
25	4533	Enkelelda Elez Xhengo (Osmani)	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Durres
26	1357	Flutura Beqir Skenderi	Gjykata Apelit	Gjyqtar	Tirane
27	1457	Bari Dyle Shyti	Gjykata Rrethit	Gjyqtar	Diber
28	2060	Sokol Faik Nishani	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Durres
29	1878	Elida Hekuran Hoxhaj (Ciplika)	Prokuroria e Rrethit	Prokuror	Fier
30	9341	Kreshnik Tomorri cipi	Kuvendi i Shqipërisë	Deputet	Tirane
31	9335	Ledina Bardhyl Alofi	Kuvendi i Shqipërisë	Deputet	Tirane
32	1016	Qemal Tahir Minxhozi	Kuvendi i Shqipërisë	Deputet	Tirane
33	85	Fatos Asllan Beja	Kuvendi i Shqipërisë	Deputet	Tirane
34	9343	Igli Latif Cara	Kuvendi i Shqipërisë	Deputet	Tirane
35	685	Arben Qamili Malaj	Kuvendi i Shqipërisë	Deputet	Tirane
36	7699	Pal Gjok Metaj	D.P. Permbarrimit (MD)	Drejtor i Përgjithshëm	Tirane
37	7094	Albert Vasil Kushi	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	Sekretar i Përgjithshëm	Tirane
38	2108	Rezana Rodolf Konomi (Perolla)	Autoriteti i Konkurrencës	Komisioner	Tirane
39	10442	Flamur Liman collaku	Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Palaujtshme	Zv/Kryeregjistrues	Tirane
40	9441	Bejtan Sevo Peshja	Ajencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (METE)	Drejtor Ekzekutiv	Tirane
41	2722	Klement Koco Zguri	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Anetar	Tirane
42	10056	Albert Koci Qarri	Universiteti	Rektor Universiteti "Ismael Qemali"	Vlore
43	7776	Abaz Ino Aliko	Enti Rregullator i Energjië	Anetar Bordi	Tirane
44	9997	Fatmir Reshat Tafaj	Komisioni Sherbimit Civil	Zv/Kryetar	Tirane
45	9499	Brikena Fadil Kasmi	Ministria e Drejtësisë	Zv/Minister	Tirane
46	39	Arben Fahri Imami	Ministria e Mbrojtjes	Minister/Deputet	Tirane
47	83	Fatmir Ali Medu	Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	Minister/Deputet	Tirane
48	9674	Vcap Besim Aga	Gjykata Rrethit	Kancelar	Diber
49	5528	Flamur Hamdi Muka	D.P. Policisë së Shtetit	Shef Komisarati	Mat
50	9991	Lindita Fust Kullolli	D.P. Permbarrimit (MD)	Permbarrues Gjyqësor	Elbasan
51	820	Arqilela Andrea Kokodima	Ministria e Mbrojtjes	Komandant i Shkolles se Trupes	Tirane
52	4781	Agim Beqir Lala	Ministria e Mbrojtjes	Komandant Force ne FA	Tirane
53	9183	Dilaver Hamza Hoxha	Ministria e Mbrojtjes	Drejtor i Planifikimit te Mbrojtjes SHIPA	Tirane
54	7702	Shkelqim Abdyl Kallolli	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë, Energjitikës	Drejtor i Agjensisë së Koncesioneve	Tirane
55	10199	Agim Ismail Bega	Ministria e Drejtësisë	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Gjyqësorit	Tirane
56	9551	Arjana Gani Sula	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Drejtor i Drejtorisë së Edukimit dhe Statistikës	Tirane
57	10206	Roland Sello Haxhia	Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Palaujtshme	Regjistrues	Tepelene
58	9736	Mamica Andon Gusho	Gjykata Rrethit	Kancelar	Pogradec
59	10002	Medar Muharrem Kajolli	D.P. Permbarrimit (MD)	Permbarrues Gjyqësor	Tirane
60	10398	Fatmir Mehmet Mehmetaj	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë, Energjitikës	Keshilltar	Tirane
61	467	Kozeta Gezim Guri	D.P. Permbarrimit (MD)	Permbarrues Gjyqësor	Tirane
62	1320	Artia Garip Vopari (Palushaj)	Gjykata Kushtetuese	Keshilltar e Gjyqtareve	Tirane
63	9447	Ledia Genc Agolli	Ministria e Shëndetësisë	Keshilltar	Tirane
64	753	Anila Vaso Tanku	Ministria e Financave	Drejtor i Përgjithshëm i Financimeve dhe Kontraktimeve të Huaja	Tirane
65	9967	Zihni Ali Goxhaj	Ministria e Mbrojtjes	Drejtor i Drejtorisë së Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	Tirane
66	8332	Juela Pullumb Mecani	Ministria e Punës, çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta	Keshilltar	Tirane
67	6858	Krenar Zalo carcani	Sherbimi Informativ Shtetëror	Drejtor i Drejtorisë kundër Spionazhit	Tirane
68	7327	Rrok Guljelm Deda	D.P. Permbarrimit (MD)	Permbarrues Gjyqësor	Tirane
69	8830	Altun Gani Salaku	Ministria e Brendshme	Drejtor i Informatizimit të Administratës Publike	Tirane
70	4883	Mevlan Xhevdet Xhindioli	Kuvendi i Shqipërisë	Keshilltar	Tirane
71	9376	Roland Ilias Larashi	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	Drejtor i Përgjithshëm	Tirane
72	8663	Sonila Petraq Baka	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Financiar dhe Statistikave	Tirane
73	2107	Petri Muhamet Azemaj	Avokati i Popullit	Ndihmes Komisioner	Tirane
74	4961	Milvana Mandi Treska (Tole)	Ministria e Financave	Drejtor i Drejtorisë së Strategjisë dhe Riskut	Tirane
75	287	Nejla Eduard Peka	Keshilli i Ministrave	Jurist/Departamenti Ligjor	Tirane
76	219	Agim Idriz Isaku	Ministria e Punëve të Jashtme	Ambasador-Bratislave	Tirane
77	10040	Arben Agim Hanku	Ministria e Punëve të Jashtme	Drejtor i Sekretariatit Ndërlidhës dhe Shifrës	Tirane
78	1887	Selami Avdi Zalli	Gjykata e Lartë	Ndihmes Ligjor	Tirane
79	476	Luiza Novruz Gjergjova	D.P. Permbarrimit (MD)	Permbarrues Gjyqësor	Lushnje
80	8540	Arben Yzeir	D.P. Policisë së Shtetit	Shef Komisarati	Pogradec
81	10507	Fatim Hysen Hoxhati	Gjykata e Lartë	Keshilltar i Kryetars Gjyqësor të Lartë	Tirane



SUBJEKTET E PERZGJEDHUR NGA SHORTI 2012

82	9322	Ilir	Personale	Inspektimit	Tirane	140	9957	Avenir Mithat Çopuni	D.P. Doganave	Specialist/Drejtoria e Informacionit	Tirane
83	9147	Hasan Mexhit Mena	D.P. Permbarimit (MD)	Permbarues Gjyqësor	Tirane	141	9768	Dritan Haseni Logji	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli Verifikim Terren	Tirane
84	8386	Ilir Hysen Gjoci	D.P. Policise se Shtetit	Shef Komisarati Policise Nr.5	Tirane	142	9770	Mimoza Kosta Lango(Kurti)	D.P. Tatimeve	Inspektor i Verifikimit ne Terren	Tirane
85	9797	Nikolla Spiro Lena	Ministria e Shendetesise	Keshilltar	Tirane	143	10473	Armand Avni Fida	D.P. Doganave	Inspektor	Tirane
86	45	Arvan Athanas Banushi	Kuvendi i Shqiperise	Keshilltar	Tirane	144	2640	Vera Preng Deda(Bushi)	D.P. Tatimeve	Specialist Vleresimi T.P.Medhenj	Tirane
87	6037	Migena Enver Reçi	Ministria e Turizmit,Kultures,Rinise Sporteve	Drejtor i Koordinimit te Politikave Rinore	Tirane	145	9804	Liset Shpetim Logji	D.P. Doganave	Doganier Pranim/Peshoreje	Gjirokaster
88	9548	Pellumb Sulo Pipero	Ministria e Shendetesise	Drejtor i Pergjithshem i Politikave dhe Planifikimit Shendetesor	Tirane	146	6220	Piro Mina Tite	D.P. Doganave	Doganier Rregjimesh	Korce
89	7020	Muharrem Ramadan Kajolli	Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	Keshilltar	Tirane	147	5213	Klement Thanas Martiro	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli T.P.Medhenj	Tirane
90	9075	Klevis Dervish Limaj	Keshilli i Ministrave	Keshilltar	Tirane	148	6542	Islam Musa Kola	D.P. Doganave	Doganier Klasifikim/Vleresimit, Kontrollit Fizik	Gjirokaster
91	8861	Ilir Sali Dedja	D.P. Policise se Shtetit	Zv/Drejtor i Policise se Qarkut	Durres	149	6644	Enkel Agim Shehi	D.P. Doganave	Doganier Klasifikim/Vleresimit, Kontrollit Fizik	Durres
92	9824	Jorida Vasil Liko	Bashkia Tirane	Drejtor I Njesise se Menaxhimit te Projekteve	Tirane	150	5524	Agron Arefi Panci	D.P. Tatimeve	Inspektor Verifikimi ne Terren T.P.Medhenj	Tirane
93	7181	Edmond Ismail Kazazi	Ministria e Puneve Publike,Transportit dhe Telekomunikacionit	Drejtor i Drejtorise se Qarkullimit & Sigurise Rrugore	Tirane	151	9131	Brikena Ernest Merkuri	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli	Korce
94	7096	Zana Thoma Bufi	Kuvendi i Shqiperise	Drejtor i Kerkimit Shkencor & Biblioteka	Tirane	152	6486	Albert Ferit Zerani	D.P. Doganave	Doganier Antiknabandesh Detare	Tirane
95	10528	Kole Lin Tonaj	Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mburojtes se Konsumatorit	Drejtor I ISUV	Tirane	153	7756	Shpetim Sali Projku	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli T.P.Medhenj	Tirane
96	8469	Miranda Nikolla Bushi	Prokuroria e Pergjithshme	Drejtor Kabineti	Tirane	154	5623	Vilma Kostandin Papajorgji	D.P. Tatimeve	Inspektor Sektori I Mbledhjes	Durres
97	9384	Xhevdet Galip Hoxha	Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme	Regjistruues	Tropoje	155	5464	Arben Hajdar Kau	D.P. Tatimeve	Drejtor i Drejtorise se Auditit te Brendshem	Tirane
98	7594	Rovena Enver Muzhaqi	Ministria e Puneve Publike,Transportit dhe Telekomunikacionit	Drejtor i Drejtorise se Integritimit dhe Koordinimit te Projekteve	Tirane	156	9865	Rovena Luzlim Bunceci (Kertusha)	D.P. Doganave	Doganier Pranim/Peshoreje	Durres
99	2856	Marjan Vangjel Gjermani	Banka e Shqiperise	Drejtor i Departamentit te Operacioneve Monetare	Tirane	157	8787	Hike Allaman Kola	D.P. Tatimeve	Inspektor i Sektorit te Vleresimit	Tirane
100	10366	Auert Ilir Koka	Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore (METE)	Drejtor Drejtorie	Tirane	158	9726	Arben Muhamet Kalaja	D.P. Tatimeve	Inspektor Hetimi	Korce
101	4572	Odise Peci (Petraq) Plaku	Ministria e Puneve te Jashtme	Keshilltar	Tirane	159	9014	Insidori Sali Rexhepi	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli	Tirane
102	1057	Fran Pjeter Brahimi	Ministria e Financave	Drejtor i Drejtorise se Mardhenievet Fiskale Nderqeveritare	Tirane	160	7383	Shpend Zenel Goci	D.P. Tatimeve	Inspektor I Kontrollit Tatimor	Tirane
103	10432	Rahman Shefqet Demaj	Qarku Kukës	Kryetar I Komunes Terthore	Kukes	161	8357	Zhylyen Vladimir Lelaj	D.P. Tatimeve	Inspektor Verifikimi ne Terren	Gjirokaster
104	10275	Dalip Kasem Kanaçi	Qarku Berat	Kryetar I Komunes Otlak	Berat	162	7599	Defrim Skender Selko	D.P. Doganave	Doganier Klasifikim/Vleresimit, Kontrollit Fizik	Pogradec
105	10252	Rexhep Jonus Hajdari	Qarku Berat	Kryetar i Komunes Perondi	Kucove	163	6351	Riza Xhemal Shijaku	D.P. Doganave	Doganier Shkarkim Manifesti C2	Durres
106	9424	Bujar Kovac Hasaj	Prefektura	Prefekt	Fier	164	7757	Arjan Trifon Marku	D.P. Tatimeve	Inspektor Verifikimi ne Terren	Elbasan
107	3572	Rexhe Uke Byberi	Qarku Kukës	Kryetar Komunes Margegaj	Tropoje	165	7348	Pavlin Thoma Konda	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli T.P.Medhenj	Tirane
108	8121	Gazmend Selman Kenga	Qarku Diber	Kryetar i Komunes Martanesh	Bulqize	166	8974	Yllka Nazif Gjurgjaj(Kadiu)	D.P. Tatimeve	Inspektor Sektori i Vleresimit,Perpunim dhe Kontabilitetit te te ardhurave	Tirane
109	10225	Besim Rexhep Shurbi	Qarku Kukës	Kryetar i Komunes Fajza	Has	167	6662	Pashaj	D.P. Doganave	Operative	Tirane
110	10382	Petrit Lame Sinaj	Qarku Berat	Kryetar I Keshillit te Qarkut	Berat	168	5057	Mustafa Lame Mecaj	D.P. Doganave	Doganier Pranim/Peshoreje	Sarande
111	10370	Arqile Jorgo Mekshi	Qarku Gjirokaster	Kryetar I Komunes Zagorie	Gjirokaster	169	10067	Visar Gzim Troshani	D.P. Tatimeve	Inspektor Verifikimi ne Terren	Durres
112	2964	Hasim Xhelal cekrezi	Qarku Elbasan	Kryetar Komunes Pishaj	Gramsh	170	8973	Arjana Ridvan Marko	D.P. Tatimeve	Specialist T.P.Medhenj	Tirane
113	2986	Lufti Abdulla Lala	Qarku Elbasan	Kryetar Komunes Shushice	Elbasan	171	8929	Enkelejda Bashkim Troka	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli	Tirane
114	2874	Bajtar Mehmet Zeçaj	Qarku Fier	Kryetar Bashkise Fier	Fier	172	5973	Gani Faik Jukaj	D.P. Tatimeve	Inspektor Verifikimit ne Terren	Shkoder
115	10263	Rajmonda Mihal Ballaj	Qarku Fier	Kryetar I Bashkise Patos	Fier	173	5756	Sashenka Zoi Ura	D.P. Tatimeve	Inspektor Mbledhje	Durres
116	10295	Esat Nuh Shehu	Qarku Diber	Kryetar I Komunes Zall Rec	Diber	174	8977	Mirlinda Viktor Xhelili	D.P. Tatimeve	Inspektor Vleresimi	Sarande
117	10264	Besnik Fuat Abdini	Qarku Vlore	Kryetar I Komunes Ksamil	Sarande	175	5195	Lulzim Din Gjidaj	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli T.P.Medhenj	Tirane
118	2940	Bedri Skender Qypri	Qarku Elbasan	Kryetar Komunes Fierze	Elbasan	176	7958	Pandeli Nikolla Prifti	D.P. Doganave	Pergjegjes Zyre	Vlore
119	3634	Pieter Zef Lleshi	Qarku Shkoder	Kryetar Komunes Vig-Mnele	Shkoder	177	6730	Alfred Petraq Jorgo	D.P. Doganave	Doganier Klasifikim/Vleresimit, Kontrollit Fizik	Durres
120	8298	Engjell Balil Shehu	D.P. Doganave	Doganier C2	Vlore	178	7727	Eduart Prend Prela	D.P. Tatimeve	Inspektor i Verifikimit ne Terren	Shkoder
121	7426	Genci Syrja Duli	D.P. Doganave	Doganier	Korce	179	5033	Dhimitra Sotirajq Pulluqi	D.P. Doganave	Doganier Rregjimesh	Pogradec
122	9032	Seferin Ramazan Muca	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli	Tirane	180	9037	Bashkim Xhevdet Skura	D.P. Tatimeve	Inspektor Verifikimi ne Terren	Elbasan
123	9944	Lumturie Idriz Berisha	D.P. Tatimeve	Inspektor Verifikimi ne Terren	Durres	181	10548	Thanas Gjamo Dimo	D.P. Doganave	Doganier C2	Korce
124	8825	Emrullah Nasuf Shehu	D.P. Doganave	Doganier Fizik	Kukes	182	7912	Pellumb Bardhyl Emiri	D.P. Doganave	Doganier Pranim/Peshoreje	Durres
125	7333	Enkelejda Tofik Paskali(Kazazi)	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli T.P.Medhenj	Tirane	183	6507	Frano Gjok Kola	D.P. Doganave	Doganier Klasifikim/Vleresimit, Kontrollit Fizik	Shkoder
126	5690	Shkelqim Haki Musaraj	D.P. Tatimeve	Inspektor i Operacioneve te Kontrollit	Fier	184	5980	Olsi Shpend Kuca	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli T.P.Medhenj	Tirane
127	6982	Arjan Vasil Pere	D.P. Doganave	Doganier Klasifikim/Vleresimit, Kontrollit Fizik	Pogradec	185	2554	Ilia Thodhoraq Poci	D.P. Tatimeve	Inspektor Vleresimi	Gjirokaster
128	5203	Dhimitri Spiro Meci	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli T.P.Medhenj	Tirane	186	8989	Vasil Jani Rafiq	D.P. Tatimeve	Inspektor Verifikimi ne Terren	Gjirokaster
129	7564	Albert Bashkim Malaj	D.P. Tatimeve	Drejtor Rajonal	Fier	187	6680	Manol Fatar Polo	D.P. Doganave	Inspektor Antiknabandesh/Drejtoria e Antiknabandesh	Tirane
130	10116	Kreshnik Myftar Dacaj	D.P. Doganave	Doganier	Sarande	188	5320	Shkelqim Mustafa Gerbi	D.P. Tatimeve	Inspektor Kontrolli	Lezhe
131	9949	Kushtrim Dashnor Elezaj	D.P. Doganave	Hetues/Drejtoria e Hetimit	Tirane	189	9877	Jetmir Mark Marku	D.P. Doganave	Doganier Klasifikim/Vleresimit, Kontrollit Fizik	Rinas
132	5438	Pavoda(Ylvije) Osman Besho	D.P. Tatimeve	Inspektor Sektori i Vleresimit	Tirane	190	10556	Elvis Shemi Leshi	D.P. Tatimeve	Inspektor Terreni	Shkoder
133	5327	Man Asllan Muhameti	D.P. Tatimeve	Pergjegjes Sektori Operacioneve te Kontrollit T.P.Medhenj	Tirane	191	9028	Sokol Hysen Bakalli	D.P. Tatimeve	Inspektor Verifikimi ne Terren	Fier
134	9714	Genti Ukshin Kosumi	D.P. Tatimeve	Pergjegjes Sektori te Hetimit Tatimor ne Drejtorine e Hetimit Tatimor	Tirane	192	5905	Artan Kristo Becka	D.P. Tatimeve	Specialist Vleresimi	Korce
135	7661	Afrim Shefqet Bodi	D.P. Doganave	Doganier Rregjimesh	Durres						
136	7635	Genci Skendo Laci	D.P. Doganave	Doganier Klasifikim/Vleresimit, Kontrollit Fizik	Vlore						
137	9304	Edmond Ibrahim Korumi	D.P. Doganave	Doganier Pranim/Peshoreje	Tirane						
138	9882	Agron Shaban Okaj	D.P. Tatimeve	Pergjegjes Sektori	Tirane						
139	7233	Ilirjan Isuf Bezati	D.P. Tatimeve	Pergjegjes Zyre Vleresimi	Gjirokaster						

Abonohu!

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:
To Subscribe please contact:

Agjensia e Abonimeve të Shtypit (TRENOVA)
Tel: +355 682047825
e-mail: arbentrenova@yahoo.com

POSTA SHQIPTARE
Tel: +355 4 2375598
e-mail: abonime@postashqiptare.al

ADRION Ltd
Tel: +355 4 2240018
e-mail: sales@adrionltd.com

Ja si fillohet dita...



[**SHQIPTARJA.com**]

origjina e lajmit...

ERE

TELE
BINGO
SHQIPTARE

EKSPRES BINGO

Shorteu për të nxjerrë fituesin e kësaj loje do të hidhet në TV kombëtar Klan ditën e martë datë 24 prill ora 18:30

Loja Ekspres Bingo është lojë fati aritmetike e cila futet në kategorinë bingo 20 nga 75

Në aparaturë do futen goglat nga 1 deri 75

Fondi i fitimit është jo më pak se 50% e fondit të akumuluar

Loja do të ketë këto kategori fitimi

Super kuti -do te quhet bileta e pare qe ploteson kutine e brendshme qe permban 7 numra te kombinimit . Ne kete raste loja ndalet dhe ne ekran shfaqet bileta fituese per kete kategori fitimi.Fondi per kete kategori eshte 5% i fondit te fitimit

qe ploteson pjesen e jashtme rreth kutise qe permban 13 numra te kombinimit .Loja perseri ndalon dhe ne ekran shfaqet bileta fituese per kete kategori fitimi.Fondi per kete kategori eshte 5%i fondit te fitimit.

shme me 7 numra .Vlera e fitimit per kategori varet nga numri i fituesve per shorteun perkates. Fondi per kete kategori eshte 12%i fondit te fitimit.

shorteun perkates .Fondi per kete kategori eshte 6% i fondit te fitimit.

Super Unaze -do te quhet bileta e pare

Kuti-Behen fituese te gjitha biletat e tjera pervec te pares qe plotesojne kutine e brend-

Unaze -Behen fitues te gjitha biletat e tjera pervec te pares qe plotesojne pjesen e jashtme rreth kutise me 13 numra te kombinimit.Vlera e fitimit per kategori varet nga numri i fituesve per

Ekspres Bingo-Bileta qe ploteson te gjitha goglat ne kombinim (20) nga goglat e hedhura ne shorte fiton cmimin e madh,vlera e te cilit shpallet para hedhjes se shortit. Fondi per kete kategori eshte 25% i fondit te fitimit.

EKSPRES

BINGO





Bie në kontakt me energjinë vdes 35 vjeçari

Një 35 vjeçar nga Qesaraka e Tiranës ka gjetur vdekjen pas një kontakti me energjinë elektrike. Mësohet se i riu ndodhej pranë banesës në kohën që një kabull korrenti i cili furnizonte shtëpinë e tij me energji elektrike i ka shkakuar vdekjen. Ende janë të paqarta rrethanat e ngjarjes ndërsa uniformat blu kanë mbërritur në vendngjarje. Nga të dhënat

paraprake thuhet se 35 vjeçari Dritan Peposhi ishte duke punuar në një shtyllë elektrike në kohën e fatkeqësisë. Të dhënat e para hetimore tregojnë se 35 vjeçari e ka prekur gabimisht kabullin elektrik, çka ka sjellë dhe vdekjen e menjëhershme të tij. Kanë qënë familjarët e viktimës ata që kanë parë ngjarjen nga ku më pas kanë njoftuar me shpejtësi

policinë e shtetit. Në vendngjarje kanë shkuar efektivat e policisë së Tiranës, të cilët pasi kanë bërë të mundur largimin nga shtylla të 35 vjeçarit Peposhi, e ka transportuar atë në drejtim të morgut në spitalin "Nënë Tereza". Hetimet kanë arritur në përfundimin se ngjarja ka ndodhur aksidentalisht dhe për pasojë, pritet që shumë shpejt ato të pushohen.

Avokatët: Dosja është nul, s'mund të gjykohet

Prifti-Beqiri, mbrojtje si Meta dhe Mediu

Akuza, 10 ditë kohë për të dhënë përgjigje

Lajmi

Dy zyrtarët e lartë Dritan Prifti dhe Leonard Beqiri kanë ndjekur rrugët ligjore të të pandehurve Ilir Meta dhe Fatmir Mediu për të shpëtuar nga përgjegjësia penale. Avokatët e tyre i kanë kërkuar njëzëri gjykatës, që të shpallë pavleshmëri absolute të akteve hetimore, pasi ato bien në kundërshtim me praktikën ligjore.

■ ■ ■ TIRANE

ELTON QYNO

Dritan Prifti, ka bazuar mbrojtjen ligjore para Gjykatës së Lartë, duke ndjekur rrugën e ish-ortakut të tij Ilir Meta dhe ish-ministrit të Mbrojtjes Fatmir Mediu. Në kërkesat paraprake që lexoi në gjykatë, avokati i ish-ministrit të Ekonomisë, Fatmir Braka theksoi se të gjitha materialet e prokurorisë janë nul, për shkak se ato janë marë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale por dhe se praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë ndalon përdorshmërinë e tyre. Në vijim të këtij argumenti, avokati i Dritan Priftit i ka përmendur trupit gjykues disa vendime gjyqësore, si atë të pajafjesisë së ish-zv/kryeministrit Ilir Meta, vendimin e 2009 të pushimit të dosjes në ngarkim të ministrit Fatmir Mediu dhe vendimin e ndërmjetëm të marë nga Gjykata e Lartë, për papërdorshmërinë e aktit të ekspertimit të bërë nga amerikanit Gleen Bard. Më tej avokati përmendi se ky ekspertimin është bërë në një kohë, kur klientit të tij nuk i ishte hequr imuniteti që gëzon si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, dhe për pasojë sjell paligjshmërinë e ekspertizës. Në fund të kërkesave paraprake avokati Braka, i ka kërkuar trupit gjykues shpalljen e pavleshmërisë absolute të dosjes për shkak se të gjitha veprimet e kryera në të janë nul. Në të njëjtën linjë me mbrojtjen e ish-ministrit të Ekonomisë Dritan Prifti, ka qëndruar dhe avokati i ish-zv/ministrit Leonard Beqiri.

Avokati Vladimir Meçi, u shpreh se ashtu si në dosje Meta-Prifti ku nuk ekziston



Dritan Prifti dhe Leonard Beqiri

te fakti, edhe në këtë çështje nuk ekziston fakti. Ndërkohë që prokurori i çështjes Bujar Sheshi ka kërkuar 10 ditë kohë, për ti dhënë përgjigje kërkesave të avokatëve, që siç i quajti ai janë tepër komplekse. Dy të pandehurit Prifti dhe Beqiri nuk ndodheshin në sallën e gjyqit. Në video ata shfaqen duke ndarë një shumë prej 70 mijë euro.

MBROJTJA

Në nenin 128 paragrafi i

parë pika b, pavlefshmëria absolute, parashikohet se: "Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme, kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedimin penal. Në paragrafin e fundit të kësaj dispozite parashikohet se një akt i ciliësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm. Prokuroria

e Tiranës, edhe pse nuk ka pasur kompetencën lëndore, ka bërë regjistrimin e procedimit penal, ka vijuar me veprimet hetimore (nuk) që konsistojnë në marrjen e provave materiale të vëna në dispozicion nga shtetasi Dritan Prifti. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 6 të vitit 2009. Pikërisht në këtë vendim kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se

Argumenti

Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme, kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedimin penal

mungesa e një autorizimi për procedim të Kuvendit të Shqipërisë për Fatmir Mediu pas mandatimit si deputet, është një prej rrethanave ligjore të parashikuara nga neni 290/1-e i K.Pr.Penale. Në bazë të të cilit ndjekja penale e filluar në ngarkim të të pandehurit Fatmir Mediu nuk mund të vazhdojë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nga provat e administruara në secancën gjyqësore të datës 14.09.2009, konstaton se ndjekja penale ndaj të pandehurit Mediu nuk mund të vazhdojë, pasi jemi përpara një prej rrethanave ligjore të parashikuara nga neni 290/1-e i K.Pr.Penale.

LAJME SHKURT

■ **Vëllai i Gilmandos: Armën s'e kishte Shullazi**
Vëllai i Gilmando Danit dhe shoku i tij, kanë dëshmuar dje në procesin gjyqësor në ngarkim të dy të pandehurve Emiljano Shullazi dhe Gilmando Dani të akuzuar nga prokuroria për armë mbajtje pa leje. Vëllai i Danit, ka pohuar para gjyaktës se armën tip pistoletë që ka sekuestruar policia në cilësinë e provës materiale, ia ka parë vëllait të tij Gilmando Dani dhe jo Emiljano Shullazit. Ai tregon se teksa ishte duke dalë nga banesa, i ka pohuar të vëllait se pse e mbante me vete armën, por ai i është përgjigjur se e mbante për vetëmbrojtje, pasi i kishte shpëtuar një atentati mafioz. Ndërkohë që në të njëjtën linjë ka qëndruar dhe dëshmitari tjetër, i cili ka qënë i pranishëm në makinë, kur janë arrestuar Emiljano Shullazi dhe Gilmando Dani.

■ **Mbytet në lumë 40 vjeçari nga Gramshi**
Trupi i pajetë i një personi të seksit mashkull është gjetur mbremjen e djeshme në Gramsh. Policia thotë se kufoma i përket një personi rreth 40 vjeç dhe është gjetur në lumin Devoll, në fshatin Bersnik. Forcat e rendit kanë shkuar në vendngjarje dhe nga ekzaminimet e para dyshohet se viktima është Halil Xaka, 31 vjeç, nga Gramshi. Policia tha se i ndjeri nuk ka dëmtime në trup, çfarë shton dyshimet se Xaka mund të jetë mbytur aksidentalisht në lumë.

Kërkon 6 mln lekë

Pacientja, padi dentistit për dhëmbët

■ ■ ■ TIRANE

Një paciente ka paditur në gjykatën e Tiranës, dentistin Maksim Musabelliu duke pretenduar se ky i fundit gjatë kurimit të dhëmbëve i ka shkakuar dëme në shëndetin e saj. Yllka Çipi në padinë e saj tregon se Musabelliu gjatë kurimit të dhëmbëve i ka shkakuar thyerjen e protezës, dhe nisur nga ky dëm ajo kërkon prej dentistit shumën prej 6 milion lekë të vjetra. Shehaj në kërkesë padinë drejtur gjykatës ka pretenduar se i padituri i ka bërë një protezë të palëvizshme porcelani për gojën. Pas përfundimit të punës ka pasur dhembje dhe probleme shëndetësore me nofullat dhe tek dhëmbët e saj ku mbështetej ura. Është drej-



tuar përsëri tek i padituri i cili fillimisht e ka qetësuar me argumentimin se nuk kishte ndonjë gjë dhe se do të duhej kohë të mësohej me protezën e re. Pas ankesës së përsëritur të saj, i padituri ka bërë ndërhyrje në dhëmbë pa hequr protezën dhe megjithë faktin se ajo kishte dhembje dhe ishte e enjtur. Ajo vazhdonte të kishte probleme dhe dhembje, një dhëmb i protezës u thye dhe me kalimin e një viti i padituri nuk pranoi ta diagnostikonte dhe mjekonte më tej, duke pretenduar se punimet ishin me një afat një vjeçar dhe për periudhën më tej nuk ishte përgjegjësia e tij. Paditësja duke pasur parasysh debatet e bëra me të paditurin është paraqitur tek një klinikë tjetër stomatologjike, poliklinika

dentare "Ufo", dhe pas vizitës ka ardhur në dijeni të faktit se ura ishte thyer aty ku ishte ndërhyrje nga i padituri, ajo urë nuk duhet të ishte vendosur pasi kishte pak dhëmbë të saj etj. Më pas paditësja i është drejtuar Urdhërit të Mjekëve Këshillit Rajonal Tiranë i cili me vendimin e tij ka vendosur që i padituri ti bëjë paditësës rehabilitim oral me një punim të ri tjetër protekt, në përputhje me standartet e protezimit dhe pacientja pas përfundimit të punës të kalojë për ekspertim pranë klinikës përkatese Universitare Stomatologjike. Një trajtim i tillë nuk është pranuar të bëhet nga mjeku Musabelliu dhe për pasojë pacientia Çipi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar 6 milion lekë dëmshpërblim.

Shpërthen tritoli plagosen tre persona në Mat

Tre persona kanë ngelur të plagosur rëndë si pasojë e shpërthimit të një sasive tritoli në rrethin e Matit. Dy vëllezërit Fatjon e Festim Gjeta dhe një kushëri i tyre, Admir Nura, janë personat e plagosur rëndë në Mat si pasojë e shpërthimit të eksplozivit gjatë punimeve për hapjen e një rruge. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 18:00 në fshatin Dars të Klosit.

Policia ka thënë se të plagosurit po punonin privatisht për hapjen e një rruge në fshat. Mësohet se si rrjedhojë e plagëve të marra nga shpërthimi i tritolit të lënduarit kanë marrë plagë të rënda dhe janë nisur me urgjencë drejt Spitalit Ushtarak në kryeqytet me helikopter. Ende nuk dihen rrethanat e plota të ngjarjes dhe as fakti nëse sasia e tritolit është përdorur

për hapjen e rrugës apo punëtorët e kanë ndeshur gjatë punës. Personat që kanë qënë në vendin e ngjarjes kanë lajmëruar policinë, efektivat e të cilës kanë shkuar me shpejtësi në zonën ku ndodhi ngjarja. Policia ka bërë transportimin për në spital të tre të plagosurve, ndërkohë që nga hetimet e kryera ka rezultuar se ngjarja ka qënë aksidentale.

Prokuroria e Tiranës i komunikon akuzat Armand Kasa

Fshiu pamjet filmike Kasa i pandehur

Ende pezull pozicioni i 5 gardistëve të dyshuar

Lajmi

Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar akuzën inxhinierit të IT-së në kryeministri Armand Kasa, pasi nga hetimet ka rezultuar se ai ka bërë fshirjen e pamjeve filmike nga serveri i kryeministrit. Vetë Kasa, s'ka pranuar të japë shpjegime, duke pretenduar se do flasë vetëm para gjykatës.

■ ■ ■ TIRANË

ELTON QYNO

Armand Kasa, ish-inxhinieri i IT-së në kryeministri është marrë i pandehur nga prokuroria e Tiranës. Nën shoqërimin e avokatit të tij, Kasa është paraqitur në prokurori dy ditë më parë ku është njohur me akuzën e "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Kryerjes së veprimeve që pengojnë zbardhjen e të vërtetës". Mësohet se pas komunikimit të këtyre dy akuzave, Kasa s'ka pranuar të japë deklarime duke pretenduar se rreth kësaj çështje do flasë vetëm në gjykatë. Nisur nga kjo procedurë ligjore, tashmë prokuroria ka filluar qepjen e dosjes dhe dërgimin e saj në gjykatë. Të pyetur nëse ka persona të tjerë që janë marrë të pandehur rreth fshirjes së pamjeve filmike nga serveri i kryeministrit,



Armand Kasa

burimet pranë prokurorisë së kryeqytetit nuk pranuan të jepnin asnjë koment duke, ja lënë kohë në vashdim për të mësuar se përveç inxhinierit Kasa, do të ketë ose jo të pandehur të tjerë.

KASA PËR FILMIMET

"Nuk kam bërë asnjë fshirje, thjesht kam bërë kopimin dhe ia kam dorëzuar në dorë

Gardës së Republikës dhe Prokurorisë"- kjo është deklarata që Armando Kasaj ka bërë menjëherë pas daljes nga gjykata e Shkallës së Apelit në Tiranë, e cila vendosi ndryshimin e masës së sigurisë për inxhinierin e IT në kryeministri. Deklarata është bërë dy muaj më parë, ku inxhinieri Kasa ishte paraqitur në

gjykatë, pasi kërkesës së prokurorisë për ndryshimin e masës së sigurisë.

GARDISTËT E DYSHUAR

Pesë punonjësit e Gardës së Republikës, që në 21 janar kanë pasur si detyrë të ruajnë dhe administrojnë serverin që regjistron pamjet filmike të kamareve të kryeministritë vashdojnë të verifikohen nga prokuroria e Tiranës. Ervina Osmani, Bledar Lika, Aurora

direkt mbi personat e sipërcituar të cilët në orët e vona të 21 janarit si dhe në orët e mesnatës së 22 janarit kanë qëndruar në kryeministri, pikërisht në zyrën ku ndodhë serveri. Sipas burime pranë njësive hetimore Task-Forcë në prokurorinë e Tiranës, praninë e tyre në zyrën ku ndodhë serveri e ka dëshmuar dhe i pandehuri Armand Kasa, i cili në dëshminë e tij tregon se personat e përmendur kanë marrë në ruajtje dhe administrim serverin.

"Nuk kam bërë asnjë fshirje, thjesht kam bërë kopimin dhe ia kam dorëzuar në dorë Gardës së Republikës dhe Prokurorisë"- kjo është deklarata që Armando Kasaj

ende nuk i janë dorëzuar organit të prokurorisë së Tiranës. Nuk dihet më saktësi nëse nga gardistët e dyshuar do meret i pandehur, por mësohet se gjatë marjes në pyetje ata kanë mohuar çdo pretendim të prokurorisë së Tiranës se ata mund të kenë gisht në fshirjen e pamjeve filmike.

Allkanjari, Ervin Lelaj si dhe drejtori Arben Shkodra, dyshohen se kanë marrë pjesë në fshirjen e pamjeve filmike të datës 21 janar 2011, ditë kjo kur ndodhi dhe demonstrata e dhunshme. Dyshimet se përveç Armando Kasa, në formimin dhe fshirjen e pamjeve filmike kanë marrë pjesë dhe persona të tjerë, kanë rënë

LAJME SHKURT

■ I vdes gruaja, vetëvritet 56-vjeçari

Një 56-vjeçar është gjetur i vetëvarur mbrëmjen e djeshme në Tiranë. Ngjarja ka ndodhur në zonën e ish-bllokut, ndërsa policia thotë se viktima është shtetasi Vasillaq Gjini, 56-vjeç. Ai mësohet se është vetëvarur në banesën e tij ndërsa gjashtë muaj më parë i kishte vdekur edhe bashkëshortja. Efektivat e policisë së Tiranës kanë mbërritur në vendngjarje dhe po hetojnë për zbardhjen e plotë të kësaj vetëvrasje. Hetimet paraprake tregojnë se 56-vjeçari kohët e fundit vuante nga depresioni.

■ Aksidenti në Fier, dy të plagosur rëndë

Dy persona u plagosën në një aksident automobilistik në aksin ruqor Lushnjë-Fier. Ngjarja ndodhi tek "Rotondoja e Kolonjës", ku sipas policisë, janë përfshirë në aksident një automjet dhe dy kamionë. Të plagosurit, janë dërguar në spital për marrjen e ndihmës së nevojshme mjekësore, ndërsa mësohet se janë në gjendje të rëndë për jetën. Forca të shumta policie kanë mbërritur në vendngjarje dhe po punojnë për zbllokimin e trafikut dhe zbardhjen e shkaqeve të aksidentit.

■ Vlorë, kapet i kërkuar nga drejtësia italiane

Sektori i Operacioneve Speciale dhe Kërkimit në Drejtësi dhe Policisë së Qarkut Vlorë ka finalizuar me sukses operacionin policor të koduar "Kujtesa" për kapjen dhe arrestimin e shtetasit të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga interpol Arben Isufi me pseudonimin (Purizio), 51-vjeç banues në lagjen "Pavarësia" Vlorë. Kapja dhe arrestimi i këtij shtetasi është kryer pasi në ngarkim të tij nga Gjykata Penale e Reggio Calabria Itali është lëshuar Urdhër-Arresti Ndërkombëtar Nr. 96/99 datë 10.07.1999 pasi ky shtetas dyshohet se ka drejtuar një organizatë kriminale me anëtarë shtetas shqiptarë dhe italianë me qëllim trafikimin e narkotikëve dhe qënieve njerëzore në drejtim të Italisë në vitin 1998. Ky shtetas pritet ti nënshtrohet procedurave ligjore për ekstradimin e tij për në Itali.

Trafikoi një 23 vjeçare

15 vite burg për trafikantin e femrave

■ ■ ■ TIRANË

Shfrytëzoi si prostitutë në Itali një 23-vjeçare, por tashmë është dënua me 15 vjet burg e 6 milion lekë gjobë. Bëhet fjalë për shtetasin Gjergj Mirashi, i cili është shpallur fajtor nga Gjykata e Krimeve të Rënda për akuzën e "Trafikimit të femrave për prostitucion" duke u dënua me një masë prej 15 vite heqje lirie. Ka qënë gjyqtari Guri Brahimi ai që pas 64 senancash gjyqësore ka vendosur të shpallë fajtor të pandehurin Gjergj Mirashi. Ky i fundit gjykohej në mungesë, pasi aktualisht nuk është mundësuar arrestimi i tij nga Policia e Shtetit. Ndërkohë që çështja penale



ndaj tij është ngritur pas një kallëzimi të bërë nga e dëmtuara, 23-vjeçaria me inicialet E.B., e cila ka treguar në polici se është mashtruar nga i pandehuri Mirashi. Ky i fundit i ndihmuar dhe nga persona të tjerë, ka mundësuar trafikimin e saj në Itali, ku më pas e ka detyruar nën presionin e dhunës fizike dhe asaj psikologjike të punojë në rrugë si prostitutë. Në dëshminë e saj e dëmtuara tregon se ka punuar për disa vite me rrathë si prostitutë dhe se të gjitha të ardhurat financiare ia jepte të pandehurit Gjergj Mirashi. Shumat financiare që ajo fitonte çdo natë kapnin shifrën prej rreth 700 deri në 1 mijë euro, para këto që çdo mbrëmje ia

dorëzonte të pandehurit të dënua tashmë me 15 vjet burg. Nga "kthe-trat" e tij e dëmtuara tregon se ka shpëtuar atëherë kur teksa ishte duke pritur në rrugë klientë, ajo është kapur nga karabinierët të cilët e kanë transportuar në një qendër ku mbaheshin femrat e trafikuar. Prej atëherë më pas ajo është riatdhesuar në Shqipëri, ku pasi i është bashkuar familjes, disa ditë më pas ka shkuar në polici ku ka denoncuar të pandehurin Gjergj Mirashi për akuzën e "Trafikimit të femrave për prostitucion". Nga hetimet e kryera dhe gjykimi i çështjes Mirashi për këtë veprë penale u shpall fajtor në mungesë me 15 vjet heqje lirie dhe 6 milion lekë gjobë.

Rama: Qeveria mashtron me turizmin 60 mln euro më pak

Sipas kreut të PS Edi Rama, Banka e Shqipërisë raporton se, që nga viti 2009, rënia e të ardhurave nga turizmi është 140 milionë euro. Sipas kryeministrit, shkruan Rama në Twitter, numri i turistëve në vitin 2011 u rrit me 550 mijë turistë, por, sipas BSH, 60 milionë euro më pak hynë në vendin tonë. Rama ironizon Ministrinë e Turizmit, në

faqen online të së cilës Tirana u shfaqet të huajve me foton e një arre, "të emërtuar me një anglishte fantastike: Baba Nuts Myslimi". "Në gusht-shtator 1944, në kulm të luftës, Shqipëria kishte revistë zyrtare për turizmin. Sot nuk ka, por ka një ministri me një çështje qesharak", shton lideri socialist. "Në vitet '30, edhe në Theth kishte zyrë turizmi, sot nuk ka as

mjek për 15 mijë vizitorë që shkojnë në Theth falë vetorganizimit të mikpritëseve". "Politika jonë e re turistike do të ndërtohet duke mos e marrë parasysh kufirin e Shqipërisë me Kosovën. Kështu do të kemi ofertë për 12 muaj. Shqipëria ka 1.000 vendndodhje të trashëgimisë kulturore", shkruan ai, duke thënë se dy vendet mund të fitojnë shumë bashkë.

Kundër neneve të Kodit, asnjë lek për vjetërsi

Lajmi

1.200 ish-punonjës të shkurtuar nga reforma para privatizimit e Albpetrolit kanë zhvilluar dje protestë në Fier, duke u takuar edhe me Avokatit e Popullit. Atyre nuk u paguhet vjetërsia në punë, e drejtë që e kanë nga Kodi i Punës

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Duke shfrytëzuar vizitën e Avokatit të Popullit, Igli Totozani, në Fier, ish-punonjës të kompanisë Albpetrol, u mbledhën dje pranë Bashkisë së qytetit, duke kërkuar zgjidhjen e çështjes së shkurtimeve të tyre nga puna. Më shumë se 1.200 naftëtarë, të dalë të papunë nga reforma e vitit 2010, nuk përfitojnë vjetërsinë e punës në përputhje me Kodin, në një kohë kur kompania është futur në proces privatizimi.

Avokati i Popullit ka premtuar ndjekjen e çështjes. Totozani ndodhet sot në Fier për nënshkrimin e një marrëveshjeje me shoqërinë civile dhe zhvilloi edhe një takim me kryetarin e Bashkisë.

SHKURTIMI

Vendimet e para të qeverisë për shkurtime, pas vitit 2005, kanë qenë ato të viteve 2008 dhe 2010, me shkurtime përkatësisht 1.100 dhe 1.294 punonjës. Është koha kur Albpetrol i jep më shumë të drejta shfrytëzimi të naftës kompanive koncesionare, kështu që ka nevojë për më pak fuqi punëtore. Aktualisht, në rast se do të zbatoheshin këto vendime, ndërmarrja do të kishte 1.651 punonjës gjithësej. Por, ç'ka ndodhur, në fakt?

Në qershor 2009 ishin zgjedhjet parlamentare, ndërkohë që në maj 2010 ato vendore. Në dhjetor 2009, u shkëput një shtesë prej 1.229 punonjësisht, ku 901 ishin punonjës krejtësisht të rinj dhe 328 të ardhur nga bashkimi me kompani tjetër. Në vitin 2010, Albpetrol ka 4.467 punonjës, edhe më tepër se sa kishte në 2005-ën. Problemi ishte tani që



nuk mund të injoroheshin vendimet qeveritare për shkurtimet, kështu që u vendos edhe nga shoqëria që të iknin 1.294 punonjës.

Sipas Kodit të Punës dhe VKM-ve, ata duhej të trajtoheshin me nga një vit pagë secili, plus vjetërsinë e punës, që llogaritet me 15 ditë për çdo vit pune.

FONDI

Fondi i njohur nga qeveria, që Albpetrol duhet ta paguante nga fondet e veta, për pagesën e punonjësit që largoheshin ishte 600 milionë lekë të reja, ku përfshihen paga njëvjeçare dhe vjetërsia. Mesatarisht, i binte që çdo punonjësi i larguar të paguhej edhe me 8.7

TENDERI

Albpetroli blen 750 mijë dollarë karburant

Shoqëria Albpetrol, ende në pronësi të shtetit, ka shpallur tenderin me objekt prokurimi "blerje karburante gazoil D1 dhe benzinë", me sasi si më poshtë: 1. 398.500 litra gazoil D1 dhe 16.600 litra benzinë. Fondi i limitit i vënë në dispozicion nga të ardhurat e Albpetrolit është, për gazoilin e tipit D1 do të paguhet 60.5 milionë lekë pa TVSH dhe për benzinën 2.4 milionë lekë të reja pa TVSH. Sipas njoftimit, të publikuar te faqet zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, afati për dorëzimin e mallit është 365 ditë (furnizim çdo muaj për 1/12 të sasive totale). Data e zhvillimit të tenderit është caktuar 18 maji.

paga mujore. Por, drejtori ka vendosur "eliminimin" e fondit për vjetërsinë në punë të atyre që largohen, për të përfituar një sasi të konsiderueshme parash, që do t'i kalonte për të punësuarit e rinj.

Ai vendos të largohen punonjësit e vjetër, por të trajtohen ata si "punonjës të

rinj", që nuk përfitojnë nga vjetërsia në punë. Këtë të fundit e marrin vetëm ata që kanë mbi tre vjet në punë. Me urdhër të tij, punonjësit e larguar duhej të merrnin vetëm një vit pagë, duke i trajtuar shkurtimet për ristrukturim, në fakt, si "pushim të menjëhershëm për shkaqe të justifikuar".

LAJME SHKURT

■ FMN shton mjetet për mbrojtjen nga krizat

Takimi i pranverës i FMN-së e Bankës Botërore përfundoi me rezultate më të mira nga sa pritej: shtetet e eurozonës i vunë në dispozicion FMN-së kredi prej 200 miliardë dollarësh. Christine Lagarde u shpreh e lehtësuar. Shefja e FMN-së Christine Lagarde vazhdon të jetë e shqetësuar për Eurozonën. Ajo është edhe më tej "epiqendra" e reziqeve për ekonominë botërore, tha Lagarde në Uashington. Sipas ministrit gjerman të Financave, Schäuble, kriza e besimit të tregjeve financiare ndaj eurozonës nuk është kapërcyer plotësisht, megjithatë janë marrë vendime thelbësore.

■ Kriza godet edhe kishën ortodokse greke

Me një marrëveshje të 60 viteve më parë, shteti grek pranoi që të mbajë me rroga pritërinjtë. Tani, mbi 10 mijë pritërinjtë në Greqi janë pjesë e sektorit publik dhe përfaqësojnë një shpenzim 190 milionë euro për buxhetin e qeverisë. Duke respektuar marrëveshjen e ndihmës financiare, që shmangu falimentin e pakotilluar, qeveria po redukton pagat dhe pensionet dhe ka ndaluar punësimin në sektorin publik. Tashmë qeveria po punëson vetëm një prift për 10 të tjerë që largohen, duke shkakuar mungesa të shërbimeve. Nëpër qytete kisha ka reduktuar shpenzimet për të mbajtur qendra ushqimi falas dhe strehim.

Fierza

Të përmbyturit kërkojnë zhdëmtim

■ ■ ■ TIRANE

Banorët e zonës verilindore të Bërdit, që kanë humbur tokat dhe pronat e tyre nën ujërat e liqenit të Fierzës, kërkojnë një zgjidhje përfundimtare të problemit të tyre, që po zvarritet prej afro dy dekadash. Në një protestë të organizuar dje, shoqata e banorëve të prekur nga ky fenomen ngriti pretendimin se problemi i tyre nuk po gjen zgjidhje, ndërkohë që nga hidrocentrali i Fierzës, sipas banorëve po fitohen shuma të mëdha parash. "Forcat politike nuk duhet të luajnë me banorët e 36 fshatrave e të një qyteti që janë përmbytur krejtësisht nga ujërat e liqenit të Fi-



erzës. Nëse nuk na zgjidhet problemi ynë, do t'i vazhdojmë protestat e grevat, përfshirë edhe grevat e urisë", u shpreh një prej banorëve, Myftar Cena. Nga ndërtimi i hidrocentralit të Fierzës në vitin 1978 u shkaktua shpërngulja e banorëve të qytetit të Kukësit të vjetër e të 36 fshatrave, tërësisht apo pjesërisht, të rretheteve të Kukësit, Hasit, Tropojës dhe Pukës. Problemi i këtyre familjeve, prej vitit 1993, kur ngritën shoqatën e tyre, ka gjetur deri tani zgjidhje pjesore me vendim të qeverisë nr. 306, datë 30.6.1994 "Për masat që do të merren për zonat e përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukëj, Has, Tropojë e Pukë". Përmes këtij

vendimi, për familjet që dëshiruan të zhvendoseshin në zonën fushore, u vu në dispozicion një sasi toke prej 1.307 ha, prej të cilave 500 ha në rrethin e Durrësit dhe 807 ha në rrethin e Lushnjes. Më pas, doli një VKM tjetër. Si rrjedhojë e zgjidhjeve pjesore ndër vite të problemit, deri tani janë shpërngulur me banim në zonën fushore mbi 650 familje, për të cilët janë shpenzuar nga buxheti i shtetit rreth 6 miliardë lekë. Por, protesta e banorëve tregon se ende nuk është dhënë një zgjidhje përfundimtare për ato familje që nuk pranojnë të shpërngulen, duke qenë se kanë lidhur ekzistencën e tyre me zonën ku janë lindur.



Replika me gjyqtarin

REPLIKË pas deklaratave të vëllait të pishtarit të demokracisë Arben Broci

SOKRAT LLALLAJ

Shtytës për këtë shkrim ma dha një intervistë e dhënë para pak kohësh në TV "Shijak" nga zoti Artan Broci, vëllai i të cilit u vra më 2 prill 1991 në Shkodër gjatë një proteste dhe në përballje me forcat e rendit. Z. Broci është prononcuar disa herë (me të drejtë) lidhur me atë ngjarje dhe, thuajse çdo herë, ka thënë të njëjtat gjëra dhe të njëjtat konkluzione.

Natyrisht që nuk do kisha shtytës për të shkruar, nëse z. Broci do ishte një qytetar i thjeshtë, që shpreh konceptet, mendimet dhe ndjenjat e tij për një ngjarje të dhimbshme. Por, konceptet dhe qëndrimet e z. Broci kanë tjetër peshë, sepse ai është gjyqtar në gjykatën e Apelit të Tiranës dhe, si i tillë, ka për detyrë të jap drejtësi i bazuar në ligj dhe në prova. Konceptet dhe qëndrimet e tij marrin një rëndësi të dorës së parë edhe për shkak të marrëdhënieve që ka me politikën, posaçërisht me z. Berisha. Rëndësia qëndron edhe në faktin e njohur se zgjidhja "juridike" e ngjarjes së 2 prillit ka pasur për protagonist Sali Berishën. Ajo zgjidhje, praktikisht, shënoi marrëdhëniet e Sali Berishës me drejtësinë dhe zanafillën e gjendjes në të cilën drejtësia ndodhet sot.

Meqenëse në atë kohë pata shërbyer përkohësisht si ndihmës i avokatëve mbrojtës të të dënuarve, e pata ndjekur me shumë vëmendje gjyqin e zhvilluar, reagimet e forcave politike dhe të shtypit. Ndërkohë, kam lexuar nga tre libra që janë botuar për atë ngjarje.

Ngjarja e 2 Prillit 1991 në Shkodër, ashtu si të gjitha ngjarjet e tjera të kësaj natyre, ka tre aspekte: aspektin human, politik dhe atë juridik. E shoh të arsyeshme të ndalem në qëndrimet e zotit Artan Broci në të tria aspektet.

1. Në aspektin human, zoti Artan Broci është një qytetar shqiptar që ka humbur vëllain para 21 vitesh dhe që, me të drejtë, ndien dhe do të ndiej dhimbje gjithë jetën. Jo vetëm ai, por gjithë shqiptarët e ndershëm duhet të ndihen solidarë me këtë dhimbje.

2. Zoti Artan Broci, edhe këtë radhë, krahas dhimbjes për humbjen e vëllait të tij, ka shprehur edhe konsiderata politike lidhur me atë ngjarje. Deri këtu, që gjë është normale dhe e mirëkuptueshme. Problemi qëndron në faktin se si e trajton ai çështjen në këtë aspekt.

Ashtu si edhe në intervistat e mëparshme, zoti Broci i përmbahet pikëpamjes se protesta e 2 Prillit ishte "protestë kundër diktaturës komuniste". Një gjë e tillë nuk është fare e vërtetë. Protestat kundër diktaturës u zhvilluan në dhjetor 1990. Të pretendosh se po proteston kundër diktaturës katër muaj pas lejitimit të pluralizmit politik dhe dy ditë pas zgjedhjeve pluraliste politike, të certifikuara si "shumë të mira" nga gjithë grupet vëzhgues ndërkombëtare dhe të pranura nga organizata e kohës, do të thotë se je duke kërkuar një alibi, ose je naiv.

Në një intervistë të dhënë para pak viteve, zoti Broci shkon më tutje kur thotë: "Meqë u pa se nuk mund t'u merrej pushteti komunistëve me votë, atëherë duhej një revolucion...". Nëse ky pohim është i vërtetë, pra, se dikush po përdorte "revolucionin" për të marrë një pushtet që populli nuk ia jep me votë, atëherë nuk duhet që fajin për pasojat ta kërkojë gjëkë. Të ndërmarrësh akte të tilla do të thotë të veprësh në kundërshtim me ato çfarë propagandon dhe me ato çfarë pretendon se do të arrih. Gjithashtu, kjo do të thotë se po vepron edhe në kundërshtim me ligjin. Me aq sa e njoh ngjarjen e 2 Prillit 1991 (dhe besoj se e njoh mirë), ajo nuk ka të bëjë fare me "revolucion", por thjesht me një manipulim dhe keqpërdorim të popullit për qëllime politike.

Në intervistën e tij, zoti Broci i ndan forcat kryesore politike të Shqipërisë në xhelatë dhe engjëj. Sigurisht që engjëjt janë në parti në pushtet dhe xhelatët në opozitë. Nisur nga ky pohim, i bije që vetë zoti Broci të jetë gjysma xhelat (pasi datat e tij kanë qenë komuniste) dhe gjysma engjëj (pasi i ati ka qenë i dënuar politik). Është një pohim ekstrem dhe i përcëmshëm që nuk ka nevojë për koment.

3. Ato që të lënë pa mend në intervistën e tij, janë pohimet dhe konkludimet e tij juridike. Kur

njeriu ka parasysh që ky individ është anëtar i Gjykatës së Apelit, atëherë çështja bëhet shqetësuese dhe e vajtueshme për drejtësinë, e cila është interes i përbashkët i shoqërisë.

Katër personat e vrarë më 2 prill kanë qenë të pafajshëm. Ky ka qenë jo vetëm konkluzioni i organeve të hetimit dhe atyre gjyqësore, por edhe pohimi i ish-të dënuarve për atë ngjarje. Ky ishte edhe qëndrimi i presidentit Ramiz Alia, i qeverisë dhe i PPSH që ishte në pushtet. Të vërteta të tilla i duhen kujtesë sonë se, duke krahasuar ato qëndrime me këto që mbahen për ngjarjen e 21 janarit 2011, arrihet në përfundime objektive. Mirëpo, pafajësia e viktimave nuk mund të shërbejë si alibi për të akuzuar këdo dhe për të dënuar këdo, pavarësisht fakteve dhe provave ekzistuese.

Në intervistën e tij zoti Broci thotë se "para 1990... ishte Partia që i bënte dënimet". Në fakt, nuk është e vërtetë. Pa përjashtuar as mundësinë dhe as rastet konkrete të ndërhyrjeve politike, evërteta ka qenë se Partia bënte ligjet, të cilat, në sferën e të drejtave të njeriut, ishin larg standardeve të vendeve Perëndimore, veçanërisht me standardet e pas viteve '60. Ndërsa dënimet i jepte gjykata.

Zotëria e di shumë mirë se vendimi për dënimin e pesë personave, lidhur me ngjarjen ku ka humbur jetën vëllai i tij, është marrë në Presidencën e atëhershme të Shqipërisë. Këtë të vërtetë ka pasur mundësi ta mësonë nga pjesëtarët e familjes së tij, që takuan presidentin e kohës (Sali Berishën) në Zyrën Presidenciale përpara se të bëhej akuzë; nga avokati i familjeve të viktimave, zoti Nafiz Bezhani dhe nga burime të tjera të pushtetit që menaxhonin procesin gjyqësor.

Mëtej, në intervistën e tij, zoti Broci thotë se "PD-ja nuk i ka pasur të gjitha pushtetet që të zbardhte këtë ngjarje... di që deri më 1996, kur ishte PD-ja në pushtet, u bënte disa tentativa për ta rihapur këtë çështje...". Nga ky pohim lindin tri pyetje: Cilat pushtete nuk ka pasur PD-ja gjatë viteve 1992-1997? Përgjigjen e kësaj pyetje, pavarësisht duan apo jo ta pohojnë, e dinë të gjithë. PD-ja i kishte të vetat: presidentin, parlamentin me mbi 60% qeverinë, SHIK-un, Prokurorinë e Përgjithshme dhe të gjitha shkallët e tjera të hetimit dhe gjykimin penal. Por

mbeten t'u përgjigjet z. Broci dy pyetjeve të tjera. E dyta, tentativa për rihapjen e çështjes u bën se kishte prova të reja, apo për përdorim politik të çështjes, siç thotë z. Nafiz Bezhani në librin e tij? Dhe, e treta, nëse u bënte tentativa të tilla, përse nuk u quan deri në fund, kush i pengoi ato?

Autori i intervistës, siç ka bërë edhe në intervistat të tjera, pretendon se "Kam rreth 12 volume të dosjes së "2 Prillit", të cilat në vitin 1997 u tentua të asgjësoheshin...". Mund të shmanget pyetja, ka apo nuk ka përgjegjësi penale një shtetas që trajton si mall të tijin dokumentet origjinale shtetërore, por nuk mund të shmanget disa pyetje të tjera: Përse i mban shtetas Artan Broci këto dosje, përse nuk i ka paraqitur në organet përkatëse të ndjekjes penale (në të vërtetë, ato janë dosjet e prokurorisë së regjimit të Sali Berishës)? Nëse ato dosje fajësojnë të dënuarit apo ndokënd tjetër, pse gjyqtari e komanduar nga Sali Berisha nuk i dënuan ata? Kur mendon ky zotëri se duhen përdorur ato dosje, se PD-ja ka shtatë vjet në pushtet, veç pesë viteve të mëparshme? Kush ishin ata që tentuan të dëgjnin dosjet dhe kur? Mos ato dosje shfaqësojnë të dënuarit dhe fajësojnë dikë tjetër?

Në intervistë, zoti Broci shpreh brengën se "U bënte disa arrestime, por u liruan në 1997...". Nuk ka pasur asnjë tentativë për të kërkuar falje (nga të dënuarët-shënimi im,S.L.). Prej kujt e kërkon faljen juristi Broci? Prej atyre që "Nuk kishin kurrfarë lidhjeje me krimin", siç e ka pohuar edhe përfaqësuesi ligjor i familjes së tij, z.Nafiz Bezhani? Prej atyre që "Ishin të pafajshëm me provat që disponoheshin", siç ka pohuar ish-Prokurori i Përgjithshëm, i zgjedhur nga PD-ja, apo nga ata që: "As kanë vrarë dhe as kanë dëshnuar që të vinin pushtet e ngjarjes së 2 Prillit", siç shpreh në vendimet përkatëse gjykatat e të tri shkallëve?

Me të drejtë, z. Broci ankohet se në atë ngjarje, "Është bërë kërcënyrë ligjore dhe ekspertiza ka ardhur dy orë përpara se të varroset". Mirëpo, Broci nuk thotë pjesën e dytë të së vërtetës, atë se ishte familja që nuk e lejoi bërjen e autopsisë, çka është e kuptueshme dhe nuk mund t'i fajësoh. Por kjo pengesë do ishte kapërcyer, siç është kapërcyer në shumë raste të ngjashme. Ai që nuk u kapërcye ishte


kundërshtimi i disa drejtuesve të PD-së në Shkodër, me Ali Spahinë në krye (!). Ndoshta Broci e ka të qartë arsyen e këmbënguljes së përfaqësuesve të Partisë Demokratike për të mos e lejuar autopsinë, por kur ke prire për të zbuluar të vërtetën e kupton se atë që di ti duhet ta dinë edhe të tjerët, opinioni. Është e çuditshme se si një jurist (edhe pse është i afërm i viktimave të ngjarjes) i beson me shumë propagandës politike se sa organeve të drejtësisë të shtetit "të vet" dhe avokatit të familjes së tij, i caktuar po nga Sali Berisha (shih librin e N.Bezhanit, "Procesi i Shekullit")? Lexuesi mund të thotë se juristi është njeri dhe dhimbja për vëllanë pushton shpirtin e cilitdo. Kështu është, por dhimbja nuk duhet të pushtojë arsyen, veçanërisht të gjyqtarit, nga i cili shtetasit presin të jap drejtësi. Të madhe e ka dhimbjen për vëllanë e vrarë edhe zoti Ardan Dvorani, gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Madje, plaga e tij është shumë më e re, se vëllai ju vra tre vjet më parë në shpërthimin e Gërdëcit, por, kur i kërkohej të shprehet për përgjegjësitë penale dhe politike, arsyetonte dhe flet si jurist. Nga pikëpamja juridike, tingëllojnë shumë të varfra pohimet e z. Broci se vrasjet e 2 Prillit edhe mund të klasifikohen si "gjenocid". Përkufizimi i konceptit **gjenocid** është i pranuar nga të gjitha Kodet Penale të vendeve të qytetëruar, nga OKB-ja dhe të gjitha konventat ndërkombëtare. Normalisht, një jurist e njeh përkufizimin e gjithëpranuar dhe, për rrjedhojë, e di se as vrasjet e 2 prillit, as ato të 21 janarit, as vrasjet që kanë ndodhur e ndodhin në botë gjatë konfrontimit të policisë me turmat, nuk mund të klasifikohen si gjenocid. Por duket se gjyqtari Broci ka zgjedhur të shprehet ashtu për të qenë në një linjë me propagandën partiake.

Një pohim tjetër i z. Broci është se, "Kam bërë një investigim, nga ku del se, të gjithë ata persona që kanë marrë pjesë në zbardhjen e çështjes së 2 prillit kanë pasur një karrierë shumë të suksesshme". Ka të drejtë, por meqenëse Broci nuk e gjykon të arsyeshme përmendjen e emrave të tyre, unë mendoj se ia vlen t'i kujtojmë, të paktën shumicën dhe më kryesorët prej tyre. Ata, që u graduan menjëherë pas hetimeve dhe gjyqit, ishin: Alush Dragoshi Prokurori i Përgjithshëm, Avni Shehu Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kristofer Peçi Ministër i Drejtësisë, Metush Saraçi anëtarë në Gjykatën Kushtetuese, Arben Qeleshi kryeprokuror i Rrethit Tiranë, Neshat Fana drejtor në Prokurorinë e Përgjithshme, Qazim Gjonaj kryetari i Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prekë Martini kryetari i Gjykatës së Apelit (e vetmja në atë kohë në Shqipëri) dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Është i njohur dhe s'ka nevojë të shpjegohet fakti se të gjitha këto poste u janë dhënë nga Sali Berisha.

Të gjitha "lajdhjet" të mësipërme ua vë vullnë një fakt tjetër shumë domethënës. Sikur të ishte rregulluar nga dora e Perëndisë për të testuar bindjet demokratike dhe moralin qytetar e juridik të atyre që pretendojnë se luftuan e luftojnë për demokraci. Para pak muajsh, zoti Broci kryesoi një trup gjyqësor, i cili duhej të përcaktonte masën e sigurisë për ish-komandantin e Gardës, të cilit i është provuar nga ekspertiza e FBI-se se ka vrarë njërin nga demonstruesit e 21 janarit 2011. Zoti Broci dhe kolegët e tij vendosën lënimin të tij të lirë.

Të kërkojë që të shkojnë në burg ata që "as kanë vrarë dhe as kanë dëshnuar vrasjen" e dikujt (qoftë ky edhe vëllai) dhe, nga ana tjetër, të vendosësh lënimin të lirë të dikujt tjetër që i është provuar vrasja e një njeriu (edhe kur i vranë nuk është i afërm i yti), do të thotë të vësh emocionin mbi arsyen, fitimin mbi të drejtën, favoret që të garanton politika mbi moralin. Në sited, që pasqyrojnë këtë vendim të Broci, komentet ishin jashtëzakonisht të shumta dhe të hidhura. Nuk mund të thuhet se në ç'masë ishin të merituar, por mund të thuhet me siguri se njerëzit të njohin dhe të gjykojnë ashtu si je dhe jo ashtu si kërkon të dukesh.

Dhe, në fund, kam dy këshilla për zotin Broci, që shkojnë edhe për të ngjashmit me të. Së pari, meqë do me shumë Partinë se të vërtetën, është më mirë të merret me politikë se sa të shfaqet edhe më i politizuar se Arant Çela. Së dyti, të ketë parasysh këshillën e Montesekies se, "Kur e kërkon borxhin në vend të gabuar, rrezikon të hysh vetë në borxh".



2 prilli, ku gabon gjyqtari Artan Broci për procesin



Abetarja Mbarëkombëtare fiton teksti i Rrokaj

Duket se teksti i Abetares mbarëkombëtare me të cilin do të mësojnë si të vegjlit në Shqipëri, ashtu edhe ata në Kosovë, është përzgjedhur tashmë. Megjithatë specialistët e ministrisë së Arsimit nuk duan që të jenë të nxituar, pasi zyrtarisht fituesi do të shpallet gjatë ditës së sotme, ata shpjegojnë se nga 7 projekte konkurruese, vetëm dy kanë pasur

rivalitetin më të fortë, mes tyre edhe një bashkëpunim shqiptaro-kosovar. Mësohet se abetarja me autor Bahri Becin, dhe ajo e Shezai Rrokajt janë kandidatet kryesore, për abetaren unike. Megjithatë mësohet se teksti i Abetares me autor Shezai Rrokajn, aktualisht dekanit i fakultetit të Filologjisë pranë universitetit të Tiranës është me pranë fitores. Burime nga komisioni i

verësimit thonë, se ajo ka marrë maksimumin e pikëve si nga pala shqiptare dhe ajo kosovare. Pa dashur të deklarojë shtëpitë botuese dhe autorët fitues një ditë para shpalljes zyrtare edhe këshilltari pranë ministrit të arsimit, Jovan Kristiqi, shprehet se abetarja fituese mori pikët maksimale si për përmbajtjen, anën vizuale dhe çmimin më të mirë të tekstit.

Lajmi

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka përcaktuar që me datë 27 prill, të gjithë maturantët do të bëjnë një test paraprak të maturës shtetërore, për të parë se ku janë. Pikat e dobëta që do të rezultojnë nga ky testim do të shërbejnë si një udhëzues për mësuesit se ku duhet të përqendrohen orët e konsultimeve.

■ ■ ■ **TIRANE**
ESMERALDA KETA

Testi paraprak i maturës për Gjuhën dhe Letërsinë është përcaktuar, ditën e premte, më 27 prill. Një provë, e cila në fakt do të zhvillohet me të njëjtat rregulla si provimi i qershorit i maturës. Ai do të zgjasë një orë e 30 minuta, do të ketë 13 pyetje me zhvillim dhe 12 me alternativë, testet do të jenë koduara, me të vetmin ndryshim që testet do të hartohen nga specialistët e drejtorisë arsimore dhe do të korrigjohen nga vetë mësuesit. Specialistët e ministrisë së Arsimit shpjegojnë se ky test, i cili ngjan shumë me testin final që do u bjerë maturantëve, synon që të evidentojë mangësitë që kanë të rinjtë në programin lëndor. "Me anë të këtij testi ne do të zbulojmë edhe pikat e dobëta të rinjve. Nëse të gjithë nxënësit gabojnë në të njëjtën pyetje do të thotë se me të ka diçka që nuk shkon, ndaj në këtë mënyrë ne do të kemi mundësi të korrigjojmë, ndryshojmë apo riformulojmë një pyetje të caktuar që të mos krijojë probleme për nxënësi. Ta zëmë, nëse një pjesë e madhe e të rinjve gabojnë tek komentit apo te esesa, atëherë me këto dy pjesë do të merren me shumë mësuës gjatë orëve të konsultimeve", - na shpjegojnë specialistët që do të merren me hartimin e testeve. Ndërkohë Drejtorja Arsimore e Tiranës ka njoftuar të gjitha strukturat që të bëjnë përgatitjet, ndërsa tezën do ta përgatisë pikërisht kjo strukturë në varësi të Ministrisë së Arsimit. Paratestimi do të zhvillohet në lëndën e gjuhë-Letërsisë dhe do të bazohet në programet orientuese që kanë marrë maturantët në duar që prej dy muajsh. Duke u njohur

Specialistët: Ku ka mangësi do të bëhen konsultime

Matura, provim të dyfishtë për Gjuhën

Paratestet do të zhvillohen me 27 prill



paraprakisht me nivelin e nxënësve, hartuesit e testeve do ta kenë më të lehtë për të zgjedhur pyetjet e duhura, në mënyrë që të mos i rëndojnë më shumë sec duhet. Udhëzimi pritet të dërgohet këto ditë në të gjitha gjimnazet. "Paratestimi do të ndihmojë në orientimin e nxënësve në lidhje me temat dhe llojet e pyetjeve

që mund të bien në provimet e Maturës", - sqarojnë më tej burime pranë Drejtorisë Arsimore të Tiranës. Këto vlerësime do të orientojnë edhe ekspertët e testeve në lidhje me shkallën e vështirësisë së pyetjeve që do të bien në tezë. Ndërkohë që shumë shpejt pritet që të përcaktohet edhe data se kur do të zhvillo-

RISIA

"Këtë vit tezat e provimit do të jenë integrale"

Sipas ekspertëve të MASH-it, për herë të parë kështu vit do të shkohohej drejt tezave integrale për provimin. "Do të rishikohet struktura e pyetjeve, në mënyrë që të mos ketë pyetje me alternativë shabllone, për të cilat maturantët të zgjedhin përgjigjen e saktë pa u menduar", - shpjegojnë specialistët. Një tjetër ndryshim është kohëzgjatja e testit. "Pavarësisht se koha është më e pakët, maturantët të jenë të qetë, pasi do të kenë kohën e mjaftueshme për t'u përgjigjur të gjitha pyetjeve", - shpjegojnë ata.

het paratesti për lëndën e Matematikës.

KONSULTIMET

Në fund të vitit shkollor maturantët do të zhvillojnë edhe tre javë konsultime, ndërkohë që edhe tashmë gjimnazistët, të cilët në qershor do të testohen për njohuritë që kanë zhvilluar konsultime në ditë të caktuara. Sipas

mësuesve dhe specialistëve të drejtorisë arsimore, të cilët po ndjekin nga afër ecurinë e procesit të maturës shtetërore çdo ditë nxënësit u kërkojnë mësuesve që të ndalen më së shumti në temat që i kanë të paqarta, duke u nisur ehe nga programi orientues i çdo lënde që ka publikuar Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

LAJME SHKURT

■ Invalidët, punësim në administratë

Kryeparlamentarja Jozefina Topalli i ka bërë thirrje drejtuesve të institucioneve publike dhe private, të punësojnë persona me aftësi të kufizuara. Sipas saj, kjo është forma më e mirë e luftës kundër diskriminimit. Deklaratat Topalli i bëri në tryezën e rrumbullakët, ku u prezantua plani strategjik i veprimit 2012-2013 i komisionit kundër diskriminimit. Në tryezë ishte i pranishëm dhe ambasadori Sequi i cili bëri thirrje që kategoritë e diskriminuara të ndërjegjësohen dhe denoncojnë, si dhe shteti të japë më shumë fonde për luftën kundër diskriminimit.

■ Babrru, mbeturinat pushtojnë lumin

Pavarësisht aksioneve të ndërmara nga kryeministri Berisha "Shqipëria e Pastër", situata përgjatë lumit të Babrrusë nuk ka ndryshuar. Aksioni që vazhdoi në të gjithë shkollat dhe institucionet e vendit kishte për qëllim më shumë kujdesje për mjedisin. Por me sa duket askush nuk ka menduar të hedhë sytë nga dy anët e lumit të Babrrusë, që janë mbuluar nga mbeturinat. Situata është problematike prej disa vitesh, e më e vështirë bëhet sidomos në ditët me shi, kur prurjet e lumit janë më të mëdha, dhe marrin me vete edhe mbeturinat e shumta.

Universiteti Bujqësor

Pedagog i jashtëm, shpallen kriteret

■ ■ ■ **TIRANE**

Universiteti Bujqësor ka shpallur kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për pedagog të jashtëm. Kështu përveç diplomës që duhet të ketë në varësi të specialitetit përkatës, është kush që të ketë mbaruar universitetin publik ose jashtë vendit. Këtu mund të specifikohen sipas kërkesave të departamenteve edhe preferenca dytësore në lidhje me diplomimin (përfshirë specifika të profileve dhe shkollim universitar dhe pas universitar jashtë vendit). Duhet të ketë notë mesatare të shkollës së lartë mbi 8,5 si dhe vlerësimin lidhur me mesataren ndryshon për çdo 0.1 unite me 1 pikë, por ky kriter nuk merret në konsideratë kur kandidaturat kanë titullin prof ose Prof.as. Universiteti përcakton se pranohen për konkurrim kandidatët që

KRITERET PREFERENCIALE

■ Master të Nivelit të Dytë jashtë vendit	10 pikë
■ Dr. i Shkencave brenda vendit	15 pikë
■ Dr i Shkencave jashtë vendit	20 pikë
■ Profesor i asociuar	25 pikë
■ Profesor	30 pikë
■ Përvojë pune në profesion dhe mësimdhënie	
■ Çdo dy vjet punë në mësimdhënie në universitet vlerësohet me 5 pikë dhe çdo punë tjetër brenda profesionit me 2 pikë	
■ Kurse kualifikimi jashtë vendit	
■ Për çdo kurs kualifikimi që lidhet me profilizimin e kërkuar, për çdo vit 5 pikë dhe për çdo kurs tjetër specializimi që nuk lidhet me profilin e kërkuar 2 pikë	

zotërojnë diplomën master dhe në rast se ka diplomën Master të Nivelit të Dytë pranohet në konkurrim deri në moshën 40 vjeç, ndërsa ata që kanë gradën dr. pranohet në konkurrim deri në moshën 50 vjeç dhe 55 vjeç është limiti i moshës për ata që janë prof.as. dhe prof. Kandidatët që janë doktoruar jashtë shtetit dhe plotësojnë kriteret e mësipërme parësorë janë preferencialë, të cilat i gjeni në tabelën bashkangjitur. Universiteti ka vendosur edhe një sërë kriteresh plotësuese. Kush ka botuar një tekst mësimor të aprovuar nga departamenti përkatës ka 15 pikë; monografi të aprovuar nga departamenti përkatës ka 8 pikë; artikull shkencorë të botuar brenda vendit merr 5 pikë; artikull shkencorë të botuar jashtë vendit 8 pikë; referime në sesione shkencore, konferenca kongrese brenda vendit ka 5 pikë dhe 8 pikë për jashtë vendit.



Personat me aftësi të kufizuar: Ksera na varfëroi

Personat me aftësi të kufizuara akuzojnë ministrin e Punës dhe Çështjeve Sociale, Spiro Ksera si shkaktoi kryesor i përkeqësimit të gjendjes së tyre ekonomike. Në një deklaratë për shtyp, këshilli kombëtar i organizatave të personave me aftësi të kufizuara, e ka cilësuar atë "arkitekt i madh i mureve të veçimit të këtyre grupeve nga shoqëria". "Ai është iniciator i tre

përkeqësimeve dhe mohimeve të të drejtave të fituara. Në vitin 2010 shkëputi indeksimin e pagesës së aftësisë së kufizuar nga rritja e pagës minimale me objektiv të qartë, ul reduktimin e shpenzimeve të qeverisë dhe deformimin e konceptit të pagesës së aftësisë së kufizuar. Me të njëjtat qëllime, ai ndryshoi edhe ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005 "për ndihmën dhe shërbimet shoqërore". Pra, kjo

pagesë nuk mund të përdoret më për të zburuar përjashtimin shoqëror apo barrierat e tjera, por do të përdoret për të blerë thesën e miellit. Me ndryshimet e fundit ai synon të kursejë ndjeshëm buxhetin e shtetit duke i çuar paraplegjikët, tetraplegjikët dhe të verbrit nën batanije dhe duke izoluar akoma më shumë nga komunikimi me telefon dhe transport", - thonë ata në deklaratën për shtyp.

Drejtori Mihaj: Nuk është e vërtetë, spitali s' do transferohet

Trauma, mjekët: Po e lëvizin për privatin

"Tani është në zero, e shkatërruan me qëllim"

Lajmi

Qendra e traumës dhe të gjithë shërbimet e tjera që ofron spitali universitar Usharak do të transferohen në Zall-Herr. Denoncimi është bërë nga deputeti socialist, Erion Braçe, dy ditë më parë, deklaratë e cila nuk i habiti aspak mjekët e këtij spitali. Ndërsa kreu i këtij spitali, Bedri Mihaj, thotë se spitali Usharak nuk do të lëvizë që aty.

■ ■ ■ TIRANE

ESMERALDA KETA

Mjekët e spitalit Usharak na shpjegojnë se në fakt kjo gjë nuk i habit aspak, dhe madje justifikon gjithë këtë mjerim ku e kanë zhytur aktualisht spitalin Usharak qeveritarët. "Nuk është e habitshme aspak. Kur u krijua më 1994, ishte parashikuar që qendra e traumës të financohej si nga ministria e Shëndetësisë ashtu edhe nga ajo e Mbrojtjes. Por dalëngadalë ajo u la pas dore, madje tashmë gjendemi në një situatë që duan të na "heqin qafe". Vetë ministri i Mbrojtjes, Imami e ka shprehur këtë. Aktualisht ne jemi në zero. Aty nuk ka asgjë. Depot e farmaceutike janë thuajse të boshatisura dhe pacientët janë të detyruar t'i blejnë vetë ilaçet duke filluar që nga betadina e gentamicina, madje edhe bistrurinë dhe garzat, e deri tek antibiotikët më të thjeshtë, në farmacitë përreth. Madje edhe alkoolin e hollojmë me fiziologjik. Si duket po përgatisin terrenin që ta shkatërrojnë Usharakun dhe t'ia lënë vendin spitalit Amerikan që edhe deri tani ka marrë një pjesë të mirë të ambienteve tona, ndërsa ne i kemi ngjeshur së tepërmi të sëmuret tanë", - na shpjegon njeri prej mjekëve të Traumës, që nuk pranon të identifikohet me emër pasi në këtë rast hakmarrja nuk mungon. Ndërkohë që një tjetër mjek, që punon prej vitesh në këtë qendër na shpjegon se Zall Herri, nuk është i përshatshëm as si vendndodhje për një shërbim të tillë. "Trauma është një shërbim i rëndësishëm dhe madje edhe kur është ndërtuar për herë të

parë ky spital nga italianët, është ndërtuar në këtë vend pikërisht për shkak të lehtësisë që u ofron të gjithëve për

shumë i favorshëm, duke pasur parasysh se traumat kanë të bëjnë me aksidentet dhe në një aksident i rëndësishëm është dhe transportimi sa më i shpejtë në spital. Ndërsa në Zall Herr, nuk ka as rrugë kryesore, nuk është fare komod për rrjedhjen e paku, pasi nuk e di se si mund të na çojnë atje dhe ku do të fusin. Kjo është absurde. Me sa duket

duan t'i lirojnë sërish vendin këtij spitali amerikan që kemi ngjitur, por boll salla na ka marrë ai.", - na thotë një tjetër mjek i Traumës së Usharakut. Ndërsa vetë drejtori i këtij spitali, Bedri Mihaj, na shpjegon se nuk ka asgjë të vërtetë që spitali Usharak do të transferohet në Zall-Herr. Askush nuk ka ndër mend ta lëvizë. Për më shumë hajdeni më takoni dhe t'ju sqaroj", - na thotë drejtori Mihaj gjatë një komunikimi

E kanë shkatërruar me qëllim, me sa duket duan t'ia japin të gjithë spitalit privat që na ka zaptuar gjysmën

të mbërritur sa më shpejt në spital. Këtu je buzë rrugës kryesore, shmanj trafikun e qytetit. Ky është një pozicion

shumë i favorshëm, duke pasur parasysh se traumat kanë të bëjnë me aksidentet dhe në një aksident i rëndësishëm është dhe transportimi sa më i shpejtë në spital. Ndërsa në Zall Herr, nuk ka as rrugë kryesore, nuk është fare komod për rrjedhjen e paku, pasi nuk e di se si mund të na çojnë atje dhe ku do të fusin. Kjo është absurde. Me sa duket

duan t'i lirojnë sërish vendin këtij spitali amerikan që kemi ngjitur, por boll salla na ka marrë ai.", - na thotë një tjetër mjek i Traumës së Usharakut. Ndërsa vetë drejtori i këtij spitali, Bedri Mihaj, na shpjegon se nuk ka asgjë të vërtetë që spitali Usharak do të transferohet në Zall-Herr. Askush nuk ka ndër mend ta lëvizë. Për më shumë hajdeni më takoni dhe t'ju sqaroj", - na thotë drejtori Mihaj gjatë një komunikimi

Financimi i spitaleve

ISKSH: Do ndryshojë skema

■ ■ ■ TIRANE

Spitalet publike në vendin tonë do të financohen sipas një skeme të re. Ata nuk do t'i marrin më paratë sipas kërkesave të tyre, por sipas performancës. Pra sa i shfrytëzojnë kapacitetet që kanë. Elvana Hana, drejtore e Institutit të Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor ka shpjeguar se metoda aktuale e pagesës në spitale bazohet në buxhet historik. "Kjo metodë, e shoqëruar me mungesën e autonomisë spitalore dhe nivel jo të mirë menaxhimi është faktor pengues për stimulimin e ofruesve në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe për rrjedhojë nuk stimulon ofrimin e shërbimeve eficiente dhe me kosto efektive."

Kjo lloj metode në të njëjtën kohë nuk rrit besueshmërinë e popullatës dhe të pacientëve tek sistemi jonë shëndetësor dhe gjithashtu nuk favorizon një shpërndarje

Lajmi

Drejtoresha e ISKSH-së, thotë se propozimet kanë të bëjnë me pagesë më buxhet global për ditë qëndrimi dhe shërbim (pagesë që i jepet për menaxhimin spitalor por bazohet në efektivitetin e shërbimit) si dhe pagesë për diagnozë një sistem që e kanë sot shumë spitale evropiane e kombinuar me buxhetin global"

të drejtë të burimeve financiare të bazuara në performancë, në nivele spitalesh apo në popullsinë në cilën ato shërbejnë", - ka thënë Hana. Sipas saj, nga monitorimi i kontratave me spitale ata kanë vënë re se një sërë treguesish të tjerë të aktivitetit spitalor siç është shfrytëzimi i shtratit apo mos-ofrimi i shërbimeve për të cilat spitalet financohen janë në një nivel të ulët. Kështu, kjo metodë financimi nuk i stimulon spitale të jenë të interesuar në ofrimin e shërbimeve eficiente dhe produktive. "Mendojmë se ka ardhur koha që të kalohet në pagesë për performancë që do të thotë pagesë për numrin e pacientëve, ditë qëndrimi në spital dhe cilësinë e shërbimit që ofrohet", - ka thënë më tej ajo.

LAJME SHKURT

■ **Arsimi parauniversitar, sërish debate**
Këtë herë Qendra Shqiptare e Asistencës Arsimore, është kundër kryesimit të Këshillit kombëtar të Arsimit Parauniversitar nga ministri dhe nga prefektët në nivel vendor. "Është një ligj që rregullon atë që quhet pjesa qeveritare. Të tërë instrumentet që funksionojnë të paguar gjejnë veten, ne nuk e kuptojmë se si ka mundësi të pranojmë sot që Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar duhet kryesuar nga ministri i Arsimit. Ai është organ konsultativ", - u shpreh Pëllumb Karameta i Qendrës Shqiptare e Asistencës Arsimore.

■ Bashkia e Tiranës:

"Monumentet flasin"
Bashkia e Tiranës ka nisur promovimin e trashëgimisë kulturore të Tiranës. Ky tur ka nisur me nxënës dhe studentë, të cilët janë njohur me disa nga monumentet historike e kulturore. Turi ka nisur nga Kulla e Sahatit, për të vijuar në kompleksin e Toptanëve, Urën e Tabakëve, Mozaikun e Tiranës etj. Nxënësit dhe studentët janë shoqëruar edhe nga nënkryetaria e Bashkisë së Tiranës, Jorida Tabaku. Ajo lançoi edhe projektin e ri të Bashkisë, të titulluar "Monumentet flasin", duke mundësuar që trashëgimia kulturore e qytetit të Tiranës, të vizitohet nga të gjithë turistët dhe kushdo që të vijë në Tiranë, të ketë informacion të bollshëm, të detajuar, për të gjithë këto monumente kulturore.

■ Karta e identitetit do përdoret si kartë shëndeti

Në të ardhmen karta e identitetit do të përdoret dhe si kartë shëndeti. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor po punon për dixhitalizimin e plotë të të gjitha hallkave të sistemit shëndetësor. Kështu, janë farmacitë janë lidhur on-line me ISKSH-në, po hidhen në kompjuter gjithë kartelat e qytetarëve, të cilët janë të regjistruar në qendrat shëndetësore të lagjeve. Ndërkohë, edhe spitalet janë të lidhura on-line me depot farmaceutike. Gjithashtu po hartohen protokollat mjekësore e paralelisht me to po logariten dhe koston për grup diagnoze, në mënyrë që të përcaktohen qartë buxhetet e spitaleve.



Ekspozita

■ ■ ■ TIRANE

DHURATA HAMZAI

Sot në ambientet e Qendrës së Informimit të Bashkimit European çet ekspozita "Objekte-Subjekte" e publicistit Fatos Lubonja. Është një ide që atij i ka lindur gjatë vizitës në fundit në Spaç me fotografen zvicerane Barbara Hausammann. Duke ecur në atë vend tashmë të shkretët, Lubonja vë re copa objektësh që mbanin gjurmët e së kaluarës, gjen aty preken e duarve të bashkëvuajtësve dhe mesazhe të tjera nga vuajtjet dhe puna e rëndë e të burgosurve politikë të Spaçit. Prekja e këtyre objekteve i ka shkaktuar Lubonjës një trysni të madhe në kujtesë, edhe pse kujtimet nuk janë më të reja për të. Siç shprehet për Shqiptarja.com, ai e viziton herë pas here Spaçin, për të kurrar traumën, për të cilin thotë se është "qendra e Ferrit". Në vizitën e kësaj here ai ka shkruar deri tek miniera, për të cilën pohon se ajo ende e ruan misterin e saj. Aty ka mbledhur disa nga copat gati të thërrmuara të litarëve prej telash çeliku, të cilat do t'i shërbejnë si epilogu i kësaj ekspozite sot, por edhe një gjysmë-lopatë të ngrënë nga ndryshku, një tel me gjemba, etj. Me një ekspozitë të tillë arti, Lubonja thotë se "ka stimuluar një muzeum". Mënyra sesi e ka konceptuar rifutjen në kujtesë të këtyre objekteve në dekompozim e sipër, nëpërmjet gjuhës moderne të arteve figurative, krijon shumë pika takimi me publikun dhe artdashësit. Gjurmët flasin, të shoqëruara me copëza historie, për njerëz të thjeshtë dhe personalitete të njohura e të panjohura sot. E, ndërsa Lubonja vetë me gjuhën e artit ka stimuluar një muzeum, lind pyetja se kur do të ketë vetë Shqipëria një muze për burgjet dhe krimet e komunizmit, siç ka në të gjitha vendet ku ato kanë ndodhur. Këtë pyetje shtror edhe fotografja Barbara Hausammann, e cila theksoi se këto veptra të Lubonjës bashkë me objektet dhe historitë e shënuara poshtë tyre duhet t'i përkasin një muzeu. "Kush do të flas për atë kohë, një ditë kur ai të mos jetë më dhe të tregojë, dhe që dihet se shumë të tjerë kanë shkruar? Është mëkat të rrinë të mbyllura. Pse të mos ketë Shqipëria një muze për krimet e Diktaturës, siç kanë edhe vendet e tjera", tha ajo për Shqiptarja.com.

Zoti Lubonja, pse menduat që objektet e gjetura në Spaç t'i kompozoni në art konceptual siç rasti i kësaj ekspozite?

— Është një nevojë e brendshme për të shprehur mbresat e një vizite, mbresat e një vizite në Spaç që është një vend i traumës, jo vetëm personale, por edhe i traumës së shumë njerëzve, dhe është një nga format e shprehjes së gjithë atyre emocioneve që përjetova në këtë vizitë në fund fare. Ashtu sikurse një piktor shkon të bëjë një peizazh që i pëlqen dhe e godet, në një farë mënyre, kjo është i jetëgj. Është një art konceptual që kërkon të sjellë tek spektatori, i cili në artin konceptual bëhet pjesë, hyn brenda, duke stimuluar një muzeum. Pra të duket si muzeum, por ideja është që kur ti hyn brenda këtij muzeumi të përshihesh.

Për mua ky koncept është stimulimi i një muzeumi me objekte e gjetura, të cilat janë dhe nuk janë muzeale. Janë objekte banale, si vegla pune, dhe në të përfshihen të gjitha historitë që janë të lidhura me këto objekte. Sepse çdo objekt ka evokuar një kujtesë, një histori, ka evokuar një personazh, një figurë.

Ajo miniera që shikohet nga jashtë, por nuk shikohet nga brenda, ka qenë një qytet



FATOS LUBONJA:

Shkoj në Spaç për të kurrar traumën

"Objekte nga 'qendra e ferrit' në një ekspozitë konceptuale"

më vete, i mundimit, i vuajtjes. Ajo është qendra e ferrit në Spaç. Te miniera brenda është tentuar të tërhiqen, madje janë mbledhur disa gjëra dhe janë sjellë në Tiranë. Unë dua t'i them publikut që të hyjë brenda dhe nga kjo ekspozitë kërkohej që t'i ngjallen emocionet, të hyjë në atë atmosferë.

Megjithëse janë copa objektësh, ju keni përfunduar me një ekspozitë artistike. Cilat janë lidhjet tuaja me artet figurative?

— Unë jam një... si të thuash, mik i arteve, mik i hershëm i artit vizual. E kam njohur, e kam studiuar, por nuk jam marrë vetë ndonjëherë shumë me mënyrë figurative. Është një miqësi që herë pas here ka shpërthime dashurie. Kam bërë edhe një ekspozitë të tjetër prirur nga arti konceptual, siç ka qenë ekspozita "Fjala", që e çova edhe në ShBA. Kam bërë instalacion në një libër timin me letrat e duhanit, ky instalacion u quajt "Përpiqja". I bëj vetë herë pas here, kur kjo miqësi imja me artet figurative ka ndonjë akt krijues, sidomos me nevojën për t'u shprehur edhe me mjete të tjera, sepse letërsia, gazetaria, të gjitha janë në fund fare mjete shprehëse të vetvetes. Ky është në një farë kuptimi medial sepse këtu ka edhe fo-

"OBJEKTE-SUBJEKTE" Çfarë do të tregojnë objektet e gjetura nga vizita më e fundit Fatos Lubonjës në Spaç sot në ambientet e Qendrës së Informimit të Bashkimit European. Në intervistën për Shqiptarja.com, Lubonja rrëfen arsyet e rikthimit të kujtesës përmes një arti konceptual si kundërpërgjigje e mungesës së një muzeumi

ton, ka dhe objekte ka dhe historinë, sepse ka edhe tekste ky instalacion.

Kontrasti mes kujtesës së përsëritshme që keni ju si person dhe asaj shkretie që ka mbetur çfarë ju thotë, nëse i referohemi vizitave më të fundit tuajat në Spaç?

— Pikërisht ajo ideja e muzeut që të duket pak muze arkeologjik, edhe provokimi i Muzeut është pjesë e asaj tentativës për ta ringjallur, për t'i dhënë jetë asaj që ishte. Që ishte dhe s'është më, sepse është në kujtesën tonë. E kaluara në një farë kuptimi e zhdukur, rimerret dhe bëhet pjesë e së tashmes. Pra është pak e vështirë të thuash që ekziston ajo që ishte. Edhe ekziston, edhe nuk ekziston, vërtet nuk e gjen më, por është në kujtesën e çdokujt dhe pikërisht kjo lojë midis kujtesës dhe asaj që s'është më, por dhe nevojës për të sjellë këto trauma, shtron edhe pikëpyetje të mëdha si: çfarë është kujtesa, çfarë i përket së tashmes dhe çfarë të kaluarës, çfarë harrohet e çfarë nuk harrohet. Apo nganjëherë nuk ka kuptim të flitet për gjëra të harruara përdërisa janë kujtuar... Është një lojë e rëndësishme kjo pra dhe arti ka në njëfarë kuptimi pasi synon të krijojë esencën e asaj që nuk duhet harruar.

Cili ishte mendimi i parë, që ju çoi tek kjo ekspozitë. Përse kishit marrë me vete dhe fotografen zvicerane Barbarën?

Mendimi i parë ishte nostalgjia e hidhërimit. Unë kam shkruar për këtë ekspozitë, për kthimin dhe rikthimin tim në Spaç. Herë pas here në Spaç ekziston një nevojë për t'u kthyer. Është një nevojë jo vetëm si kthimi tek vendi i traumës, por edhe një nevojë e brendshme për të kurrar traumën dhe nevojën për ta dokumentuar gjënë. Ishte një vizitë që në fund fare mua më shërbente në pjesën e ekspozitës, ndërsa Barbarës, fotografes i duhej për të mësuar një pjesë që nuk e kishte jetuar, pra për të hyrë në jetën time, në botën e asaj vuajtjes si një e huaj. Ky takim solli vizita, pastaj solli dokumentimin, pastaj ajo bëri vizita ndërsa unë mora këto objekte që më evokonin në kujtesën time histori të veçanta të bashkëvuajtësve.

Për cilin nga bashkëvuajtësit të merr më tepër malli...që kërkon me patjetër gjurmët tyre?


Më shumë më merr malli për ata që kanë vdekur, që s'mundën të shikojnë përmbyshjen e regjimit në Shqipëri, atë periudhën e pasburgut. Janë ata që më mungojnë, veçanërisht Fadil Kokomani, me të cilin jam rridënuar, për të cilin kam shkruar dhe librin "Ridënim". Ata janë pjesa më dhimbshme e kësaj drame, e kujtimeve të mia.

Ju keni në ekspozitë tre kuti qelqi me mbetje e një litari, me pluhurin dhe dherat përreth?

Ai është epilogu i kësaj ekspozite. Është metafora që qëndron mbrapa asaj historie. Është metafora e shenjtëritimit të atij vendi vuajtës dhe atyre figurave dhe atyre të tjerëve, është një metaforë që i kundërvihet harresës... që edhe një pikë pluhuri ka kujtesë. Mban kujtesë.

U shprehët se objektet e gjetura në Spaç kanë mbetur si gjurmë arkeologjike. Por, në të vërtetë, gjurmët e asaj kohe, a janë aq të largëta, apo janë të pranishme. A përsëritet ajo kohë tani. A jemi ne të prekur ende nga sindroma e Diktaturës?

— E para gjë që duhet thënë është se në qoftë se do t'i bëjmë një përkufizim asaj diktature dhe asaj vuajtjeje, po të përcaktojmë me një fjalë e thjeshtë do ishte dehumanizimi i njeriut. Njeriu ka potenciale të mëdha për të



Disa nga objektet që ekspozohen sot në ekspozitën "Objekte-Subjekte" të Lubonjës

krijuar dhe regjimi i atillë e dehumanizon njeriun. Në këtë mënyrë edhe kujtesa e njeriut për ata që u dehumanizua i shërben humanizmit. Për fat të keq edhe për shumëcka që po ndodh sot në shoqërinë shqiptare, që unë e kam konsideruar si vazhdimësi e asaj kohe është një lloj dehumanizimi. Pra dehumanizimi ku nuk është njeriu në qendër të vëmendjes, nuk është dashuria për njerëzit, nuk është kujdesi por është në shoqëri të dhunës, të krimet të abuzimit me pushtetin si atëherë dhe të gjitha këto lënë gjurmë dhe krijojnë trauma të reja. Moskurimi i traumave të vjetra është pasojë e kësaj.




DOKUMENTARI Cfarë ndodhi mbrëmë në Kinema Milenium pas shfaqjes së dokumentarit për historinë e diktatorit Enver Hoxha. Reagimet dhe qëndrimet e politikanëve. Cilat janë ato mendime që bashkuan dje Nanon me Berishën

Liria Belishova: Jam e kënaqur shumë me dokumentarin e Enver Hoxhës

Embijetuara e vetme prej anëtarëve të Byrosë Politike, Liri Belishova, që më pas u dënua me burg dhe u internua në kampe pëqëndri-

mi ishte e pranishme. Jam shumë e lodhur dhe e drobitur nga filmi. Më mundojnë kujtimet. Unë i thashë dy fjalë Blendi Fevziut. I thashë që ka bërë një gjë të madhe për këtë komb. Është mirë të thuhet të vërteta si kanë qenë. Nuk është e lehtë të përfytyrohet e gjithë ajo që ka ndodhur. Një ditë tjetër do t'u them më shumë. Kam shumë emocione. Personalisht jam shumë e kënaqur dhe e lehtësuar nga dhimbjet që u bë ky film. Unë e falënderoj Fevziun, por gjithë shqiptarët duhet të falënderojnë dhe të jenë mirënjohës.



Liri Belishova e emocionuar i rrëfhet Fatos Nanos

Dokumentari i Fevziut për diktatorin bashkon në një tryezë Nanon dhe Berishën

Blendi Fevziu: Historia e Shqipërisë mbështillet me shumë mistere

■ ■ ■ TIRANE

DHURATA HAMZAI

vijon nga faqja 1

...të përbashkët. Kishin ardhur vetë kryeministri Sali Berisha i shoqëruar nga Kryetarija e Kuvendit Jozefina Topalli. Pak minuta para tij erdhi Fatos Nano i shoqëruar nga bashkëshortja Xhoana, të cilët u ulën në krah të njërit prej përfaqësuesve të Partisë Demokratike, z.Sokol Olldashit. Nano dhe Olldashi kanë komunikuar biseda të vazhdueshme nën zë gjatë shikimit të filmit. Ndërsa pas shfaqjes Kryeministri Sali Berisha ulet në tryezën e koktejit bashkë Fatos Nanon dhe zonjën e tij Xhoana, dhe mes tyre ishte sërish Sokol Olldashi si iniciator i bisedave të futura në



rrath të ngushtë mes tyre. Ata jo vetëm dhanë mendime për dokumentarin, por nisën të kenë diskutime shumë të afërta dhe konfidenciale. Nano dhe Berisha ishin të dy në gjendje humori të lartë dhe nuk i kanë kursyer buzëqeshjet deri në fund të koktejit. Ndërsa zonja Topalli, e cila gjatë shikimit të filmit qëndronte në krahun e djathtë të Berishës largohet menjëherë pas shfaqjes dhe nuk qëndron me grupin e demokratëve në kokteje. U vu re në atë shfaqje mungesa e Kryetarit të PS, Edi Rama. Pas bujës që bëri dalja në treg e Librit të Enver Hoxhës nga Blendi Fevziu, nuk munduan personalitetet të fushës së politikës dhe artit, si dhe media. Shfaqja e filmit zgjati 76 minuta, sipas të gjitha atyre etapave që shkoi jeta e Enver Hoxhës. Kësh-

tu që mbeti edhe një pikë takimi në kontekste të tjera. "Urime, i thotë Fatos Nano, Blendi Fevziut, kur të jesh "më i lirë" se kaq dua të pimë një kafe e të bisedojmë shtuar".

Në dokumentar shfaqeshin filmime speciale nga arkivi i shtetit të

cilat shoqëroheshin nga shënime të cilat janë edhe në librin "Enver Hoxha" të Fevziut. 76 vitet e jetës së diktatorit nisin me ditët e fundit të jetës së tij, "kur komunikimi me botën përreth ishte bërë fare i zbehtë", tha Fevziu. Fevziu e ka ndjekur jetën e

diktatorit hap pas hapi, duke iu referuar gjithë materialit dhe dëshmi të mundshme. Ka spikatur me detaje portretin e Hoxhës dhe zonjës së tij Nexhmije. Figura e Hoxhës u shfaq gjakatare, vrasës, cinik dhe person me nivel të ulët, veti

këto të zbardhura nga arkivat e censuruara të kohës. Detaje interesante që jepnin urinë dhe lakminë e diktatorit për pushtet, nisin që nga vitet 40 që nga krijimi i partisë komuniste, autokritika implikuese në plenumin e Beratit, etj. Historia e këtij dokumentari është një histori e trishtë e një njeriu që sundoi për më shumë se gjysmë shekulli në historinë shqiptare. "Gjithsesi është një histori që ne duhet ta shohim në sy, sepse vetëm duke e parë në sy do të jemi më koshtient për atë që ka ndodhur dhe për atë që na pret.", tha Fevziu. Në çdo kudër filmi shfaqej historia e njëpasnjëshme e eliminimeve të anëtarëve të Byrosë nga Enver Hoxha që njihen kryesisht dhe pas viti '73. Pjesa më e madhe fokusohen nga eliminimet në ushtri deri tek eliminimi i Mehmet Shehut në vitin 1981. Në filma ka fakte edhe për eliminimet e urdhëruara me shkrim dore nga Hoxha që datojnë vitet 1942-43-44. "Enver Hoxha ka pasur filozofinë e tij të eliminimit", tha dje Blendi Fevziu.

Sali Berisha: I kam njohur anët më të errëta të Hoxhës që në atë kohë

Pas është shprehur se Blendi Fevziu tregoi me këtë film "të gjitha infrazhukurat terroriste të regjimit Hoxhist në aspektet e tij më dramatike", Kryeministri Berisha tha se: "Ata të cilët kanë përjetuar atë periudhë e kanë të qartë se për përshkrimin e saj për paraqitjen e saj duhen vëllime e seri filmash, duhet të themi të vërtetën se sinteza që bën në një libër, dhe kjo që bën në një film Blendi Fevziu është ndër më të plotat, më domethënëse, më autentike të një kohe që është ndoshta nga më të egrat". Berisha ka komentuar se ky është hapi i parë i madh

në njohjen e barbarive të atij regjimi. "Nuk ka diskutim që konsumimin i energjisë me të shkuarën është jo produktiv, por njohja e të shkuarës përbën një kusht të domosdoshëm për të parë më qartësi të ardhmen që meriton", tha Berisha. Ndërsa i pyetur se a i kishte njohur anët e errëta të Hoxhës, kur punonte me të, Berisha i përgjigjet se "Unë njihja në atë kohë çdo anë të errët të Enver hoxhës pa diskutim. Njihja në profesionin tim si mjek urinë kronike në të cilën e kishte zhytur popullin shqiptar mjerrimin e jashtëzakonshme, të cilën autori këtu ka preferuar ta paraqes me eksodin masiv të shqiptarëve.

Fatos Nano: Nuk kam pritur dokumentarin për të njohur Hoxhën



Pjetjes se nëse e kishte njohur Hoxhën si në filmin e Fevziut, shumë i përfoluri si President e ardhshëm i vendit, Fatos Nano tha se: "Ti mendon se do të prisja të bëhesha kaq, të shihja dokumentarin për të mësuar një gjë të tillë. Sigurisht që i kemi ditur që në atë kohë tiparet e errëta të Enver Hoxhës. Sidoqoftë një histori

e dokumentuar kaq mirë, është e vlefshme për të gjithë, edhe për mua. Është e vlefshme, sepse argumentohet mbi dokumente dhe arkiva. Pse ju nuk i dinit? Mendoj se vlera e këtij dokumentari qëndron tek reagimi që kemi e duhet të kemi para faktëve konkretë që shfaqen hapur, siç kanë qenë shkruar.

Blendi Fevziu: Me Hoxhën bëhen dhjetëra dokumentarë. S'kam ndërmend tjetër



Fevziu pohon se ky do të dokumentar e ka pasur zanafillën para librit të bujshëm "Enver Hoxha", i cili e ka futur në konflikt me të venë e Hoxhës, Nexhmijen. "Ideja për dokumentarin ka qenë para librit, ka qenë dokumentari që ka prodhuar librin. Pavarësisht se libri u zgjerua shumë dhe sollë një dokumentar tjetër. Dihet se disa materiale filmime të Enver hoxhës e tregojnë në një version krejt ndryshe nga ai i kurruri, që ju e patë. Dhe me kalimin e kohës tentova që mbi këto pamje të ndërtoja një dokumentar. Ishte shumë e vështirë, sepse pamjet nuk janë gjithçka. Atëherë fill-

ova dhe ndërtova tekstin e parë të dokumentarit që ishte një tekst prej 58 faqesh që dilte një dokumentar prej gjashtë orësh. Ishte pamundur kjo dhe për këtë arsye vazhdoja pastaj me idenë e librit", tha ai duke na bërë të kuptojmë se ka pasur dijeni mbi të dhënat arkivore shumë herët. I pyetur nëse ka ndërmend të bëjë dokumentar tjetër ai thotë: "Jo. Këndvështrimi sesi mund të shihet një sundues si Hoxha është i ndryshëm, unë hodha këndvështrimin e brendshëm të Partisë Komuniste të Shqipërisë, si u rrit Enver Hoxha, si e mori pushtetin, si e fuqizoi PK në Shqipëri.



Big Brother 5

VAJZAT E BB: Tek konkurrentet femra do të ndalesha për të thenë se janë më të bukura se vajzat që kanë qenë tek BB1, por me nivel inteligjence më të dobët sesa vajzat e BB1.

TIRANE

SUADA DACI

SHKËLQIM BRUSHULLI

Edgari e përdori eksperiencën jetësore me djallëzi

BB5 lë shumë për të dëshiruar në krahasim me edicionin e parë të këtij spektakli

A i ka qenë një nga banorët më të komentuar të BB1, jo vetëm për strategjinë e ndjekur në këtë reality show, por edhe për shkak të moshës së tij. Shkëlqim Brushulli, ishte banori më i madh i BB1, i cili theu i pari tabun se për të qenë pjesë e këtij formati televiziv, mund të bëhej kushdo pavarësisht moshës së tij. Në një intervistë për Shqiptarja.com, Çimi shprehet se, "është ndër të paragjykuar, qoftë nga banorët e shtëpisë më të famshme, por edhe nga njerëz të tjerë jashtë BB". Duke u ndalur te edicioni i pestë i Big Brother Albania, ai shprehet se, "BB1 ka pasur nivel të lartë në çdo lloj aspekti". Çimi komenton edhe ish konkurrentin më të moshuar të këtij spektakli Edgari, i cili la javën e kaluar shtëpinë më të famshme në Shqipëri, duke pohuar se, "ai e përdori eksperiencën e tij jetësore me shumë djallëzi, ndërsa banori më interesant në shtëpi sipas tij është Ermali". Ndonëse kanë kaluar 5 vjet nga koha kur ai ishte konkurrent në BB1, Shkëlqimi thotë se, vazhdon të ruajë marrëdhënie të mira me të gjithë konkurrentët e BB1.



Shkëlqim Brushulli, ish-banor i BB1



Disa nga konkurrentët e Big Brother 1

Shkëlqim, e ndiqni BB5?

Megjithatë nuk kam qenë në Shqipëri prej fillimit të BB5 e deri më tani, por si ish banorë i BB, duke pasur nostalgji për këtë program e kam ndjekur nëpërmjet internetit online.

Si ju duken banorët?

Banorët e BB5 janë pëthpuar të njëjtë me të gjithë BB-të përveç BB1, që nuk ka të krahasuar me të tjerët në vazhdim. Jo sepse kam qenë unë i pranishëm, por ka patur nivel më të lartë në çdo aspekt.

Keni ndonjë banorë të preferuar?

Deri tani asnjë prej tyre nuk ka ndonjë gjë të veçantë për të qenë i preferuari im, por meqenëse duhet të zgjedh njërin ai është, Ermali.

Si ju duken vajzat e shtëpisë?

Tek vajzat e shtëpisë do të ndalesha për të thenë se janë më të bukura se vajzat që kanë qenë tek BB1, por me nivel inteligjence më të dobët sesa vajzat e BB1.

Po djemtë?

Me rolin që kanë marrë djemtë e BB5, duke bërë intriga e thashetheme dyshojë ndonjëherë që janë djem.

Sipas jush, cilët janë banorët më të fortë brenda shtëpisë?

Banorët më të fortë brenda shtëpisë së BB5 do të klasifikojnë sipas rolit që kanë marrë. Liami është i fortë për intriga, Graciano i fortë për thashetheme, Edgari ka qenë i fortë në eksperiencë dhe përvojë. Më e forta fare është Gentia me naivitetin e saj. Por kjo nuk përbën rendësi pasi i "forti i shtëpisë" duhet të jetë përcaktuar nga Big Brother.

Ju keni qenë një nga banorët e mëdhenj në moshë, që thyet i pari tabun për ta marrë pjesë në këtë reality show, sa e vështirë ishte kjo për ju?

Unë nuk e dija se çfarë ishte programi Big Brother dhe njeriu nga natyra duke qenë egoist, për të plotësuar egon e tij, padashje thotë një po dhe e gjen veten brenda po-së por me një ndryshim tepër të madh në kohë. Për të thenë po duhen vetëm 2 sekonda, por ta jetosh po-në janë 71 ditë, që do të thotë larg shoqërisë dhe larg gjëse tënde me të shtrenjtë, që quhet familje për të plotësuar këtë ego. Këtë tabu unë e theyeva.

Jeni ndër të paragjykuar brenda dhe jashtë shtëpisë?

Jam ndër të paragjykuar si brenda dhe jashtë shtëpisë së BB.

Keni dashur ndonjëherë të

ishit lideri i shtëpisë?

Të gjithë banorët e BB1 dhe opinionistët i BB1, e kanë pranuar hapur që unë kam qenë lideri i shtëpisë.

Këtë vit në BB ka mori pjesë edhe një konkurrent i madh në moshë, si Edgari, si do ta vlerësonit lojën e tij?

Edgari nuk kishte asgjë të përbashkët me mua, përveç se ishte më i vjetri në moshë nga banorët e shtëpisë siç isha edhe unë. Nëse unë isha në pozicionin e babaxhanit, për efekt të moshës dhe i mbledhja të gjithë banorët rreth vetes, Edgari bënte të kundërtën. Ai kishte eksperiencë, por e përdori atë për djallëzi dhe kjo gjë nuk i shërbeu.

Franceska

Nuk besoj as te dashuria as te miqësia

Franceska afrohet pranë Graciano dhe Olës dhe thotë që është çuditur nga ai që nuk e ka futur tek miqtë e tij të ngushtë, pasi ata nuk janë grindur asnjë herë e në krahasim me Olën, kanë ndenjur më shumë bashkë. Graciano përgjigjet se lidhjen që ka krijuar aq shpejt me Olën, nuk e ka krijuar me asnjë dhe e ndjen shumë afër. Teksa flasin për lojën, Franceska shprehet se deri në këtë pikë të gjithë konkurrentët janë fitues e më pas mes saj e Graciano lind një debat, ku Graciano shprehet se Franceska është mërzitur me të se nuk e ka zgjedhur në rrethin e tij të ngushtë shoqëror, ndërsa ai është mërzitur pasi Franceska e ka cilësuar si konkurrent të dobët. Ajo shprehet se Graciano po i jep sado disfaksion Liamit e Arbrit duke u zënë me Tanin. Së fundi, Franceska shprehet se në këtë lojë nuk ka besim tek asnjë, as në shoqëri e as në dashuri.



ERMALI XHELOZ NDAJ FRANCHESKËS

Ermali dhe Franceska qëndrojnë të shtrirë, afër njëri-tjetrit e fillojnë të bëjnë plane për mënyrën se si do t'i kalojnë pushimet. Franceska i kërkon që ai të shkojë në Vlorë e të dy fillojnë që të flasin me shaka. Më pas diskutojnë për xhelozinë e Ermalit ndaj Franchesks, të cilën ai e shpreh shpesh, duke i sug-

jeruar që të vishet me rroba më të gjata e më të mbyllura, pa ekspozuar trupin. Ajo fillon që të tregosh se çfarë do t'i pëlqente që të bënte në këto momente, duke përmendur kujdesin për veten, duke i bërë vetes shërime për bukurinë, ndërsa Ermali mendon se një vajzë duhet të ketë prioritet të tjera. Ata flasin me njëri-tjetrin, duke e kthyer bisedën në shaka e duke qeshur.

bai" i shtëpisë.

Si ndikoi në jetën tuaj?

Nuk mund të them as mirë as keq. Po ta dija sesi ishte ky program, nuk do të isha bërë kurrë pjesë e tij.

Mbani mend ndonjë moment të bukur brenda shtëpisë?

Momenti im më i bukur brenda shtëpisë, që më dha shumë emocione ka qenë takimi me fëmijet e mi. Këtë moment nuk kam për ta harruar kurrë, pasi i lashë ata të iknin vetëm pa mua. Që atë natë unë duhet ta kisha lenë shtëpinë e BB.

Shkëlqim i ruani marrëdhënie me ish-banorët e BB1?

Po vazhdoj të kem marrëdhënie të shkëlqyera me të gjithë banorët e BB1.

Sa të njohur i'u bëri BB?

Kam jetuar momente të bukura mbas daljes time nga BB1 vetëm në Kosovë, atje jam prituri si një hero i vërtetë. Megjithatë për ta unë mbeitem ende një idhull. Ndoshta kjo ishte merita e BB-së.

Me çfarë merreni aktualisht?

Momentalisht ndodhem në Zvicër ku po përfundoj një trajnim, për biznesin tim privat. Nëse më lejoni do doja të jepja edhe një këshillë për të gjithë banorët e BB5. "Ju lutem mos lëndoni njerëzit, që keni lenë jashtë për të plotësuar egon tuaj".

GRANDIOLA

I trembem eliminimit këtë javë


Graciano dhe Grandiola qëndrojnë afër tavolinës dhe fillojnë të diskutojnë me njëri-tjetrin për të nominuarit e kësaj jave dhe për banorin që mund të dalë. Grandiola mendon se banori që do të dalë, mund të jetë njëri nga tre banorët e rinj, ndërsa Graciano nuk e përjashton mundësinë se mund të dalë edhe ai vetë. Grandiola thotë se këtë javë ka shumë frikë se mos del nga shtëpia. "Fakti që jeni tre të rinj, do të thotë që mundësia për të dalë ti, është më e vogël", i thotë Graciano. Më vonë ata flasin për spektaklin e gjatë të kësaj jave, duke thenë se të gjitha të shtunat do të jenë të bukura dhe të mbushura me surpriza, sepse numri i banorëve po bëhet gjithmonë e më i vogël. Ndërsa në dhomën e gjumit, Ermali, Liami, Franceska dhe Erioni tregojnë histori të filmave që kanë parë, duke i ndarë me njëri-tjetrin. Ndërsa Franceska thotë se nuk ndihet mirë.

[SHQIPTARJA.com] **enditëse**Keqkuptimi shkakton
panic në avion

Pak ditë më parë, udhëtarët të linjës Southwest Airlines, që shkante nga Baltimore për në Long Island, u përshinë nga një panik i madh. Gjithçka po shkonte për bukur dhe qetë deri në momentin kur kryepiloti, duke dashur për mirësjelljeje t'i uronte mirseardhjen në avion një zonje shtatzënë, përdori një shprehje që për pak sa nuk shkaktoi krahururë. Konkretisht piloti u afrua mikrofonit dhe e filloi urimin e mirseardhjeje duke thënë "mom on board" (mama në bord). Mirëpo, ndoshta nga cilësia e keqe e audios, shumë prej udhëtarëve e dëgjuan "bomb on board". Kaq u desh që të shpërthente paniku. U desh ndërhyrja e menjëhershme që pas disa minutash kaosi asistentet e fluturimit të sqaronin gjithçka dhe të rikthenin normalitetin. Federal Aviation Administration ka bërë të ditur se është normale që personeli të bëjë komunikime personale gjatë fluturimit, por po mendon ta rregullojë ndryshe brenda në bordin e avionit

Denoncohet se
përgjon ish-gruan


Policia e Racoon, në Pensilvani këto ditë ka demoncuar një burrë me akuzën për përgjim të paautorizuar. Nuk është fjala për ndonjë histori spiunazhi të tipit të luftës së ftohtë, por për një histori bashkëshortore tashmë të përfunduar. Burri në fjalë është 66-vjeçari Wayne Comet Cripe, i cili i ka vënë një "çimkë" përgjimi poshtë krevatit të së shoqes. Në fakt që prej një viti është i ndarë nga gruaja, por që për arsye të kut-pueshme, jetojnë në të njëjtën shtëpi, por duke fjetur në dhoma të ndara. Pikërisht për këtë "çimkë" përgjimi është denoncuar në polici nga ish-gruaja e tij. Wayne u justifikua duke thënë se nuk e kishte vënë për ta përgjuar, por meqenëse ideja se ajo që deri para një viti kishte qenë gruaja e tij bën dashuri me të tjerë e mundonte, prandaj përmes "çimkës" sigurohej që të hynte vetëm kur ajo ishte vetëm.

Kur hutimi
rezulton fatal

Që një njeri mund të ketë një moment hutimi, kjo nuk është ndonjë çudi e madhe, por kur nga një gafë kalon në një tjetër, thjesht nga hutimi atëherë nuk duket shumë normale. Madje një rast të tillë hutimi të dyfishtë, Gary Allen Banning, nga Havelock, New Carolina, mjerisht nuk do të ketë kujt t'ia tregojë sepse e pagoi me jetën e tij. Sipas rindërtimit të ngjarjes nga ana e policisë, Banning ishte futur në kuzhinë për të pirë ujë por gabimisht kishte rrëkëllyer një gotë benzine. Natyrisht që e kishte nxjerrë menjëherë i gjori, por benzina i kishte rënë në rroba dhe rrotull vetes. Pastaj, për të mbledhur vretin bëri gafën e dytë, fatalen, duke ndezur një cigare. Benzina që i kishte rënë përgjatë trupit mori flakë menjëherë dhe me gjithë ndihmën e shpejtë ndërror jetë pak më vonë në spital për shkak të djegieve të shumta.



SUPER FJALEKRYQ



■ HORIZONTAL

- Dikur quhej Kanadan.
- Në mes të Jean dhe Godard regjisor.
- Film i James Cameron.
- Lumi që formon ligenin Thun.
- Është defekt në bord
- Një mjet kur nuk je.
- Komunikojnë me alfabetin morse.
- Partia Komuniste e Kinës.
- Është shemër.
- Gjysma e hauzit.
- Një çmim prestigjioz për gazetarët.
- Emblësirat e ditëlindjeve.
- Modeli shkurt.
- Kilmer aktor.
- I drejtohen... të intervistuarit.
- Është Topi i Leo Messi-it.
- Pak anestezi.
- U kompozua nga Schumann.
- Meryl e The Iron Lady.
- Në këtë vend.
- Kështu janë filozofët që venë kënaqësinë në plan të parë.
- Zgjedh veshjet e aktorëve.
- Në fudn të krahut.
- Janë magnetikë të tilla në kasete.
- Ishte përbindësh që hante fëmijë.
- Të fundit në studim.
- Si moral.
- Bëjnë hije në... manastir.
- Gerhard, ish-sekretar i përgjithshëm i UEFA.
- Një Agron që kërkon...

përgjigjen përfundimtare

- Fillojnë lirshëm.
- Është kaponi i... helikopterit.
- Një kohë... dhe një vit.
- Jean, që qe aktor i famshëm.
- Bëjnë role me re.
- Janë autoktonë të lashtë.
- Bëhet harku me një hu.
- Inicialet e Herrera, ish trainer.
- Është prapësi.
- Sampras tenist.
- Fillojnë largimin.
- Jules, i kupës së parë të botës në futboll.
- Kalauar në kryer.
- Ajri i Londrës.

80. Janë veprat me

- bëmat e kreshnikëve.
- Emri i Pasteur.
- Kush ka... nguron.
- Girardot aktore.
- E ka simbolin N.

■ VERTIKAL

- Rrethon... ballkonin.
- Janë gjuajtës si... mirage.
- I thuren... heroit.
- Është e re pas Krishtit.
- Koscina, që qe aktore.
- Ishte dado... dikur.
- Është në fund.

9. Një Al... scarfce.

- Një dokument në PC.
- Artet pa re.
- E famshme ajo e Kolombit.
- Katet pa kufij.
- Rrotullohen në një orë.
- Një pjesë e dramës.
- Është njëvendëshe në Formula 1.
- Një gjellë me shumë zarzavate.
- Scoto filozof.
- Një telekomedi e shkurtër.
- Është zhurma.
- Mbyllin një spital.
- Janë konkluzionet me hamenje.
- Është muzika rap.
- Një mund të jetë shitejje.

29. Është lashtësi.

- Ndiqet nga Square Garden.
- Organizma Lokale Sociale.
- Mund të jetë... paparazzo.
- Është çaji kundërmues.
- Kultivohen në kopsht.
- Në krye të subjekteve.
- Një nur bukurie.
- Një gjellë... përballë.
- Një depozitë... drithi.
- Madame e mbiquajtur Notre-Dame de Thermidor.
- Ato të dados nuk janë mishi.
- Xhevahiri i poezisë sonë.
- Kishte odaliska.
- Qyteti i famshëm për një shishe.
- Qendra Ndërkombëtare e Kulturës.
- Janë në digë.
- Inicialet e Moravia-s.
- Institucione Automome Përmët.
- Ndalur pa çifte.
- Jeton në kufij.
- Një telash.
- Ishte altar pagan.
- Kështu përfundin një princip.
- Teodori, publicist i pahuar.
- Një pjesë e leshrave.
- Një stacion beduinësh.
- Është edhe ajo ghibli.
- Hapin pa kufij.
- Fillojnë romanin.
- Diftong në dietë.
- Diftong për leader.

PERGJIGJET E NUMRIT TE DJESHME



HOROSKOPI



Pritet një ditë e ngjeshur por edhe me zhvillimi kryesisht pozitive në aspektin profesional. Nga ana tjetër, duhet përfitor nga Afërdita në shenjë për të përmirësuar raportet me partnerin.

Dashi



Sot, të lindurit e kësaj shenje janë mund të jenë në qendër të vëmendjes të njerëzve të rëndësishëm, prandaj këshilla që u jepet është të bëjnë figurë të mirë. Afërdita stimulon erosin.

Demi



Ndoshta nuk do të jetë ditua juaj në aspektin e punës, pasi gjërat kanë tendencat të shkojnë në kundërshtim me parashikimet tuaja, por në aspektin sentimental nuk do të mungojnë surprizat.

Binjakët



Raportet e përkryera jo vetëm me partneren por edhe me të gjithë ata që ju rrethojnë do t'ju vlejë edhe në një ditë të vështirë, siç mund të jetë kjo e stomja. Pse kaq të kontraktuar sot?

Gaforja



Me Marsin në një pozicion të papërshtatshëm gjërat nuk ka se si shkojnë mirë edhe pse ju mundoheni që të mos bini moralisht kur nuk ju ecën. Mund t'ju ecë më shumë në dashuri.

Luani



Të lindurit e kësaj shenje sot mund të kenë të Hëna një aleat më shumë, çka do të bëjë që dita në planin afektiv të jetë shumë e mirë. Keni nevojë për dike që t'ju mbështesë.

Virgjëria



Ekilibri në kuadrin yjor do të sjellë ekulibre edhe ndër të lindurit e kësaj shenje e kjo do t'ju japë mundësinë të gjykonit më me qetësi për gjithçka. Fusha sentimentale duket mjaft aktive.

Peshorja



Ndoshta do t'ju duhet të ndryshoni diçka sot, ose në programin tuaj të detyrës ose në drejtim të një projekti a ideje që mundihet të realizoni. Nuk keni pse e refuzoni ndihmën e dikujt.

Akrepi



Kujdes, njëqind herë kujdes! Kjo u këshillohet të lindurve të kësaj shenje, sepse sot, nga një hap i lehtë gabim mund t'ju ton lamtumirë një ëndrrë të vjetër. Më të hapur ndaj partnerit.

Shigjetari



Edhe për ju është Hëna ajo që do t'ju japë gjallëri jetës suaj, sidomos në pjesën e dytë të ditës. Afërdia Juan për të marrë përgjegjësi do të jetë një anë shumë pozitive në një marrëveshje.

Bricjapi



Urani është në një pozicion të tillë që stimulon te ju fantazinë dhe në momente kritike do të arrihi të gjeni zgjidhje gjeniale. Kujdes nga tendenca për t'u dukur mbi të tjerët.

Ujori



Afërdita në shenjë tuaj, ju jep jo vetëm stimujt e nevojshëm në planin erotik, për të cilat vërtet që keni nevojë, por edhe energji e komunikueshmëri të jashtëzakonshme. Kujdes me financat.

Peshqit

LAJME
NGA BOTA■ Francë, kryeson
Hollande i së majtës

Socialisti François Hollande (Fransua Oland) kryeson garën pas raundit të parë në zgjedhjet presidenciale të Francës duke lënë pas presidentin e tanishëm Nikolas Sarkozy. Pas numërimit gati të plotë të rezultatit, zoti Hollande kishte më shumë se 28 për qind të votave ndërsa konservatori Sarkozy 27 për qind. Z. Hollande tha se rezultatet e së dielës e bëjnë atë kandidat në më të fortë, por paralajmëroi mbështetësit se mund të presin një breshëri sulmesh të ashpra nga presidenti Sarkozy para votimit të 6 majit.

■ Zgjedhjet në Francë,
alarmohet Merkel

Kancelarja gjermane Angela Merkel e ka quajtur "alarmuese" shfaqjen e fuqishme të krahut të djathtë në zgjedhjet franceze, pasi që kandidatja Marinë Le Pen mori 18 për qind në raundin e parë, njofton AFP. "Merkel vazhdon të mbështesë presidentin në detyrë Nikolas Sarkozin si president të ardhshëm, por do të punojë ngushtë me cilindo që të fitojë në balotazhin e 6 majit", ka thënë zëdhënësi i saj, Georg Streiter. "Kjo shifër e lartë është alarmuese, por pres që të zbutet në raundin e tyre", ka thënë ai në lidhje me rezultatet e Partisë Fronti Kombëtar, parti kjo anti-evropiane dhe anti-emigracionit.

■ Hollandë, bie qeveria
e Mark Rutte

Qeveria holandeze, një ndër zërat më kritikë të vendeve evropiane, dështoi në kalimin në qeveri të buxhetit. Kryeministri holandez dha dorëheqjen të hënën duke mos pasur mundësi të bihej dakord për një plan që ta sillte deficitin e vendit në linjën e rregullave të BE. Zyra e Mbretëreshës Beatrix tha se ka pranuar dorëheqjen e kryeministrit Mark Rutte dhe kabinetit të tij pas dështimit të masave shtrënguese. Pritet tani të mbahen zgjedhje të reja, por nuk është fiksur deri tani asnjë datë, edhe pse opozita thotë se mund të mbahen në qershor.

■ Afganistan-SHBA, gati
marrëveshja strategjike

Afganistani dhe SHBA kanë përfunduar hartimin e një marrëveshjeje të partneritetit strategjik, e cila përfundon marrëdhëniet e tyre pas tërheqjes së trupave luftëra në mënyrë progresive nga vendi, në vitin 2014. Një deklaratë e zyrës së Presidentit afgan Hamid Karzai tha se projekt-marrëveshja u pranua sot nga këshilltari i sigurisë kombëtare i Afganistanit Rangin Daddar Spanta dhe nga ambasadori amerikan Ryan Crocker. Në deklaratë thuhet se marrëveshja është gati për t'u nënshkruar nga presidenti amerikan Barak Obama dhe zoti Karzai.

■ Breivik: Më vjen keq
për viktimat e pafajshme

Vrasësi masiv, Anders Breivik, ka thënë se i vjen keq për "vrasjen e kalimtarëve të pafajshëm" nga shpërthimi i bombës në Oslo, por jo edhe për masakrën që ka kryer në kampin e Partisë Laboriste në Utoja. Në atë që pritet të jetë dita e fundit e dëshmisë në Gjykatën e Oslos, Breivik ka thënë se të vrarët në kryeqytet kanë qenë të pafajshëm, sepse ata nuk kanë pasur lidhje politike, "ndërsa ata që Utoja kanë qenë objektiva legjitime".

Së shpejti...

televizioni më i ri informativ në Shqipëri

A1

REPORT!

origjina e lajmit...

Jemi një grup mediatik i pavarur nga çdo parti në të cilin rregullat profesionale të informacionit mbizotërojnë mbi luftërat politike

Lajmi në
High DefinitionMund ta ndiqni A1-Report
në këto televizione kablore:

NE SHQIPERI

Televizioni Qyteti
Korçë
Inteli Media Fier
Inkusat Pogradec
TVM Devolli
Vjosa Vlorë
Toskëz Lushnjë
Bradasat Elbasan
Erzeni Shijak
Luna Kavajë
Marixho Bulqizë
Pameti Peshkopi
Iris Berat
Policani Berit
Bani i Sahi Elbasan
Kombi Fier


Lushnja Përrejas
Alfa Kabell Tirane
Cakran Fier
Kucova Kucove
Lapardhaja Berat
Brado Elbasan
Orkumi Vlorë
Asperag Mat
Mali Kukës
Oresh Fier
Maqellara Diber
Multivizion Kavajë
Tallë Janina B.Curri
Divjaka Lushnjë
M&G Elbasan
Ura Vagare Berit
Saranda Digital Sarande

Pupa Roskovec
HB-CA Eni ASA
Iliria Berat
Riad KGM Lezhe
S3 Tirane
Ju-al Kruje
Mamures Lac
Manastiri Fier
Belshi Elbasan
ARD&NET Fier

NE MAqedoni

Multimedia Maqedoni
Telefnet Maqedoni
Skupi Cable Maqedoni

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:
TIRANE-DURRES-LEZHE-FIER

KANALI 158

DIGITALB

KANALI 50

Do na ndiqni në të gjithë Shqipërinë,
Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi
dhe në pjesën tjetër të Europës

• Alba Malltezi
Drejtores e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtores e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Kronika: Elton Qyno

Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
Cel: +355696060418

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shptyr në shptyrkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë